RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË PËR PROJEKTIN E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, NDËRTIMI I SHKOLLAVE NË BASHKINË TIRANË”

Tiranë, Qershor 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBEDHJE EKZEKUTIVE**	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-12
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	13
II.	**HYRJA**	15-18
1.	Objekti i auditimit	15
2.	Qëllimi i auditimit	15
3.	Identifikimi i çështhes	15
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	16
5.	Përgjegjësitë e audituesve	16
6.	Kriteret e vlerësimit	17
7.	Standardet e auditimit	17
8.	Metodat e auditimit	18
9.	Dokumentimi i auditimit	18
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	19-95
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	19
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	21
3	Auditim i Kontratave të Koncesionit/Partneritet Publik Privat, Ndërtimi i Shkollave Bashkia Tiranë.....	21
	a. Identifikimi i propozimeve të pakërkuara apo të kërkuara. Studimet e parafizibilitetit dhe fizibilitetit ..... b. Hartimi i projektit dhe preventivit të zbatimit për punimet e ndërtimit objekt i kontratave koncesionare me Partneritet Publik Privat (PPP)..... c. Përgatitja e dokumenteve dhe zbatimi i procedurave të koncesionit ..... ç. Ngritja dhe funksionimi i njësisë së zbatimit të koncesionit dhe komisionit të dhënies së koncesionit/partneritet publik privat..... d. Zbatimi i kontratave të Koncesionit/Partneritet Publik Privat, ndërtimi i shkollave, Bashkia Tiranë. Monitorimi i kontratave	22-64 84-95
4	**Auditimi i problemeve te ndryshme të dala gjatë auditimit**	95
IV.	**Gjetjet dhe Rekomandimet**	96-104
V.	**Lista e dokumenteve të auditimit**	105
VI.	**Anekse**	106-109

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
BT	Bashkia Tiranë.
NjZP	Njësia e Zbatimit të Projektit.
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
ATK	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
SPV	Subjekt për Qëllime të Veçanta.
PPP	Partneritet Publik Privat
DSK	Dokumentet Standarte të Koncesionit
KK	Kontrata e Koncesionit
KP	Kontratat e Projektit
MM	Manuali i Mirëmbajtjes
ST	Specifikimet Teknike
KTP/KTZ	Kushtet Teknike të Projektimit/Zbatimit
VShKK	Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën
ZK	Zona e Koncesionit
KKT	Këshillit Komëtar të Territorit
DMIH	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve të Huaja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 771/3, datë 02.11.2020 ndryshuar me nr. 771/5, datë 17.12.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 09.11.2020 deri me datë 12.02.2021, në subjektin Bashkia Tiranë, për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2020, u krye auditimi mbi zbatimin e përputhshmërisë për Projektin e Partneritetit Publik Privat, ndërtimi i shkollave në Bashkinë Tiranë.

Në përfundim të auditimit në terren, janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 5 akt konstatime dhe, pas kryerjes së takimit përmbyllës me datë 12.02.2021, u paraqitën observacionet nga Bashkia Tiranë për aktet e mbajtura, pas vlerësimit të tyre u përgatit projektraporti i auditimit i cili u dërgua në Bashkinë Tiranë me shkresën përcjellëse nr. 771/7, datë 09.04.2021. Pas konfirmimit me shkresë nr. 15248/1, datë 11.05.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 771/8 prot, datë 20.05.2021) mbi njohjen me projektraportin dhe observacionet përkatëse, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi ku, në mënyrë të përmbledhur, rezulton si më poshtë:

Bashkia Tiranë, është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò *dhe* Ligjit Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e BT etj., akte ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak i BT.

Në përgatitjen e materialit për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar dokumentit të fizibilitetit për 17 shkolla, Dokumenteve Standarte të Koncesionit (Këtu e në vijim ñDSKò) dhe i gjithë dokumentacioni tekniko ï ligjor, pjesë integrale e kontratave respektivisht: Kontrata koncesionare për punë publike me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës 1ò dhe kontrata koncesionare për punë publike me nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës 4ò.

Në total, në Bashkinë Tiranë janë 14,292 nxënës mbi kapacitetin maksimal të infrastrukturës arsimore dhe 14,919 nxënës që e zhvillojnë mësimin gjatë turnit të dytë. Numri i pamjaftueshëm i shkollave në Bashkinë Tiranë ka bërë që gjatë viteve të përvijohen disa probleme të cilat përballet komuniteti si numri i lartë i nxënësve për klasë, mësimi me dy turne, vështirësia e aksesit në shkolla. Projekti ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò synon zgjidhjen e problemeve përmes ndërtimit të 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jenë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Objektivat që synon të arrijë projekti ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë Tiranëò janë:

1. **Eliminimi i mësimit me dy turne:** - Një pjesë e mirë e shkollave parauniversitare në Bashkinë Tiranë punojnë me dy turne. Me ndërtimin e shkollave të reja nxënësit do të kenë në dispozicion hapësira shkollore që do të operojnë jo më mbi kapacitet;
2. **Normalizimi i raportit nxënës për klasë:** - Objektivi është që mesatarisht të arrihet raporti 30 nxënës për klasë;
3. **Përmirësimi i aksesit:** - Në disa zona të Tiranës të cilat vitet e fundit janë populluar shumë mungojnë objektet arsimore dhe si rrjedhim nxënësit duhet të udhëtojnë në distanca shumë më të mëdha se sa parashikohet në standardet e miratuara. Ky projekt, duke i ndërtuar shkollat e reja në zona të pambuluara me institucione arsimore, ka si objektiv përmirësimin e aksesit të nxënësve në përputhje me standardet.
4. **Përmirësim i kushteve mësimore: -** Godinat e reja që do të ndërtohen do të jenë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si, palestra, laboratorë, mjedise rekreative, etj.
5. **Përmirësim i cilësisë së mësimdhënies: -** Me klasa më një numër më të vogël nxënësish, mësuesit do ta kenë më të lehtë të menaxhojnë procesin mësimor duke u kushtuar më shumë

vëmendje nxënësve dhe, nxënësit nga ana e tyre do ta kenë më të lehtë të përqendrohen gjatë zhvillimit të mësimit:

6. **Rivitalizim i zonave ku do të ndërtohen objektet shkollore: -** Duke qenë se shkollat e reja do të ndërtohen në zonat periferike në të cilat mungojnë institucionet, ato do të kthehen në pika referimi dhe qendra të zhvillimit të aktiviteteve sociale, çka do të rivitalizojë zonat në fjalë, edhe me ndihmën e projekteve të tilla si ñShkolla si Qendër Komunitareò.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit:

Nga auditimi në Bashkinë Tiranë, mbi ndërtimin e shkollave me Kontrata Koncesionare /Partneritet Publik Privat (PPP) rezultoi se:
Grupi i auditimit, mbas dhënies së vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nën sistemeve të kontrollit nëpërmjet Komisionit të dhënies së Koncesionit; Njësisë së Zbatimit të Projektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve mbi:
- Planifikimin dhe ndërtimin e institucioneve arsimore parauniversitare, nëse është bërë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò. Parashikimi në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i vendndodhjes për infrastrukturat publike, etj.
- Hartimin e fizibilitetit nga komisioni i hartimit, nëse është përcaktuar drejt, tipologjia, cilësia, shpërndarja në territorin e Bashkisë Tiranë dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve (shkollat fillore dhe 9-vjeçare; shkollat e mesme) dhe në përputhje me kuadrin rregullator ligjor.
- Përcaktimin e drejtë të burimeve financiare të institucioneve arsimore parauniversitare të përcaktuara në Ligjin Nr. 69/2020 ñPër Arsimin Parauniversitarò, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike nga Bashkia e Tiranës. (Të ardhura nga buxheti i shtetit; të ardhurat e njësisë të qeverisjes vendore; dhurimet e sponsorizimet; të ardhurat e përfituara nga institucionet arsimore dhe të ardhura të tjera të ligjshme).
- Zgjedhjen e mënyrës së ndërtuarit të shkollave me PPP, nëse është më e mira dhe më efikase, nga Bashkia Tiranë.
- Saktësinë e parashikimit të analizës ekonomiko ï financiare për Lotin 1 (Zona Tirana 1) dhe Lotin 4 (Zona Tirana 4) për 7 (shtatë) vite.
- Efikasitetin e formës së bashkëpunimi ndërmjet autoritetit kontraktues Bashkisë Tiranë (Partneriteti Publik) dhe partneriteti privat, i cili merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike përdorueseve të shpërbimeve brenda fushës së komponentëve të tij.
-Hartimin e Projektit të Zbatimit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò nëse është bërë në përputhje me Standardet e Projektimit dhe Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe në përputhje me rregullave dhe ligjet e ndërtimit në Shqipëri.
- Nëse punimet e ndërtimit janë zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit, specifikimet teknike, dhe kushtet teknike të zbatimit.
- Realizimin e punimeve të ndërtimit për 5 (pesë) objektet e lotit 1, pa leje ndërtimi për zhvilluesin Bashkia Tiranë dhe pa leje mjedisi.
- Hartimin e projekt idesë dhe të projekt zbatimit për lotin 1 dhe 4, dhe aplikimi pa kryer më parë oponencën teknike.
- Vlerësimin e evidencave që treguan për shkallën e mospërputhjeve materiale;
- Rëndësisë e vlerave të përfshira (urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni i tyre justifikues, procedurat e prokurimit, kontratat e mirëmbajtjes me performancë, vonesat në kohë në lidhje me afatet e përcaktuara, etj.);
- Auditimin e natyrës së mospërputhjeve ligjore, normative, rregullore ose procedura të brendshme.
- Arsyet që kanë çuar në mospërputhje ï neglizhencë apo akte të mashtrimit.
- Efekti dhe pasojat e mundshme që mund të ketë mospërputhja.

Arrin në konkluzionin që:

Në auditimin mbi studimin e fizibilitetit u konstatua:
1. Një analizë jo e saktë dhe e unifikuar e kostove të ndërtimit të shkollave dhe kopështeve me një diferencë prej **8,049.4 lekë/m^2**, e cila përbën rritje të analizës së kostove të ndërtimit dhe konkretisht:
- Për ndërtimin e shkollave Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,030 lekë më tepër***.
- Për ndërtimin e shkollave Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***10,544,496 lekë më tepër.***
- Për ndërtimin e shkollave Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë.
2. Hartimi i kërkesave të veçanta nga Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesionit për lotin 4 ñZona Tirana 4ò jo në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës dhe të lidhura ngushtë me punët e ngjashme, stafin teknik, licensat profesionale apo mjetet aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.
3. Hartimi i kërkesave të veçanta nga Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesionit për lotin 1 ñZona Tirana 1ò jo në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës dhe të lidhura ngushtë me punët e ngjashme, stafin teknik, licensat profesionale apo mjetet aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.
Në auditimin mbi zbatimin e kontratave Koncesionare u konstatua:
4. Përdorim pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të fondeve të Bashkisë Tiranë në shumën **11,953,207 lekë me TVSH**, për shkak të përzgjedhjes dhe pagesës së mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në kushtet e konfliktit të interesit.
Në DSK për projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò dhe në Kontratën Koncesionare me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Autoriteti Kontraktues (BT) i ka dhënë komoditetin koncesionarit shoqërisë SPV ñ SH.K.T4.ò SHPK, për të zgjedhur dhe paraqitur Bashkisë Tiranë subjekte mbikëqyrëse punimesh dhe subjekte kolauduese punimesh, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse mbikëqyrësi dhe kolaudatori përzgjidhen dhe paguhen nga Koncensioneri i shpallur fitues ñ SH.K.T4.ò SHPK. Pra, konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktues, ñSH.K.T4ò SHPK dhe jo Bashkinë Tiranë.
5. Përdorim pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të fondeve të Bashkisë Tiranë në shumën **17,667,467 lekë me TVSH**, për shkak të përzgjedhjes dhe pagesës së mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në kushtet e konfliktit të interesit.
Në DSK për projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò dhe në KK me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018, Autoriteti Kontraktues (BT) i ka dhënë komoditetin koncesionarit shoqërisë SPV ñZ.M.A.ò SHPK, për të zgjedhur dhe paraqitur BT subjekte mbikëqyrëse punimesh dhe subjekte kolauduese punimesh, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse mbikëqyrësi dhe kolaudatori përzgjidhen dhe paguhen nga Koncensioneri i shpallur fitues ñZ.M.A.ò SHPK. Pra, konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktues, Shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK dhe jo Bashkinë Tiranë.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në studimin e fizibilitetit Bashkia Tiranë ka analizuar se duke qënë që në Shqipëri nuk janë bërë më përpara investime të këtyre	43	E lartë	Bashkia Tiranë të analizojë variantin për ndarje në më shumë Lote për dy lotet e

	përmasave në fushën e arsimit, risku që të gjenden Operatorë Ekonomikë me eksperiencë në këtë fushë të përmasave financiare të sipërcituara është tepër i vogël. Në çdo rast, edhe nëse do të kishte Operatorë Ekonomikë të cilët kanë kryer kontrata të ngjashme të përmasave të mësipërme, numri i tyre do të ishte tepër i limituar duke limituar kështu edhe konkurencën, gjë që dëmton procesin e prokurimit. Përveç sa më sipër, skema e financimit përmes PPP parashikon që Operatori Ekonomik të shërbejë edhe si investitor përveçse si ndërtues. Ky element e vështirëson akoma më tepër gjetjen e Operatorëve Ekonomikë që kanë kapacitete për realizimin e këtij projekti si një i tërë. Ndaj Bashkia Tiranë ka vlerësuar që projekti të ndahet minimalisht në **4 Lote**, për të rritur shanset që kërkesat e mësipërme të plotësohen. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi studimin e fizibilitetit të projektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò, Bashkia Tiranë nuk ka analizuar mundësinë apo variantin financiar nëse BT do të marrte vetë kredi për realizimin e projektit. Nga Bashkia Tiranë, *nuk është analizuar varianti për ndarje në më shumë LOTE*, në mënyrë që të nxitej apo stimulohej konkurenca e operatorëve ekonomik pasi në projektet me vlera të larta monetare, konkurenca është më e ulët ku shumë pak operatorë ekonomik në treg plotësojnë kapacitete financiare dhe teknike. Ndarja në më shumë se 4 lote, do të realizonte një konkurencë apo terheqje më e gjerë e më shumë operatorëve ekonomik.			parealizuara ende, në mënyrë që të nxiten apo stimulohen operatorë ekonomik për të marrë pjesë në PPP, ku të zhvillohej konkurenca, duke përfituar ulje të çmimeve dhe të marzheve nga konkurimi publik.
2	Kërkesat e veçanta të kualifikimit për objektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën **Tirana 4**ò, si dhe për pesë objektet arsimore në zonën **Tirana 1** nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Sipas DSK te kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit. - Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Eksperiencë në Ndërtim a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **30% e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 307,075,859 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. **Ose** b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo me te vogel sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2,047,172,392 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. *Sa më sipër*, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50 % e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Pra AK ka ndryshuar pikën (a), të punëve të ngjashme për një objekt nga 50 % në 30 % dhe ka lënë të pandryshuar pikën (b) me shumë objekte në dyfishin e vlerës. Veprimi i mësipërm favorizon operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30 % të vlerës dhe vështirësia e pjesmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit. *Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni i prokurimit publik.* Në lidhje me pikën **2.2**, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për çdo inxhinier në	25-31	E lartë	Bashkia Tiranë, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve për Lotet 2 dhe 3 që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret në lidhje me punët e ngjashme, stafin teknik, licensat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurenca. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

	zbatim licensa e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues i janë kërkuar gjithashtu edhe licensat e projektimit. Gjithashtu, vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi: Mbështetur në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë. Në pikën **5** AK ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë *për të pakten 6 (gjashte) muajt e fundit*. Në pikën **5.1** përcaktohet që OE të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për *6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 40 (dyzet) punonjës*. Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 40 punonjës me dëshimi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifkime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 20 apo 30 punonjës me ISHTI në listë pagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë. ***Ndërkohë***, në pikën **5.2**. AK kërkon që Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar Inxhinier ï Auditues energjie (1 person) dhe Ekspert zjarrfikes të certifikuar (1 person) në listpagesat e shoqërisë për të paktën *3(tre) muajt e fundit.* Në pikën **6**, kërkohet që Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, ***1 mjek***, bazuar në bazë të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 ñPër sigurinë dhe shëndetin në punëò, VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 ñPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 09.02.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, gërma ñbò dhe pika 4 gërma ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***. Pra kërkesa e mjekut është shfuqizuar. Gjithashtu, vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotesojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 74 pika 3 ku citohet ....ñ *secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DSK. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*ò. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon ñMjekò nuk mund të jetë pjesë e një bashkimi operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, ***pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit***. Në pikën **18**, AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund tô vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjestim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinç kulle me lartesi min 30 ml me peshëmbajtje të pakten 850 kg në 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinç. Është kërkuar Fabrikë Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet të paraqitet akti i pronesise së qiradhensit shoqëruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerase duhet të jetë e noterizuar, ku të specifikohet*			

	objekti i kontratës dhe afati i saj. Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë.			
3	Kryetari i BT, me shkresën me nr. 34277/2, datë 09.10.2019 mbështetur në KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, Kreu IV, Pika 4.4.2, paragrafi ñcò dhe pika 4.5 në pozicionin e zhvilluesit/investitorit, duke përfaqësuar Institucionin Bashkia Tiranë, ka autorizuar Shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK të paraqesë kërkesë dhe të realizojë të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor për projektimin, menaxhimin e dorëzimin e dokumentacionit për aplikim për leje ndërtimi. - Në vijim, Shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK me shkresën me nr. 21, datë 09.10.2019, autorizon shoqërinë ñA.K.ò SHPK që të përfaqësojë shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK në procedurën e aplikimit për Leje Ndërtimi për objektin: ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò. Grupit të auditimit deri në fund të auditimit me datë 12.02.2021, nuk ju paraqit zbardhja e lejeve të ndërtimit për 5 (pesë) objektet arsimore që po ndërtohen në sheshet e ndërtimit: Sheshi 9/1, rruga ñEshref Frashëriò; Sheshi 11/2, rruga òVangjel Notiò dhe Sheshi 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò. Sa më sipër zgjatja e procedurës së lëshimit të lejes së ndërtimit dhe ndërkohë vazhdimi i punimeve të ndërtimit për objektet arsimore nuk është në përputhje me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"* të ndryshuar, neni 29 dhe neni 39, dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë. - Për shkak të zgjatjes së procedurës për Lejen e Ndërtimit nga Bashkia e Tiranës, për objektet arsimore që do të ndërtohen në sheshet e ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò pranë lagjes ñDon Boskoò, në Sheshin 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò dhe në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò, nga mbikëqyrësi i punimeve JV ñD. E.ò SHPK & ñY. A.ò, nuk janë mbajtur dokumentet teknike si: - Akt kontrolli në kuotës ± 0.00; - Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit (në përfundim të kësaj faze);	71-71	E Lartë	Nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, të bëhet një analizë për mos dhënien e lejeve të ndërtimit dhe të dalin përgjegjësitë. Të merren masa të menjëhershme për dhënien e lejeve të ndërtimit për pesë objektet arsimore në lotin 1 ñZonën Tirana 1ò duke mundësuar realizimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit (konformë kushteve urbanistike dhe treguesve zhvillimor për zhvilluesin Bashkia Tiranë), projektin e zbatimit, kushtet teknike të zbatimit dhe të sigurojë cilësinë e objekteve arsimore dhe materialeve të ndërtimit sipas kërkesave të projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.
4	Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e punimeve sipas Kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 me operator ekonomik fitues shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK për shkollën, Tip 2 + Kopësht që po ndërtohet në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò nuk është bërë kërkesë për Leje Mjedisi pranë AKM. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e zbatimit rezulton se, AKM ka pajisur shoqërinë ñA.K.ò SHPK me leje mjedisi për objektet arsimore që po ndërtohen në sheshin e ndërtimit 11/1 rruga ñPaisi Vodicaò dhe në sheshin e ndërtimit 9/1 rruga ñEshref Frashëriò në vlerën 60,000 lekë dhe jo në vlerën 150,000 lekë siç është llogaritur në rraportin përmbledhës nr. 34198, datë 09.11.2016, pika 1.3.1.3 ñKostot e tjera të drejtpërdrejta të investimitò (Fizibiliteti). Sa më sipër vazhdimi i punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes së mjedisit është në kundërshtim me pikën 4.4.2 germa (c) të kontratës Koncesionare ; ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPer kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimitò i ndryshuar, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 4, germa (e) dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë Koncesionare , Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve.	72	E lartë	Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tã kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA.K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për leje mjedisi për objektin arsimor që po ndërtohet në sheshin e ndërtimit 11/2, për të garantuar parandalimin dhe kontrollin për çdo ndikim apo ndotje mjedisore si dhe zbatimin e kërkesave teknike të përcaktuar në lejen mjedisore. AK Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për lejet mjedisore, duhet të reflektojë diferencën prej 90,000 lekë në koston direkte të investimit në kalendarin e pagesave parashikuar në nenin 2.5 të kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kontratës.

5	Oponenca Teknike për projektin ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò është bërë e pjesshme, nga shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK vetëm për objektin ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 9/1, Rruga ñEshref Frashëriò Tiranë dhe nuk rezulton të jetë bërë oponencë teknike në vlerën 729,484 lekë për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodica ò Tiranë dhe për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Noti ò Tiranë. Sa më sipër, Shoqëria Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodica ò Tiranëò dhe për projektin e zbatimit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Noti ò Tiranëò, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se: ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò. Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkina Tiranë, NjZP dhe Mbikëqyrësi i punimeve.	73	E lartë	Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, NjZP dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tõ kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA.K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për kryerjen e oponencës teknike për objektet arsimore që po vazhdojnë punimet e ndërtimit me një projekt zbatimi pa kryer më parë oponecën teknike, si një detyrim ligjor. AK Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për oponencën teknike, duhet të reflektojë diferencën prej 729,484 lekë në koston direkte të investimit në kalendarin e pagesave parashikuar në nenin 2.5 të kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kontratës.
6	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se NjZP në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale është ngritur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me Urdhërin nr. 7710/3, datë 21.02.2019. Në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò, Njësia e Zbatimit të Projektit duhej të ishte ngritur një muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës Koncesionare (17.10.2018), pra me datë 17.11.2018 dhe jo me datë 21.02.2019. Sa më sipër, NjZP është ngritur rreth 4 (katër) muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me Kontratën Koncesionare/PPP ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimorenë Bashkinë e Tiranësò me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol., datë 17.10.2018, pika 6.1 ku thekson se: ñ*Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e Kontratës, AK krijon Njësinë e Zbatimit të Projektit e cila do të përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen si më poshtë ("NJZP")*...ò. Ngritja e NJZP me shumë vonesë ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë, për mos zbatim të përmbushjes së detyrime kontraktuale të kontratës së koncesionit.	75-76	E lartë	Nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, të merren masa që në vazhdimësi për zbatimin e kontratave Koncesionare në ndërtimin e objekteve arsimore për lotin 2 dhe lotin 3, për krijimin e Njësisë së Zbatimit të Projektit në aftin kohor të përcaktuar në kontratën Koncesionare, si një detyrim kontraktual.
7	Përcaktimi i kostos së ndërtimit të shkollave, nga AK Bashkia Tiranë është referuar preventivave të hartuar për ndërtimet e reja të objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, me financim nga fondet publike dhe donatorë, ku janë marrë në konsideratë 5 shkolla dhe është nxjerrë çmimi për njësi në metër katror. Sipas preventivëve të marrë në analizë për të 5 objektet arsimore, kategoritë e punimeve me zërat përkatës, që realizohen, janë Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike. Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iõu referuar Manualit Teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 ï 2013, ku është bërë indeksimi i çmimit për metër katror i dalë nga këto preventiva. Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it ñNdryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (*Për Banesa*), 1994-2015ò, ku për periudhën 2013 ï 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55 %. Si rezultat i këtij indeksimi çmimi mesatar i ndërtimit për shkollat është pranuar **46,331.6 lekë/m²** pa TVSH dhe çmimi mesatar i ndërtimit për kopshteve është marrë **54,381 lekë/m²** pa TVSH. *Pra konstatohet,* se një analizë jo e saktë e kostove të ndërtimit pasi në të dyja rastet e shkollave dhe të kopështeve preventivat e punimeve kanë të njëjtat zëra të punimeve (Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike). Në të dy rastet e përllogaritjeve për shkollat dhe kopshtet u është referuar manualeve teknike të cmimeve 2012-2013, të cilat	42	E lartë	Bashkia Tiranë të analizojë situatën ku të nxjerrë përgjegjësitë për përllogaritjen e kostove të ndërtimit të shkollave dhe të kopështeve, të paargumentuara teknikisht në diferenca të çmimit, për: - Ndërtimin e shkollave Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,030 lekë më tepër***. - Ndërtimin e shkollave Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), në ***10,544,496 lekë më tepër.*** - Ndërtimin e shkollave Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë. Bashkia Tiranë të merrë masa të menjëhershme që për dy lotët 2 dhe 3 të cilat nuk janë zhvilluar ende, të rillogariten saktë kostot e ndërtimit, në mënyrë që fondet publike të përdoren me ekonomicitet, efektivitet dhe eficensë.

	nuk kanë ndryshime për zërat e punimeve dhe indeksimi për banesat është marrë i njëjtë 0.55 %. Në analizën e kostove për kopshtet, nuk paraqiten objektet e përllogaritura, nga janë marrë referencat etj. Rrjedhimisht, edhe kostoja për metër katror e kopshteve duhej të ishte e njëjtë me atë të ndërtimit të shkollave, ku të dyja përfshihen në të njëjtin grup tarifor sipas VKM 354, datë 11.05.2016 për ñ*Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikqyrje dhe Kolaudim*ò. Për objektet arsimore, i refreohet Kreu III, Seksioni I ñNdërtesat dhe ndarjet funksionale të tyreò, ku kemi marrë grupin e IV tarifore dhe referuar tabelës 6, ñTabela shoqërueses e tarifave, neni 25. Pra, kostoja për metër katror e kopshteve është marrë me çmimin 54,381 lekë/m^2 pa TVSH, e cila duhej të merrej me çmimin 46,331.6 lekë/m^2 pa TVSH, me një diferencë prej **8,049.4 lekë/m^2**, e cila përbën rritje të analizës së kostove të ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë, e cila sjell rritje të mëtejshme në kostot shtesë për projektimin, mbikqyrjen dhe kolaudimin. Nga rillogaritjet e grupit të auditimit konstatohet se Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,030 lekë më tepër***, Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***10,544,496 lekë më tepër*** dhe Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë.			
8	Në DSK kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesmarrës në procedurën Koncesionare/PPP duhet tëi ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikëqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.* Kryetari i BT me shkresën me nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar ñSh.K.T4ò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 ñCaktimi i Mbikëqyrësit të punimeveò si dhe të pikës 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon: - Për mbikëqyrës punimesh ñA.MK.ò SHPK - Për kolaudator BOE ñD.N.ò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4ò është lidhur ndërmjet ñSH.K.T4.ò. ***<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Sh.K.T.T4. dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>*** Në ofertën e koncesionarit në kapitullin C, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 9,552,840 lekë pa TVSH ose 11,463,408 me TVSH dhe	49-50	E lartë	Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të marrë masa nëpërmjet një grupi të vecantë pune, që vlera **11,953,207 lekë me TVSH** për mbikëqyrjen dhe kolaudimit, të paguhet nga Bashkia Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi. *Varësia dhe likuidimi për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin nga Bashkia Tiranë, do te rrisë sigurinë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.* Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interest ndëmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

	vlera që do të paguhet kolaudatori është 408,166 lekë pa TVSH ose 489,800.2 leke me TVSH. Në total vlerë është **9,961,006 lekë pa TVSH** ose **11,953,207 lekë me TVSH.** Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimve është i konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria Koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin e zbatimit, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, etj. *Vlera prej* **11,953,207 lekë me TVSH** që do tã paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.			
9	Në DSK kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesmarrës në procedurën Koncesionare/PPP duhet tã ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.* Me datë 29.10.2018 Drejtori i Përgjithshëm të Punëve Publike në BT me shkresën me nr. 39681/2 prot (datë 27.10.2020) i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 1ò se duke marrë parasysh reputacionin personal, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit zgjidhen: - Për mbikëqyrës punimesh JV ñD. E.ò SHPK & ñY. A.ò - Për kolaudator ñTò SHPK. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit të objektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pestë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò është lidhur ndërmjet shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò shpk. ***<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Sh.K.T1. dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>*** Ndërkohë në ofertën e koncesionarit, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 14,161,791 lekë pa TVSH ose 16,994,149 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 561,098 lekë pa TVSH ose 673,318 leke me TVSH. Në total vlerë është **14,722,889 lekë pa TVSH** ose **17,667,467 lekë me TVSH.** Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimve	80	E lartë	Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të marrë masa nëpërmjet një grupi të vecantë pune, që vlera **17,667,467 lekë me TVSH** për mbikëqyrjen dhe kolaudimit, të paguhet nga Bashkia Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi. *Varësia dhe likuidimi për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin nga Bashkia Tiranë, do te rrisë sigurinë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.* Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interest ndëmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

	është ose konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria Koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, etj. *Vlera prej* **17,667,467 lekë me TVSH** që do të paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion për Njësinë e Zbatimit të Projektit.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Projektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranëò respektivisht për Lotin 1 dhe 4: Zona Tirana 1 dhe Zona Tirana 4, sa i takon shkallës së zbatimit të kontratave koncesionare, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat Njësia e Zbatimit të Projektit, menaxhon, mbikëqyr dhe koordinon përmbushjen nga palët kontraktuale të detyrimeve respektive përgjatë procesit të zbatimit të kontratave Koncesionare . Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Baza për opinionin e modifikuar.
Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Bashkia Tiranë për Projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranëò, rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale por të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një Opinioni të modifikuar.
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ***ISSAI 4000***[1]**,** me ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në INTOSAI - P10, ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 130 ñKodi Etikò. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetin për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e projektit, rezultuan disa mangësi dhe parregullsi që konsistojnë në:
-Ecuria e punimeve të ndërtimit për kontratën koncesionare me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 nuk është në përputhje me grafikun e punimeve dhe realizimi i punimeve referuar faktit paraqitet rreth 53 %.
-Projekti ka kapërcyer afatet e parashikuara për përfundimin e punimeve sipas parashikimit

[1] *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

në kontratë. Vonesë e theksuar ka rezultuar në Kontratën Koncesionare me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 për zbatimin e punimeve të ndërtimit të Kontratës me Koncension/Partneritet Publik Privat me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, për 5 (pesë) objekte arsimore në Zonën Tirana 1ò, periudha e përfundimit të të cilit nuk është shtyrë nga BT dhe ndërkohë aktualisht punimet e ndërtimit janë me rreth 115 ditë jashtë afatit të përfundimit të kontratës.
-Si pasojë e vonesave në zbatimin e kontratave, rriten edhe shpenzimet për disa shërbime, të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtje dhe operim automjetesh, mirëmbajtje dhe operim i zyrave në dispozicion të konsulentit, mbikëqyrësit apo kolaudatorit, etj., të cilat nuk japin impakt në investimin e realizuar.
- Ritjen e kostove të ndërtimit të shkollave dhe të kopështeve, të paargumentuara teknikisht në diferenca të çmimit, për:
- Ndërtimin e shkollave Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,030 lekë më tepër***.
- Ndërtimin e shkollave Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), në ***10,544,496 lekë më tepër.***
- Ndërtimin e shkollave Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë.
- Përdorim pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të fondeve të bashkisë Tiranë në shumën **11,953,207 lekë me TVSH**, për shkak të përzgjedhjes dhe pagesës së mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar në Kontratën Koncesionare me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, për projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò loti 4 (Zona Tirana 4).
- Përdorim pa Ekonomicitet, Eficencë dhe Efektivitet të fondeve të bashkisë Tiranë në shumën **17,667,467 lekë me TVSH**, për shkak të përzgjedhjes dhe pagesës së mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar në Kontratën Koncesionare me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018, për projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò loti 1 (Zona Tirana 1).
- Janë konstatuar mangësi në vazhdimin e punimeve të ndërtimit për kontratën koncesionare Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 në kushtet e neglizhencës së zbardhjes së lejes së ndërtimit, lejeve zhvillimore si dhe lirimit të pjesshëm të shesheve të ndërtimit. Hartimit të Projekt idesë dhe Projektit të Zbatimit pa kryer paraprakisht oponencën teknike për objektet arsimore sipas shesheve të ndërtimit.

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit Nr. 771/3, datë 02.11.2020 ndryshuar me nr. 771/5, datë 17.12.2020, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 09.11.2020 deri me datë 12.02.2021 në subjektin: Bashkia Tiranë u krye auditimi ñAuditim mbi përputhshmërinë për projektin e PPP, ndërtimi i shkollave në bashkinë Tiranëò, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1- **Skënder Muça, përgjegjës grupi;**
2- **Aldo Kume, anëtar;**

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.
-Objekti auditimit synojnë***:***
Dhënie e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nën sistemeve të kontrollit të brendshëm nëpërmjet Komisionit të dhënies së Koncesionit; Njësisë së Zbatimit të Projektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:
- Nëse planifikimi dhe ndërtimi i institucioneve arsimore parauniversitare është bërë në përputhje me me ligjin nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò. Parashikimi në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i vendndodhjes për infrastrukturat publike, etj.
- Nëse nga komisioni i hartimit të fizibilitetit, është përcaktuar drejt, tipologjia, cilësia si dhe shpërndarja në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve (shkollat fillore dhe 9-vjeçare; shkollat e mesme) dhe në përputhje me kuadrin rregullator ligjor.
- Nëse janë përcaktuar drejt burimet financiare të institucioneve arsimore parauniversitare, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike nga BT.
- Nëse zgjedhja e mënyrës së ndërtuarit të shkollave me PP është më e mira dhe më efikase, nga Bashkia Tiranë.
- nëse analiza ekonomiko ï financiare për të dy lotët (Tirana 1 dhe Tirana 4) në total për 7 (shtatë) vite, është bërë e saktë.
- Nëse kjo formë bashkëpunimi ndërmjet autoritetit kontraktues Bashkisë Tiranë (Partneriteti Publik) dhe partneriteti privat, i cili merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike përdoruesve të shpërbimeve brenda fushës së komponentëve të tij, është efikase apo jo.
-Nëse hartimi Projektit të Zbatimit është bërë në përputhje me Standardet e Projektimit dhe Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe në përputhje me rregullave dhe ligjet e ndërtimit në Shqipëri.
- Nëse punimet e ndërtimit janë zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit, specifikimet teknike, dhe kushtet teknike të zbatimit.
- Nëse materialet e ndërtimit plotësojnë specifikimet teknike dhe garantojnë cilësi të lartë.

2- Qëllimi i auditimit:
Qëllimi auditimit: është dhënia e opinionit të përputhshmërinë, apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve e dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

3-Identifikimi i çështjes.
Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të BT, të zbatimit të projektit për ndërtimin e shkollave me Koncesion/PPP, të mbikëqyrësve të punimeve dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi. Për këtë janë vlerësuar aktivitetet kontrolluese që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike mbi monitorimin dhe menaxhimin e zbatimit të kontratave koncesionare mbi ndërtimin e shkollave në territorin e BT.
Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera në hartimin e fizibilitetit, kostove direkte dhe indirekte, për 2(dy) lote, përkatësisht: Loti I. ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për objektet arsimore, në zonën Tirana 1ò dhe Loti II, ñPër përmirësimin e

infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për objektet arsimore, në zonën Tirana 4ò. gjithashtu auditimi ka përfshirë zbatimin e punimeve të ndërtimit të kontratës me koncesion për Lotin 1(Tirana 1) dhe për Lotin II (Tirana 4).
Auditimi ka përfshirë zbatimin e procedurave të prokurimit/koncesionit. Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara në projektim, si dhe është bërë vlerësimi dokumenteve të grumbulluara që i përket mjaftueshmerisë e përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit të zbatimit të punimeve të ndërtimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se dokuemntet e mbledhura, si fizibiliteti, projekt idea dhe projekt zbatimi i projektit të ndërtimit të shkollave janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi përputhshmërinë e veprimtarinë së Bashkisë Tiranë me kuadrin rregullator në fuqi duke përfshirë ndjekjen e procedurave për projektin e PPP, ndërtimi i shkollave në bashkinë Tiranë.

4-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:
Komisioni i vlerësimit të koncensionarit (KVK) përbërë nga: - Drejtori i Përgjithshëm i Punëve Publike, T.T.; Drejtori i Përgjithshëm i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, D. B.; Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar, J. H.; Drejtori i Përgjithshëm Juridik, i Aseteve dhe Licensimit, L. D.; Drejtori Juridik, A. D. dhe Drejtori i Prokurimeve, J. Z., janë përgjegjës për ndjekjen e procedurave të Koncesionit/Partneritet Publik Privat, për përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë, në zonat Tirana 1, Tirana 2, Tirana 3 dhe Tirana 4.
Njësia e zbatimit të projektit (NjZP) në Bashkinë Tiranë, e përbërë nga: ñH. H.ò; ñI. Q.ò; ñA.D.ò; ñE. R.ò; ñS. K.ò, si dhe mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës për zbatimin e kontratës për punë publike me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës 1ò.
Njësia e zbatimit të projektit (NjZP) në bashkinë Tiranë, e përbërë nga: ñH. Hò.; ñF. F.ò; ñO.B.ò; ñL. Gj.ò; ñS. K.ò, si dhe mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës për zbatimin e kontratës për punë publike me nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës 4ò.

5-Përgjegjësitë e audituesve:
Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.
Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) Nëse planifikimi dhe ndërtimi i institucioneve arsimore parauniversitare është bërë në përputhje me me Ligjin nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò. Parashikimi në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i vendndodhjes për infrastrukturat publike, etj.
b) Nëse nga komisioni i hartimit të fizibilitetit, është përcaktuar drejt, tipologjia, cilësia si dhe shpërndarja në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve (shkollat fillore dhe 9-vjeçare; shkollat e mesme) dhe në përputhje me kuadrin rregullator ligjor.
c) Nëse janë përcaktuar drejt burimet financiare të institucioneve arsimore parauniversitare, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike nga BT.
d) Nëse zgjedhja e mënyrës së ndërtuarit të shkollave me PPP është më e mira dhe më efikase, nga Bashkia Tiranë.

e) Nëse analiza ekonomiko ï financiare për të dy lotët (Tirana 1 dhe Tirana 4) në total për 7 (shatë) vite, është bërë e saktë.
f) Nëse kjo formë bashkëpunimi ndërmjet autoritetit kontraktues Bashkisë Tiranë (Partneriteti Publik) dhe partneritetit privat, i cili merr përsipër detyrimin për të ofruar shërbime publike përdorueseve të shpërbimeve brenda fushës së komponentëve të tij, është efikase apo jo.
g) Nëse hartimi Projektit të Zbatimit është bërë në përputhje me Standardet e Projektimit dhe Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe në përputhje me rregullave dhe ligjet e ndërtimit në Shqipëri.
h) Nëse punimet e ndërtimit janë zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit, specifikimet teknike, dhe kushtet teknike të zbatimit.
i) Nëse materialet e ndërtimit plotësojnë specifikimet teknike dhe garantojnë cilësi të lartë.

Në përputhje me ISSAI (1320) e (1450), objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Procedurat e koncesionit nuk janë zgjedhur, sepse gjithsej janë vetën dy lote për 9 shkolla. Gjatë procesit të vlerësimit të rriskut, audituesit vlerësuan nivelin në hartimin e fizibilitetit për projektin për përmirësimin e infrastrukturës arsimore për 17 shkolla të reja, por bazuar nga zhvillimi i procedurave të koncesionit deri në momentin e auditimit nga grupi i auditimit, procesi i auditimit u realizua vetën për Lotin 1; Tirana 1 për ndërtimin e 5 (pesë) shkollave dhe Lotin II, Tirana 4 për ndërtimin e 4(katër) shkollave.

6-Kriteret e vlerësimit.

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Ligjin Nr. 125/2013, ñPër Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privatò.
- LigjiNr.10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar.
- Ligji nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò.
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMenaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publikò, ligji nr. 10164, datë 15.10.2009.
- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimitò i ndryshuar.
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar.
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò i ndryshuar.
- VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreò.
- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò.

7. Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI (100) ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI (400) ñParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëò që përcakton parime themelore ISSAI (100) dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI (4000) ñPrezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò; si dhe ISSAI (4200);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve

(IFAC);

- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò; etj.
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò, etj.

8. Metodat e auditimit:

- Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
- Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

9. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe Projekt Raportin e Auditimit dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabelat, pasqyrat, evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. Informacioni i përgjithshëm:

Në përgatitjen e materialit për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar dokumentit të fizibilitetit për 17 shkolla, Dokumenteve Standarte të Koncesionit (DSK) dhe i gjithë dokumentacioni tekniko ï ligjor, pjesë integrale e kontratave respektivisht: Kontrata Koncesionare për punë publike me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës 1ò dhe Kontrata Koncesionare për punë publike me nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës 4ò.

Në total, në Bashkinë Tiranë janë 14,292 nxënës mbi kapacitetin maksimal të infrastrukturës arsimore dhe 14,919 nxënës që e zhvillojnë mësimin gjatë turnit të dytë. Numri i pamjaftueshëm i shkollave në Bashkinë Tiranë ka bërë që gjatë viteve të përvijohen disa probleme të cilat përballet komuniteti si numri i lartë i nxënësve për klasë, mësimi me dy turne, vështirësia e aksesit në shkolla. Projekti ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò synon zgjidhjen e problemeve përmes ndërtimit të 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jenë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme.

Përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti.

Rritja e kërkesës dhe nevojës për cilësi në arsim, ndeshet me kontraditën e ekzistencës së limituar të fondeve publike të nevojshme për realizimin e disa prej projekteve publike strategjike, sidomos ato që lidhen me investime kapitale. Pamundësia buxhetore për plotësimin e këtyre nevojave apo kërkesave ka bërë që partneritetet publike private të shihen si një burim i rëndësishëm për financimin e investimeve publike. Momentalisht, sektori i arsimit parauniversitar në gjithë Shqipërinë, por sidomos në Bashkinë e Tiranës, ka nevoja shumë të mëdha për investime kapitale në drejtim të ndërtimit të godinave të reja shkollore dhe përmirësimit të kushteve të godinave ekzistuese. Duke qenë se kapitali i nevojshëm për tâu investuar në këtë drejtim është mjaft i madh krahasuar me mundësitë aktuale të Bashkisë së Tiranës, alternativat e financimit si PPP duhen vlerësuar si mundësi për zgjidhjen e disa problemeve emergjente.

Në këtë prizëm përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga ky projekt janë si më poshtë: Një nga qëllimet kryesore të projektit është shmangia e mësimit me dy turne. Mësimi gjatë turnit të dytë nuk është i rekomandueshëm pasi ul nivelin e përqëndrimit të nxënësve në mësim dhe, si rrjedhim, performancën e tyre në shkollë. Eleminimi i turnit të dytë do sillte gjithashtu përfitime për mësuesit si dhe për prindërit të cilët e kanë më të vështirë shoqërimin e fëmijëve në shkollë për shkak të përplasjes me orarin e punës. Së fundmi, me eleminimin e turneve të dyta shmanget edhe mbipërdorimi i shkollave çka bën që procesi i amortizimit të shkollave të jetë më i ngadalshëm dhe të ulen edhe kostot e mirëmbajtjes. Me realizimin e këtij projekti do të përfitojnë në mënyrë direkte rreth 12,390 nxënës, të cilët aktualisht e zhvillojnë mësimin në turnin e dytë ose në klasa të tejmbushura.

Nëpërmjet investimit në infrastrukturën arsimore parauniversitare, do mundësohet që shkollat e reja të projektohen që në fillim sipas standardeve të BE-së duke siguruar që çdo shkolle të përfshije elementet e mëposhtme:

- *Kushtet cilësore të godinave.* Projekti parashikon që godinat e shkollave të reja të jenë më të mirë-izoluara në krahasim me shkollat ekzistuese duke reduktuar në këtë mënyrë edhe kostot e ngrohjes/ftohjes së ambienteve. Gjithashtu ato duhet të përfshijnë një sistem cilësor ngrohjeje, ndriçimi, hidro-sanitar etj., kushte këto të cilat ndihmojnë në kryerjen e mësimit sipas standardeve të caktuara.
- *Sigurinë e nxënësve.* Çdo shkollë do të përmbushë standardet e sigurisë nga zjarri apo tërmetet, do të jetë e pajisur me dalje emergjence dhe me elemente të tjera sigurie sipas standardeve të nevojshme.

- *Ambiente të përshtatshme për kurikulat mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit.* Shkollat e reja duhet të jenë të pajisura me laboratore, salla IT, salla muzike, ambiente sportive etj., në bazë të kurikulave.
- *Akses i lehtë nga personat me aftësi të kufizuar.* Projekti ka si kusht themelor sigurimin e gjithë lehtësirave të nevojshmë për mundësimin e aksesit të ambienteve të shkollave nga personat me aftësi të kufizuar.
- *Shkolla tërheqëse dhe kreative.* Përveç elementëve të cilësisë dhe sigurisë projekti synon gjithashtu që shkollat të jenë më terheqese nga pikëpamja e projektimit për mundësuar në këtë mënyrë ambiente më stimuluese dhe shlodhëse, çka nga ana tjetër ndihmon në nxitjen e kreativitetit të nxenesve dhe rritjen e interesit të tyre gjatë procesit të nxënies. Së bashku me përfitimet në lidhje me performancën mësimore, shkollat tërheqëse ndikojnë gjithashtu pozitivisht në gjallerimin e zonës dhe komunitetit përreth tyre. Një shëmbull i mirë në këtë aspekt dhe më pranë realitetit të Tiranës vjen nga Projekti i suksesshëm i ñUrbanizimit Socialò të qytetit të Medellin në Kolumbi[15]. Në kuadër të këtij projekti gjatë 10 viteve të fundit në Medellin janë ndërtuar dhe rikonstruktuar një numër i konsiderueshëm shkollash tërheqëse dhe kreative. Qëllimi kryesor i projektit ka qenë luftimi i varfërisë në komunitete nëpërmjet edukimit cilësor të fëmijëve si dhe duke sjellë më shumë gjallëri dhe zhvillim në zonat përreth shkollave. Duke qenë se Bashkia e Tiranës ndeshet me thuajse të njëjtat sfida dhe objektiva, adoptimi i shembullit të Medellin mund të jetë një histori suksesi edhe për kryeqytetin Shqiptar.

Bashkia Tiranë, është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò *dhe* ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e BT etj. akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak i BT.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

3. AUDITIM I KONTRATAVE TË KONCESIONIT/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT, NDËRTIMI I SHKOLLAVE BASHKIA TIRANË.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit në Bashkinë Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u krye auditimi i studimit të fizibilitetit: ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës”.

a. Identifikimi i propozimeve të pakryera apo të kërkuara. Studimet e parafizibilitetit dhe fizibiliteti.

Pikënisja e Projektit, Studimi i fizibilitetit realizuar në Nëntor 2016

- Në Bashkinë Tiranës gjenden gjithsej 191 shkolla publike, nga të cilat 17 janë shkolla të mesme të veçanta, 13 janë të mesme të bashkuara , 40 janë cikli i ulët dhe 121 janë 9-vjeçare. Në total, zhvillojnë mësimin 13,963 nxënës në shkollat e mesme të vecanta, 4,557 nxënës në shkollat e mesme të bashkuara, 56,950 në ciklin 9-vjeçar dhe 795 nxënës në ciklin e ulët. Duke qenë se numri i nxënësve është më i lartë se kapaciteti maksimal i këtyre shkollave, një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë të regjistruar më shumë nxënës se kapaciteti maksimal i tyre, çka i detyron ta zhvillojnë mësimin në klasa të mbipopulluara ose gjatë turnit të dytë. Nga llogaritjet e bëra nga BT për këtë studim fizibiliteti rezulton se 61 shkolla kanë më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal, nga të cilat 10 janë të mesme të vecanta, 2 janë të mesme të bashkuara dhe 49 janë 9-vjecare. 57 shkolla e zhvillojnë mësimin me dy turne nga të cilat 3 të mesme të veçanta, 3 të mesme të bashkuara, 1 cikël i ulët dhe 50 shkolla 9-vjecare. Në total, në Bashkinë Tiranë janë 14,292 nxënës mbi kapacitetin maksimal të infrastrukturës arsimore dhe 14,919 nxënës që e zhvillojnë mësimin gjatë turnit të dytë. Numri i pamjaftueshëm i shkollave në Bashkinë Tiranë ka bërë që gjatë viteve të përvijohen disa probleme të cilat përballet komuniteti si numri i lartë i nxënësve për klasë, mësimi me dy turne, vështirësia e aksesit në shkolla. Projekti synon zgjidhjen e problemeve përmes ndërtimit të 17 shkollave të reja, nga të cilat 10 do të jënë shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme. Objektivat kryesorë që Bashkia e Tiranës synon të arrijë për projektin e Përmirësimit të Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë janë eliminimi i mësimit me dy turne, normalizimi i raportit nxënës për klasë, përmirësimi i aksesit, përmirësim i kushteve mësimore, përmirësim i cilësisë së mësimdhënies, rivitalizim i zonave ku do të ndërtohen godinat shkollore.

Sa më sipër, studimi dhe hartimi i fizibilitetit mbi projektin e përmirësimit të infrastrukturës arsimore me formën me Partneritet Publik Privat (PPP) është kërkuar sipas nevojave arsimore të Bashkisë Tiranë.

b. Hartimi i projektit dhe preventivit të zbatimit për punimet e ndërtimit objekt i kontratave Koncesionare me PPP.

Kostot për zbatimin e projektit

Referuar programeve mësimor dhe standardeve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, tipet e klasave, përmasat e tyre, hapësirat e nevojshme për çdo nivel, për arsimin e mesëm të lartë, në total evidentohen 4 tipe shkollash. Burim i marrë nga studimi i fizibilitetit.

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr total	M2/nxënës	Sip.totale
Tipi 1	Urban	Arsimi Bazë	20	30	600	8.23	4938
Tipi 2	Urban	Arsimi Bazë	30	30	900	7.32	6588
Tipi 3	Rural	Arsimi Bazë	20	24	480	8.42	4041.6
Tipi 4	Urban	mesëm/Larte	21	30	630	6.35	4000.5

- Bazuar në relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme e Punëve Publike, nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, përshkruhen kostot e ndërtimit. Kostoja e ndërtimit e llogaritur **për kopështet** është

përllogaritur sipas preventivave të projekteve të kopshteve të realizuara nga Bashkia Tiranë gjatë përiudhës 2012-2013-të. Në këtë çmim janë përfshirë kostot e ndërtimit të objektit arsimor së bashku me hapësirat e hapura në funksion të tij (oborrin). Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iu referuar Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 ï 2013, është bërë indeksimi i çmimit për metër katror i dalë nga këto preventiva. Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it ñNdryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për banesa), 1994-2015ò, ku për periudhën 2013 ï 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55 %. Si përfundim çmimi mesatar së bashku me normën e rritjes llogaritet të jetë **54,381 lekë/m^2** pa TVSH.

Sipërfaqet e kopshteve sipas tipeve, burim i marrë nga studimi i fizibilitetit.

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr klasash	Nx/Klasë	Nr nxenesve	M^2/nxënës	Sip.totale (m2)
Tipi 1	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	9.1	874
Tipi 2	Urban	Kopësht (3-5 vjeç)	6	24	144	9.1	1310
Tipi 3	Rural	Kopësht (3-5 vjeç)	4	24	96	9.1	874

Kostoja e ndërtimit të kopshteve sipas tipologjisë

Tipi	Cikli	Sip.totale	Cmimi m^2	Kosto totale ndërtimi (lekë)
Tipi 1	Kopësht (3-5 vjeç)	874	54,381	47,528,848
Tipi 2	Kopësht (3-5 vjeç)	1310	54,381	71,238,892
Tipi 3	Kopësht (3-5 vjeç)	874	54,381	47,528,848

A. Kosto e ndërtimit e shkollave

- Bazuar në relacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Nr. Prot. 21407/2, datë 09.08.2016, kostoja për ndërtimin e shkollave është 46,331.67 lekë/m^2, ndërsa për ndërtimin e kopështeve është 54,380.83 lekë/m^2. Nga kombinimi i kësaj të dhënë me sipërfaqen totale të ndërtimit për secilin tip shkolle, rezulton se:

Å Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 1 është 276,314,618 lekë. (2 shkolla)
Å Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 2 është 376,471,912 lekë. (7 shkolla)
Å Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 3 është 234,736,581 lekë. (1 shkollë)
Å Vlera e ndërtimit të një shkolle Tipi 4 është 185,349,833 lekë. (7 shkolla)

Kostoja totale për realizimin e 17 shkollave të parashikuara (ndërtim, mobilim, laboratorë, mirëmbajtje) është 4,720,118,027 lekë (ndërtimi) + 502,378,267 (kosto mobilim+laboratore) + 1,159,737,664 (kosto mirëmbajtje për 7 vite) = 6,382,233,958 lekë pa TVSh.

- Përcaktimi i kostos së ndërtimit të shkollave i është referuar preventivave të hartuar për ndërtimet e reja të objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, me financim nga fondet publike dhe donatorë, ku janë marrë në konsideratë shkollat si më poshtë:

ÅNdërtim i ri shkolla 9 vjeçare në rrugën ñSelaudin Bekteshiò, nga Delegacioni i BE;
ÅNdërtim i ri shkollës 9 ï vjeçare ñAhmet Gashiò, financim nga fondet publike;
ÅNdërtim i ri shkollës 9 ï vjeçare tek ñIsh Parku i Autobusaveò, financim nga fondet publike;
ÅNdërtim i ri shkollës 9 ï vjeçare ñIsh Magazinat e Kombinatit tekstilò, nga fondet publike;
ÅNdërtim i ri shkollës së mesme ñ Hoxha Tahsimò, financim nga fondet publike.

Sipas preventivëve të marrë në analizë për të 5 objektet, kategoritë e punimeve me zërat përkatës, që realizohen, janë Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike. Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iu referuar Manualit Teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 ï 2013, është bërë indeksimi i çmimit për metër katror i dalë nga këto preventiva. Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it ñNdryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (**për Banesa**), 1994-2015ò, ku për periudhën 2013 ï 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55 %. Si rezultat i këtij indeksimi çmimi mesatar i ndërtimit është pranuar **46,331.6 lekë/m^2** pa TVSH. Mbështetur në këtë analizë, kostoja për ndërtimin e objekteve arsimore sipas tipologjive është:

Tipi	Cikli	Sip.totale	Cmimi m^2	Kosto totale ndërtimi me TVSH (lekë)
Tipi 1	Arsimi Bazë	4938,0	46,331.6	228,785,770
Tipi 2	Arsimi Bazë	6588,0	46,331.6	305,233,020
Tipi 3	Arsimi Bazë	4041.6	46,331.6	187,207,732
Tipi 4	I mesëm I	4000.5	46,331.6	185,349,833

Kosto totale e ndërtimit e shkollave bashkë me kopshtet e integruara është sipas tabelës së mëposhtme, burim i marrë nga studimi i fizibilitetit.

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Sip. Kopesht	Sip. Arsimi Baze	Sip. Mesm/ Larte	Kosto/ Per shkolle (Lek)	Kosto/ Per kopesht (Lek)	Kosto Totale
Tipi 1	Urban	Baze + Kopesht	874	4,938	0	228,785,770	47,528,848	**276,314,618**
Tipi 2	Urban	Baze + Kopesht	1310	6,588	0	305,233,020	71,238,892	**376,471,912**
Tipi 3	Rural	Baze + Kopesht	874	4,041.60	0	187,207,732	47,528,848	**234,736,581**
Tipi 4	Urban	I mesëm i Lart	0	0	4000.5	185,349,833	0	**185,349,833**

Sa më sipër konstatohet, se nuk është bërë një llogaritje e saktë e kostove të ndërtimit pasi në të dyja rastet e shkollave dhe të kopështeve preventivat e punimeve kanë të njëjtat zëra të punimeve (Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike). Në të dy rastet e përllogaritjeve për shkollat dhe kopshtet u është referuar manualeve teknike të cmimeve 2012-2013, të cilat nuk kanë ndryshime për zërat e punimeve dhe indeksimi për banesat është marrë i njëjtë 0.55 %. Në analizën e kostove për kopshtet, nuk paraqiten objektet e përllogaritura, nga janë marrë referencat etj. Rrjedhimisht, edhe kostoja për metër katror e kopshteve duhej të ishte e njëjtë me atë të ndërtimit të shkollave, ku të dyja përfshihen në të njëjtin grup tarifor sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016 për ñ*Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikqyrje dhe Kolaudim*ò. Për objektet arsimore, i refreohet Kreu III, Seksioni I ñNdërtesat dhe ndarjet funksionale të tyreò, ku kemi marrë grupin e IV tarifore dhe referuar tabelës 6, ñTabela shoqërueses e tarifave, neni 25. Pra, kostoja për metër katror e kopshteve është marrë me çmimin ***54,381 lekë/m²*** pa TVSH, e cila duhej të merrej me çmimin ***46,331.6 lekë/m²*** pa TVSH, me një diferencë prej **8,049.4 lekë/ m²**, e cila përbën rritje të analizës së kostove të ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë, e cila sjell rritje të mëtejshme në kostot shtesë për projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin. Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimin e çmimit:

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Sip. Kopesht	Sip. Arsimi Baze	Sip. Mesm/ Larte	Kosto/ Per shkolle (Lek)	Kosto/ Per kopesht (Lek)	Kosto Totale
Tipi 1	Urban	Baze+kop	874	4,938	0	228,785,770	40,493,818	269,279,588
Tipi 2	Urban	Baze+kop	1310	6,588	0	305,233,020	60,694,396	365,927,416
Tipi 3	Rural	Baze+kop	874	4,041.60	0	187,207,732	40,493,818	227,701,550
Tipi 4	Urban	I mes/ Lt		0	4000.5	185,349,833	0	185,349,833

Tabela paraqet difencën e kostove të llogaritura për Tipet e ndërtimeve.

Tipi	Kosto Totale me 46,331 lek	Kosto Totale me 54,380 lek	Diferenca nga cmimi per m2
Tipi 1	269,279,588	276,314,618	**7,035,030**
Tipi 2	365,927,416	376,471,912	**10,544,496**
Tipi 3	227,701,550	234,736,581	**7,035,031**

B. Kostot e tjera të drejtëpërdrejta të investimit, përbejnë kostot për Studim projektimi, Mbikqyrja e punimeve, Kolaudimi, Oponenca teknike, Mbrojtja ndaj zjarrit, Leje mjedisore, Taksa e ndikimit në infrastrukturë. Kostot shtesë janë referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 për ñ*Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikqyrje dhe Kolaudim*ò. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për Vepra Publike është 0. Në tabelën e mëposhtme përmblidhen kostot shtesë.

Tipi	Nr i shkollav	Sip. e ndertimit	Studim projektim	Mbikqyrja	Kolaudim	Oponenca	Zjarrefikes	Leje Mjedisore
Tipi 1	2	11,624	8,962,254	6,281,842	221,052	446,366	100,000	60,000
Tipi 2	7	55,286	70,772,689	29,245,329	1,054,124	1,754,725	350,000	210,000
Tipi 3	1	4,915	6,638,188	2,703,942	93,917	208,967	50,000	30,000
Tipi 4	7	28,004	37,421,081	15,275,677	537,985	1,293,922	350,000	210,000
Total	**17**	**99,828**	**123,794,213**	**53,506,790**	**1,907,078**	**3,703,980**	**850,000**	**510,000**

C1. Kosto mobilimi dhe laboratoresh

- AK, për mobilimin e shkollave të reja 9 vjeçare dhe të mesme, në Bashkinë Tiranë e ka realizuar në bazë të ligjit nr. 69/2012 ñ*Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, për të cilin Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgatitur Udhëzimin ñ*Për projektimin e ndërtesave shkollore*ò (Normat dhe Standardet). Në vijim të nevojave për shkolla të reja të evidentuara prej jush, refreuar standartit të MAS për tipologjinë e klasave dhe ambienteve të tjera në funksion të programit mësimor, janë bërë llogaritjet përkatëse në lidhje me kostot e mobilimit për nxënës, e cila është rreth **24,167 lekë pa TVSH**. Në këtë kosto janë përfshirë vlerat e mobilimit pa zërin e pajisjeve, kompjuterike dhe pajisjeve të tjera që nevojiten për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, etj. Për llogaritjen e çmimit të mobilimit AK u është referuar ofertave të marra në treg nga 6 njësi ekonomike në lidhje me artikujt e mobilimit sipas specifikimeve teknike të MAS-së. Sipas tipeve të shkollave kosto e mobilimit do ishte si më poshtë:

Tipi	Nr. Klasave	Nx/Klase	Nr nx. Total	Kosto/ nxenes	Kosto totale
Tipi 1	20	30	600	24,167	14,500,000
Tipi 2	30	30	900	24,167	21,750,000
Tipi 3	20	24	480	24,167	11,600,000
Tipi 4	21	30	630	24,167	15,225,000

- Për mobilimin e kopshteve të reja, BT i është referuar eksperiencës së mëparshme për mënyrën e mobilimit dhe sasitë e nevojshme për to. Në lidhje me koston e mobilimit është referuar çmimet e tregut, si dhe preventivave të mëparshëm të indeksuara. Kosto mobilimi i kopshteve për fëmijë është rreth **27,916 lek pa TVSH**. Në këtë kosto mobilimi krahas mobilimit të ambjenteve të fëmijëve (dhomë ndënje, fjetje) janë përfshirë ambjentet e zyrës së drejtorit, psikolog, si dhe kostot për kompletimin e guzhinës me të gjithë pajisjet. *Pra sa më sipër, konstatohet se kostot e mobilimit të kopshteve nuk kanë lidhje me kostot e ndërtimit të kopshteve dhe në analizën financiare janë të ndara.*

Tipi	Vendndodhja	cikli	Nr. klasash	Nx/ Klasë	Nr. nxenestotal	Kosto/ femije	Kosto totale
Tipi 1	Urban	(3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000
Tipi 2	Urban	(3-5 vjeç)	6	24	144	27,916	4,020,000
Tipi 3	Rural	(3-5 vjeç)	4	24	96	27,916	2,680,000

C2. Kostove për pajisjet laboratorike.

AK, është referuar materialit të vënë në dispozicion nga ana Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2016, me kontratë blerje ñLaboratorë shkencorë (Kimi, Fizikë, Biologji) për shkollat e sistemit Arsimor Parauniversitarò. Kosto për pajisjet e laboratorëve sipas tipologjisë së shkollave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Tipet e shkollave	Kosto pa TVSH
1	Arsimi Bazik (Tipi 1)	6,095,850
2	Arsimi Bazik (Tipi 2)	7,279,450
3	Arsimi Bazik (Tipi 3)	5,743,950
4	Arsimi i Mesëm i Lartë (Tipi 4)	13,983,067

Nga analiza e të gjitha të dhënave të sipër-përmendura rezulton se kosto totale e mobilimit dhe pajisjes me laboratorë e 17 shkollave është 502,378,267 lekë pa TVSH, sipas tabelës më poshtë:

Tipi	Nr. Shkollave sipas tipit	kosto mobilimi shkollave	kosto mobilimi kopeshteve	Total kosto mobilim	Kosto laboratori	Total kosto mobilje dhe orendi
Tipi 1	2	29,000,000	5,360,000	34,360,000	12,191,700	46,551,700
Tipi 2	7	152,250,000	28,140,000	180,390,000	50,956,150	231,346,150
Tipi 3	1	11,600,000	2,680,000	14,280,000	5,743,950	20,023,950
Tipi 4	7	106,575,000	-	106,575,000	97,881,467	204,456,467
Total	17	299,425,000	36,180,000	335,605,000	166,773,267	**502,378,267**

D. Kosto direkte e investimit.

Në përfundim, kosto direkte e investimit është **6,221,010,605 lekë**. Nga këto, **814,242,252** lekë janë përllogaritur fondet e nevojshme për shpronësim që do të mbulohen nga BT. Ndërsa kosto totale e projektit që do të mbulohet nga konçesionari është **5,406,768,353** lekë, ku kosto e ndërtimit është **4,720,118,027** lekë pa TVSH, Kosto e Projektimit, Oponencës teknike, Supervizimi, Kolaudimi, mobilimi dhe laboratoret **686,650,327** lekë pa TVSH. Detajimi i zërave të parashikuar është si më poshtë:

Viti	Pershkrimi	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**6,221,010,605**
A.1	**Kostot e Truallit**	**814,242,252**
A.2	Kostot e Projektimit	123,794,213
A.3	- Ndertim + instalime	4,720,118,027
A.4	- Oponenca teknike	3,703,980
A.5	- Takse Infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	510,000
A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	850,000
A.8	- Kosto Supervizimi	53,506,790
A.9	- Kosto Kolaudimi	1,907,078
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	335,605,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	166,773,267

E. Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes.

Bazuar nga përllogaritjet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Puntorëve të Qytetit, kosto e mirëmbajtjes vjetore për çdo klasë është 422,107 lekë me TVSH ose **351,755 lekë pa TVSH**. Duke kryer përllogaritjet përkatëse kosto mesatare vjetore për mirëmbajtjen e përgjithshme për secilin tip shkollash është 8,442,132 lekë për një shkollë të tipit 1; 12,663,198 lekë për një shkollë të tipit 2; 8,442,132 lekë për një shkollë të tipit 3 dhe 7,386,865 për një shkollë të tipit 4. Kosto totale e mirëmbajtjes për të gjitha shkollat është **165,676,838 lekë në vitë**. Kosto vjetore e mirëmbajtjes për efekt llogaritjesh fillon nga viti 2018 dhe në vijim deri në përfundim të periudhës së PPP. Tabelat më poshtë, paraqet përmbledhjen.

Tipi i shkollave	Nr i shkollave	Kosto e mirëmbajtjes për shkollë	Kosto e përgjithshme e mirëmbatjes
Tipi 1	2	8,442,132	16,884,264
Tipi 2	7	12,663,198	88,642,385
Tipi 3	1	8,442,132	8,442,132
Tipi 4	7	7,386,865	51,708,058
Grand Total	**17**	**9,745,696**	**165,676,838**

Në total për 7 vite mirëmbatjeje kostoja e përgjithshme e mirëmbajtjes do të jetë 1,159,737,664 lekë pa TVSH. Nga të cilat, 763,592,363 lekë Pa TVSH është kostoja e mirëmbatjes së aseteve, dhe 396,145,301 lekë pa TVSH kostoja e stafit të mirëmbajtjes. Tabela e mëposhtme, është analiza e zërave të shpenzimeve të mirëmbajtjes për çdo shkollë, gjatë një viti pa TVSH.

B.	Kostot Direkte të Mirëmbajtjes	**1,159,737,664**
B.1	Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve	**763,592,363**
B.1.1	Kostot e Mirëmbajtjes së ndertesave	176,556,240
B.1.2	Kostot e Mirëmbajtjes së pajisjeve	446,105,322
B.1.3	Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi	55,846,898
B.1.4	Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)	85,083,903
B.2	Staf Mirembajtje	**396,145,301**
B.2.1	Staf Roje	58,272,458
B.2.2	Staf Sanitare	251,473,857
B.2.3	Staf Sekretare	50,368,763

F. Burimi i financimit.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 8,811,760,212 lekë nga të cilat, 814,242,252 janë shpronësime që do të paguhen direkt nga Bashkia Tiranë te të shpronësuarit dhe 7,997,517,960 lekë është vlera e koncensionit, sipas detajimit të mëposhtëm.

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**814,242,252**	**1**	**814,242,252**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**5,406,768,353**	**1**	**5,406,768,353**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	5,406,768,353	1	5,406,768,353
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**165,676,837**	**7**	**1,159,737,859**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	165,676,837	7	1,159,737,859
4	**Marzhi i Fitimit**	**1,431,011,748**	**1**	**1,431,011,748**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	1,431,011,748	1	1,431,011,748
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4)			**8,811,760,212**

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	814,242,252	7,997,517,960	8,811,760,212
Totali	**814,242,252**	**7,997,517,960**	**8,811,760,212**

Tabelë përmbledhëse e kostove dhe të ardhurave të projektit

Viti	Pershkrimi	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Grand total
A.	**Kostot Direkte te Investimit**	**6,221,010,605**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**6,221,010,605**
A.1	**Kostot e Truallit**	**814,242,252**								**814,242,252**
A.2	Kostot e Projektimit	123,794,213								123,794,213
A.3	- Ndertim + instalime	4,720,118,027	-							4,720,118,027
A.4	- Oponenca teknike	3,703,980								3,703,980
A.5	- Takse Infrastrukture									-
A.6	- Leje mjedisore	510,000								510,000

A.7	- Mbrojtje ndaj Zjarrit	850,000								850,000
A.8	- Kosto Supervizimi	53,506,790								53,506,790
A.9	- Kosto Kolaudimi	1,907,078								1,907,078
A.10	- Mobiljet dhe Orendi	335,605,000	-	-	-	-	-	-	-	335,605,000
A.11	- Investime IT&T dhe Labs	166,773,267								166,773,267
B.	**Kostot Direkte të Mirëmbajtjes**	**-**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**1,159,737,859**
B.1	**Kostot e Mirëmbajtjes së Aseteve**	**-**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**109,084,634**	**763,592,438**
B.1.1	- Kostot e Mirëmbajtjes së Ndërtesave	-	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	25,222,316	176,556,212
B.1.2	- Kostot e Mirëmbajtjes së Pajisjeve		63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	63,729,348	446,105,436
B.1.3	- Kostot e mirëmbatjes Mobiljet dhe Orendi		7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	7,978,136	55,846,952
B.1.4	- Mirëmbajtje IT&T (HD+SW)		12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	12,154,834	85,083,838
B.2	**Staf Mirembajtje**	**-**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**56,592,203**	**396,145,421**
B.2.1	Staf Roje		13,471,815	11,226,513	9,355,427	7,796,189	6,496,824	5,414,020	4,511,684	58,272,472
B.2.2	Staf Sanitare		35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	35,924,846	251,473,922
B.2.3	Staf Sekretare		7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	7,195,542	50,368,794
A+B	**Totali i Kostove (A+B+C)**	**6,221,010,605**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**165,676,837**	**7,380,748,464**

C.	**Të Adhurat**	**814,242,252**	**1,288,021,874**	**1,239,515,438**	**1,191,009,002**	**1,142,502,566**	**1,093,996,130**	**1,045,489,694**	**996,983,257**	**8,811,760,212**
C.1	Likujdimet e shpronesimeve	814,242,252								**814,242,252**
C.2	Tarifa e Shfrytezimit pa TVSH		1,288,021,874	1,239,515,438	1,191,009,002	1,142,502,566	1,093,996,130	1,045,489,694	996,983,257	**7,997,517,960**
D	**Fitimi (humbja)**	(5,406,768,353)	1,122,345,037	1,073,838,601	1,025,332,165	976,825,729	928,319,293	879,812,857	831,306,420	**1,431,011,748**
E	**Fitimi (humbja) progresive**	(5,406,768,353)	(4,284,423,316)	(3,210,584,715)	(2,185,252,551)	(1,208,426,822)	(280,107,529)	599,705,327	1,431,011,748	**1,431,011,748**
F	**15% Tatim fitim**	0	0	0	0	0	0	(89,955,799)	(124,695,963)	**(214,651,762)**

3. Arsyetimi i Vendimit të Koncensionit/Partneritetit Publik Privat.

- Në bazë të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, ñPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privatò, arsyetimi i vendimit është përcaktuar në vlerën e parasë dhe kostot totale neto të projektit në rast se kjo do të arrihej bazuar në një metodë të prokurimit tradicional. Për këtë qëllim u përdor Krahasuesi i Sektorit Publik (KSP) i cili mat pikërisht kostot e projektit në rast se ai do të financohej nga vetë autoriteti kontraktor përmes prokurimit tradicional.

- Në ndryshim nga Koncencionet/PPP të zakonshme, ku koncensionarët ndërtojnë objekte të infrastrukturës publike me fondet e veta, i operojnë ato derisa të nxjerrin kostot e investimit plus fitimin dhe më pas ia transferojnë këtë objekt autoritetit kontraktor, ky Koncension/PPP ka një natyre tjetër. Duke qenë se objekti i kKoncensionit/PPP është ndërtimi i godinave shkollore, të ardhurat e tij nuk do të vijnë nga përdorimi i objektit të koncensionit, por nga transfertat vjetore që do tã paguajë Bashkia Tiranë koncensionarit duke llogaritur një marzh fitimi prej **6,28%.** Duke pasur parasysh edhe faktin se për zgjidhjen e problemeve të mbipopullimit dhe mësimit me dy turne dhe përmbushjen e standarteve të MAS, Bashkia Tiranë ka përcaktuar 17 shkolla të reja, dhe arsyetimi i vendimit merr trjatën e mundësive që ka Bashkia për financimin e ndërtimit të këtyre shkollave të reja përmes metodave tradicionale të prokurimit. Për ndërtimin këtyre shkollave përmes metodave tradicionale të prokurimit, Bashkia Tiranë mund të përdorë tre mënyra:

i) prokurimin e drejtpërdrejt të menjëherëshëm të 17 shkollave të reja,
ii) prokurimin e 17 shkollave të reja duke e shtrirë në një periudhë 3 vjeçare dhe
iii) prokurimin e një apo disa shkollave në vit sipas mundësive të veta financiare.

i) Bazuar në kostot direkte të investimit për ndërtimin e 17 shkollave të reja dhe duke patur parasysh se buxheti total faktik i vitit 2015 i Bashkisë Tiranë ka qenë 8,730,933,000 lekë (duke përfshirë edhe transfertën e kushtëzuar), rrjedhimisht mundësitë financiare të Bashkisë për prokurimin e këtij projekti janë zero. Kosto e ndërtimit të këtij projekti është rreth 89 % e buxhetit faktik të Bashkisë dhe në rast se do ta financonte atë, Bashkia jo vetëm që nuk do mund të ofronte asnjë shërbim tjetër, por nuk do të mund të mbulonte as pagat e punonjësve të saj.

ii) Sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò (i ndryshuar), një projekt mund të prokurohet sipas metodave tradicionale edhe duke u shtrirë në një periudhë 3 vjeçare. Nëse Bashkia e Tiranës do të prokuronte ndërtimin e 17 shkollave të reja duke e shtrirë në 3 vjet, atëherë Bashkisë do tõ duhej të shpenzonte afërsisht 2,500,000,000 lekë çdo vit. Kjo shumë, krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2015, është sa 30 % e buxhetit total dhe 51 % më e lartë se totali i shpenzimeve kapitale për vitin 2015 të cilat kanë qenë afërsisht 1,700,000,000 lekë. Pra, nëse Bashkia Tiranë do të zgjidhte këtë metodë prokurimi, jo vetëm që nuk do mund të kryente asnjë investim publik në sektorët e tjerë për 3 vjet, por do tõ duhej edhe të mbulonte diferencën prej rreth 800,000,000 lekë, duke pakësuar shpenzimet operative apo shpenzimet e personelit. Edhe nëse do të përdoreshin për këtë synim të ardhurat nga Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore të cilat llogariten mesatarisht 940,000,000 lekë në vit, sërish Bashkia Tiranë do tõ duhej që çdo vit të mbulonte në të ardhurat e veta diferencën mes 2,500,000,000 lekë që nevojiten dhe 940,000,000 lekë që janë të ardhurat nga taska e përkohëshme. Kjo diferencë 1,600,000,000 lekë dhe sërish është thuajse e barabartë me totalin e shpenzimeve kapitale për vitin 2015. Pra, edhe nëse do të përdorte këtë mundësi Bashkia nuk do mund të kryente asnjë investim publik në sektorët e tjerë si shërbimet publike vendore, rrugët dhe transporti publik.

iii) Në rast se do të zgjidhej që të prokuroheshin një apo më shumë shkolla në vit, Bashkia Tiranë do mund të përdorte për të financuar këtë projekt fondin e investimeve në programin e arsimit parauniversitar dhe eduktimit dhe të ardhurat nga Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore. Investimet faktike mesatare të tre viteve të fundit në programin e arsimit parauniversitar kanë qenë 262,621,006 lekë. Është e rëndësishme të përmendet se përmes këtij programi buxhetor gjatë viteve të fundit vetëm 10 % e fondit ka shkuar për ndërtimin e shkollave të reja, dhe pjesa dërrmuese e fondit ka shkuar për rikonstruksionin e çerdheve, kopshteve dhe shkollave. Kjo për arsye se niveli i amortizimit të objekteve arsimore është i lartë dhe nevojat kryesore kanë qenë dhe janë për rikonstruksionin e tyre në mënyrë që të mund të zhvillohej mësimi normalisht. Duke shtuar edhe faktin se si rezultat i reformës territoriale, Bashkia e Tiranës është përgjegjëse edhe për çerdhet, kopshtet dhe shkollat në zonat rurale të cilat vuajnë një nivel amortizimi akoma edhe më të lartë, mundësitë që përmes këtij programi buxhetor Bashkia të financojë ndërtimin e shkollave të reja në të ardhmen janë minimale. Rrjedhimisht, prokurimi i shkollave të reja do mund të financohej vetëm nga Taksa e përkohëshme e infrastrukturës arsimore. *Të ardhurat mesatare vjetore të parashikuara nga kjo taksë janë 940,000,000 lekë në vit*. Duke pasur parasysh se kjo taksë do të mblidhet vetëm për një periudhë 7 vjeçare, në total Bashkia do të mbledhë nga kjo taksë *6,580,000,000 lek*. Në rast se do të zgjidhej kjo metodë prokurimi, Bashkia do mund të ndërtonte 14 shkolla të reja nga 17 që nevojiten. Shkollat e reja do mund të prokurohen çdo vit nga dy, dhe duke pasur parasysh që punimet për një shkollë zgjasin mesatarisht 20 muaj, ndërtimi i 14 shkollave do përfundojë 7 vjet pas nisjes së punimeve. Krahasuar me tre mundësitë për përdorimin e metodave tradicionale të prokurimit publik, skema e Koncensioni/PPP paraqet avantazhe të theksuara dhe garanton realizimin e projektit në një periudhë shumë më të shkurtër kohore. Dy mundësitë e para, prokurimi i menjëherëshëm i 17 shkollave të reja dhe prokurimi i tyre duke e shtrirë projektin në një periudhë 3 vjeçare, janë dukshëm përtej mundësive financiare të Bashkisë Tiranë. Pra, përmes këtyre dy metodave tradicionale të prokurimit, projekti është jofizibël dhe financiarisht i parealizueshëm. Mundësia e tretë e sipër përmendur nuk e realizon plotësisht projektin pasi përmes saj mund të ndërtohen vetëm 14 nga 17 shkollat që nevojiten. Gjithashtu, edhe 14 shkollat që mund të ndërtohen, *nuk ndërtohen menjëherë por përgjatë 9 viteve të ardhshme*. Pra, kjo mundësi jo vetëm që ofron një zgjidhje të pjesëshme të problemit të mbipopullimit dhe të zhvillimit të mësimit me dy turne.

- Në modelin ***Projektim, Financim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje*** (PFNM), koncensionarët marrin përsipër përgjegjësinë për projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e një vepre për një periudhë disa vjeçare të përcaktuar në kontratë. Pagesa pas përfundimit të projektit diktohet

Në këtë Lot, janë përcaktuar 3 tipe kryesore shkollash, janë parashikuar gjithsej ndërtimi i ***4 shkollave***, nga të cilat 2 shkolla nga Tipi 4, 1 shkollë e Tipit 2 dhe 1 shkollë e Tipit 1. Sipas studimit të fizibilitetit janë përcaktuar përllogaritjet e kostove direkte të investimit për projektim, ndërtim, mbikqyrje, kolaudim bashkë me kostot e mobilimit dhe të mirëmbajtjes. Këto përllogaritje të vlerave të kostove, janë vendosur si kritere të vecanta kualifikuese në lidhje me aftësinë zbatuese të koncesionarit mbi punët, projektet dhe furnizimet e ngjashme.

Nga auditimi i dokumenteve të procedurës së koncesionit, nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik. Kërkesat e veçanta të kualifikimit nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Sipas DSK kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike,

shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit.
Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:
Eksperiencë në Ndërtim.
a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **30 % e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 307,075,859 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. **Ose**
b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo me te vogel sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2,047,172,392 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.
Sa më sipër, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet:
a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50% e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Pra AK, ka ndryshuar pikën a, të punëve të ngjashme për një objekt nga 50 % në 30 % dhe ka lënë të pandryshuar pikën b me shumë objekte në dyfishin e vlerës. *Veprimi i mësipërm favorizon* operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30 % të vlerës *dhe vështirësia e pjesmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit.*
Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni prokurimit publik.

Në pikën **2.1** AK kërkon Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim ku të përfshihen kategorite: 2/a (Projektim arkitekturor për objekte banimi - industriale ï objekte turistike) 2/b - 1 (objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara) 2/b ï 2 (qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore) 2/d (Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe të gjelberta, lulishte e parqe) 3/a (Objekte civile - industriale ï turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.) 3/c (1.Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme ï metalike ï 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.), 4/a (Projektim të Instalimeve hidrotermosanitare), 4/b (Projektim të Instalimeve termoteknike ï kondicionimi, si dhe impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme) 4/c (Projektim të linjave e rrjeteve elektrike për objekte civile, industriale) 6/a (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore) 8/a (Rivelime inxhinierike) 8/b (Rivelime inxhinierike kadastrale) 9/a (Studim/Vlerësim gjeologo inxhinierik i truallit për objekte civile ï ekonomike deri 5 kate) 10/c (Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme ï diellore ï era etj) 10/e (Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës ï linja të tensionit të ulët ï të mesëm) 11/a (Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane.

Në pikën **2.2** AK kërkon që, Operatori ekonomik duhet të paraqese Licencat profesionale të stafit kryesor përgjegjës *për zbatimin e kontratës* në kategorite si më poshte shënuar, shoqëruar patjeter me CV, kontratat individuale të punës (të vlefshme), si dhe stafi i mëposhtëm duhet të ketë eksperiencë të paktën *5 vite në sektoret përkatës*.
1. Projektues Arkitekt me Kat 2/a/b-1-2/d (Projektim arkitekturor për objekte banimi - industriale ï objekte turistike, objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara, qendra

tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore, projektim peisazhi, sistemim siperfaqe të gjelberta, lulishte e parqe).
2. Projektues Konstruktor me Kat 3/a/c ï 1 - 2 (Objekte civile - industriale ï turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate, 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie, Beton arme ï metalike ï 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët).
3. Projektues Instalator me Kat 4/a/b/c (Projektim të Instalimeve hidrosanitare, Projektim të Instalimeve termoteknike ï kondicionimi, si dhe impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burme të rinovueshme, projektim të linjave e rrjeteve elektrike për objekte civile, industriale).
4. Projektues Rrugë-Hekurudha me Kat 6/a. (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore).
5. Projektues Gjeodet me Kat 8/a/b (Rivelime inxhinierike, rivelime inxhinierike kadastrale).
6. Projektues gjeologo inxhinierik ï hidrogjeologjiko me Kat 9/a (Studim/Vlerësim gjeollgo inxhinierik i truallit për objekte civile ï ekonomike deri 5 kate).
7. Projektues i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike me Kat. 10/c/e (Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme ï diellore ï era etj, Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës ï linja të tensionit të ulët ï të mesëm).
8. Projektues të sinjalizimit rrugor me Kat 11/a (Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime).

Sa më sipër, në lidhje me pikën 2.2, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për çdo inxhinier në zbatim licensa e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues janë kërkuar gjithashtu edhe licensat e projektimit.
Gjithashtu, vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi:
Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë.
-Në pikën **5** AK, ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojne në listpagesat e shoqërisë *për të pakten 6 (gjashte) muajt e fundit*, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, punonjesit si me poshtë: Arkitekt 2 (dy) Inxhinier Ndertimi 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik 1(një) Inxhinier Topograf / Markshaider / Gjeodet / Gjeomatik (*Inxhinier për Burimeve Natyrore, me profil të Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë, profil Gjeomatikë*) 1(një); Inxhinier Mjedisi 1(një); Inxhinier Mekanik 1(një); Inxhinier Gjeolog 1(një); Inxhinier Elektrik 1(një).
Në pikën **5.1** përcakton që OE të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne listpagesat e shoqërisë për *6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 40 (dyzet) punonjës* të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të pakten: - Grupi I - 10 (dhjetë) punonjës - Grupi II - 24 (njëzetë e kater) punonjës - Grupi III ï 2 (dy) punonjës - Grupi IV - 2 (dy) punonjës - Grupi V- 2 (dy) punonjës.
Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 40 punonjës me dëshimi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifkime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 20 apo 30 punonjës me ISHTI në listë pagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë.
Ndërkohë, në pikën **5.2**. AK kërkon që Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar Inxhinier-Auditues Energjie (1 person) i cili mund të nevoitet për verifikimet e harxhimeve të energjisë të pajisjeve gjatë fazës së përfundimit të punimeve dhe të mirëmbajtjes.

Ekspert zjarrfikes te certifikuar (1 person) në listpagesat e shoqërisë për të paktën *3(tre) muajt e fundit.*

-Në pikën **6** AK kërkon që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa per *6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm*. *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

Kërkesa për 1 mjek ka qënë në bazë të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 ò*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*ò, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 òPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, gërma ñbò dhe pika 4 gërma ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***.

*Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*ò. Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

- Gjithashtu, vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotesojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 74 pika 3 ku citohet ....ñ *secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DSK. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*ò.

Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon ñMjekò nuk mund të jetë pjesë e një bashkimi operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, ***pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit***.

-Në pikën **18**. AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjestim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshembajtje të pakten 850 kg në 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinc. Është kërkuar Fabrike Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet të paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqëruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerase duhet të jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.* Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë. *Në lidhje më këtë kërkesë AK duhet të shtonte specifikimin për kontratë furnizimi me fabrikën e betonit.*

Në fund të kërkesave për Operatorët Ekonomikë, kërkon që OE pjesmarrës në procedurën koncesionare /PPP duhet ti ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedurë Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet.
Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori (Ku Investitor është Bashkia Tiranë) , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr. 8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit* *që do të kolaudojë.*

B. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin e datës **08.10.2019** të komisionit të koncesionit dhe sipas njoftimit të fituesit datë 13.08.2019, konstatohet se në procedurë ka marrë pjesë vetëm një Bashkim Operatorësh Ekonomik, sipas kritereve të vlerësimit me Oferta ekonomikisht më të favorshme, ka marrë **90 pikë**. Në përfundim kualifikohet dhe shpallet fitues BOE ñJ.V ñA.K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñE.K.ò SHPK & ñA & E. E.ò SHPK & ñS. E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò ka krijuar shoqërinë SPV ñ SH.K.T4.ò SHPK me datë themelimi 07.10.2020 dhe datë regjistrimi në QKB me NUIS M02219001K dhe ankesa Nuk ka patur.

1. Ortaku themelues ñF.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 32,132.5 lekë që përbën 32,1325 % të kapitalit fillestar të regjistruar.
2. Ortaku themelues ñA. K.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 39,533.5 lekë që përbën 39,5335% të kapitalit fillestar të regjistruar.
3. Ortaku themelues ñED. & K.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 16,319 lekë që përbën 16,319% të kapitalit fillestar të regjistruar.
4. Ortaku themelues ñE.SH.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,155 lekë që përbën 10,155% të kapitalit fillestar të regjistruar.
5. Ortaku themelues ñS.E. & C.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 1,302 lekë që përbën 1,302 % të kapitalit fillestar të regjistruar.
6. Ortaku themelues ñA & E E.ò SHPK, zotërues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme ALL 558 lekë që përbën 0,558 % të kapitalit fillestar të regjistruar.

Ortakët e shoqërisë do të përmbushin detyrimet në zbatimin e projektit sipas KK, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësitë dhe dhe rolet e caktuara ndërmjet tyre sipas KK dhe përcaktimeve të Akt-Marrëveshjes për BOE me nr. 5057 rep, nr. 1552 kol, datë 07.09.2019 të Noteres Manushaqe H. J.

Vlera totale e kontratës koncesionare dhe pagesa e koncesionit.

Ndërtimi i shkollave dhe punimet e ndërtimit do të realizohen me financimin e koncesionarit, i cili merr përsipër riskun dhe koston e investimit për zbatimin e objektit të kësaj kontrate, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në të, duke patur parasysh se në përputhje me DSK dhe ofertën e koncesionarit, AK ka marrë përsipër tõ paguaj koncesionarit vlerën prej **1,738,456,242** lekë pa TVSH ose **2,086,147,490** lekë me TVSH. Marzhin e fitimit në masën **6.28 %,** që përllogaritet çdo vit mbi vlerën e mbetur të investimit direkt dhe mbi koston vjetore të mirëmbajtjes, të përllogaritur sipas kalendarit të pagës në Aneksin 3. AK do tõ paguajë

koncensionarit si kontribut në këtë PPP për realizimin e ndërtimeve dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore për gjithë kohëzgjatjen e koncesionit, vlerën totale të kontratës, për një periudhë 7-vjeçare nga data e çertifikimit të ndërtimit, në përputhje me shumat dhe afatet e përcaktuara në kalendarin e pagesave në aneksin 3. Koncesionari ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñED.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò me datë 12.02.2020 në kompaninë e sigurimit Albsig ka siguruar kontratën koncesionare, për llogari të AK, në shumën **208,614,749.02** lekë me TVSH, si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës së sipërmarrjes.

- ñ SH.K.T4.ò ka paraqitur pranë BT shkresën me nr. Prot. 36663, datë 22.10.2020, në lidhje me ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 i kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 për mbikëqyrës punimesh subjektet e mëposhtme:

- ñA.MK.ò SHPK, ñT.ò SHPK, JV ñA. & C. M. A.ò SHPK. Si dhe propozimin në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, neni 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò i kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 për kolaudator shoqëritë

ñD-Nò SHPK ñT. E. D. S.ò SHPK, ñI.ò SHPK, ñG. & L.ò SHPK. Kontrata e koncesionit/ PPP me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë **08.09.2020** të lidhur ndërmjet BT , ndërmjet ñMASRò dhe koncesionarit.

Kryetari i BT me shkresën me nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar ñSH.K.T4.ò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 ñCaktimi i Mbikëqyrësit të punimeveò si dhe të pikës 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon:

- Për mbikëqyrës punimesh ñA.MK.ò SHPK
- Për kolaudator BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK.

Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4ò është lidhur ndërmjet ñSH.K.T4.ò, ***pa vlerë ekonomike të kontratës së mbikëqyrjes dhe kolaudimit.*** Pra Bashkia Tiranë paguan koncesionarin për shërbimin e mbikëqyrjes dhe koncesionari nuk ka dokumente që sa e paguan mbikëqyrësin dhe kolaudatorin.

Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Shoqërinë koncesionare Tirana 4 dhe jo Bashkinë Tiranë.

Ndërkohë në ofertën e koncesionarit në kapitullin C, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 9,552,840 lekë pa TVSH ose 11,463,408 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 408,166 lekë pa TVSH ose 489,800.2 leke me TVSH. Në total vlerë është **9,961,006 lekë pa TVSH** ose **11,953,207 lekë me TVSH.**

Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur mbi përzgjedhjen e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, rezulton:

-Mbikëqyrësi ñ**A.MK.**ò SHPK dhe kolaudatorit i punimeve BOE ñ**D-N" SHPK & "T.E.D.S.**ò SHPK të propozuar nga koncensionari ñ **SH.K.T4.**ò SHPK dhe të përzgjedhur nga AK për kontratën koncesionare me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu V, Pika 5, Nënpikat 5.1.1/5.1.2 (për mbikëqyrësin) dhe Kreu V, Pika 5.2, Nënpikat 5.2.1 dhe 5.2.2 (për kolaudatorin) është në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse propozimi për 3 (tre) shoqëri mbikëqyrëse dhe 3 (tre) shoqëri kolauduese të punimeve të propozuar nga Koncesionari dhe të

përzgjedhur nga NjZP apo nga AK Bashkia Tiranë, nuk është bazuar në argumente që vertetojnë përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën e tyre.
Për emërimin/përzgjedhjen e mbikëqyrësit dhe/ose kolaudatorit, nuk ka asnjë dokument si, shkresë apo raport vlerësimi që të pasqyrojë propozimin e bërë nga NJZP apo të AK duke marrë parasysh eksperiencën, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit.
Ky veprim është në kundërshtim me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 7 i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë***...ò, dhe Nenin 12, i cili thekson se: ñ...*Koladatori i objektit i kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë***...ò. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.
Kontrata e lidhur për mbikëqyrjen e punimeve me datë 27.10.2020 ndërmjet Koncensionarit " SH.K.T4." SHPK dhe shoqërisë mbikëqyrëse "A.MK." SHPK është një kontratë e thjeshtë e tipit si Nënkontraktor (madje e paparashikuar në DSK), dhe mbi të gjitha nuk buron nga zhvillimi i një procedure prokurimi sipas ligjit nr. 9643, datë datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar*, ku punëdhënës është " SH.K.T4." SHPK dhe punëmarrës është shoqëria "A.MK." SHPK. Pra në rastin konkret, shoqëria "A.MK." SHPK në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve është propozuar nga " SH.K.T4." SHPK dhe për punën e kryer do të paguhet në vlerëj* **11,953,207** lekë me TVSH *po nga " SH.K.T4." SHPK dhe jo nga Autoritetu Kontraktues Bashkia Tiranë, duke bërë të mundur përdorimin jo me efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kontratën Koncesionare . Në qoftë se varësia dhe likuidimi për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin do të jetë nga Bashkia Tiranë, mendojmë se do te rritet siguria në realizimin e punimeveduke bërë të mundur përdorimin me me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.*

► **Titulli i gjetjes: Kërkesat kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë.**

Situata: Kërkesat e veçanta të kualifikimit për objektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën **Tirana 4**ò, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Sipas DSK kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit. - Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Eksperiencë në Ndërtim.
a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin për: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **30 % e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 307,075,859 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. Ose
b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo me te vogel sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2,047,172,392 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Sa më sipër, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50% e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pra AK ka ndryshuar pikën a, të punëve të ngjashme për një objekt nga 50 % në 30 % dhe ka lënë të pandryshuar pikën ñbò me shumë objekte në dyfishin e vlerës. Veprimi i mësipërm favorizon operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30 % të vlerës dhe vështirësia e pjesmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit.

Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni prokurimit publik.

- Në lidhje me pikën **2.2**, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për cdo inxhinier në zbatim licensa e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues janë kërkuar gjithashtu edhe licensat e projektimit.

Gjithashtu, vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi:

Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë.

- Në pikën **5** AK ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë *për të pakten 6 (gjashte) muajt e fundit*. Në pikën **5.1** përcakton që OE të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne listpagesat e shoqërisë për *6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 40 (dyzet) punonjës*. Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 40 punonjës me dëshimi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifkime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 20 apo 30 punonjës me ISHTI në listë pagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë. ***Ndërkohë***, në pikën **5.2**. Ak kërkon që Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar Inxhinier ï Auditues energjie (1 person) dhe Ekspert zjarrfikes te certifikuar (1 person) në listpagesat e shoqërisë për të paktën *3(tre) muajt e fundit.*

- Në pikën **6**, kërkohet që Operatori/et Ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, ***1 mjek***, bazuar në bazë të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punëò, VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 òPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, gërma ñbò dhe pika 4 gërma ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***. Pra kërkesa e mjekut është shfuqizuar. Gjithashtu, vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotesojë kete kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 74 pika 3 ku citohet ....ñ *secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të*

*përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DSK. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*ò. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon ñMjekò nuk mund të jetë pjesë e një bashkimi operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, ***pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit***.

Në pikën **18**. AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjestim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshembajtje te pakten 850 kg ne 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinc. Është kërkuar Fabrike Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet të paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqëruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerase duhet të jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.* Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë. *Në lidhje më këtë kërkesë AK duhet të shtonte specifikimin për kontratë furnizimi me fabrikën e betonit.*

Kriteri: VKM nr. 575, datë 10.07.2013, ñPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/PPPò. Ligji 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit duke fazorizuar operatorë ose bashkim operatorësh të caktuar

Shkaku: Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 ñPër prokurimin publikòi ndryshuar

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Bashkia Tiranë, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve për Lotet 2 dhe 3 që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriteret në lidhje me punët e ngjashme, stafin teknik, licensat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurenca. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

► **Titulli i gjetjes: Përcaktimi i mbikëqyrjesit dhe kolaudatorit në kundërshtim me aktet ligjore.**

Situata: Në Dokumentet Standarte të Koncesionit kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesmarrës në procedurën Koncesionare /PPP duhet tõi ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i*

punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.*

Kryetari i BT me shkresën me nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar ñSH.K.T4.ò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 ñCaktimi i Mbikëqyrësit të punimeveò si dhe të pikës 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon:

- Për mbikëqyrës punimesh ñA.MK.ò SHPK
- Për kolaudator BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4ò është lidhur ndërmjet ñSH.K.T4.ò.

<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Sh.K. T4. dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>

Në ofertën e koncesionarit në kapitullin C, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 9,552,840 lekë pa TVSH ose 11,463,408 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 408,166 lekë pa TVSH ose 489,800.2 leke me TVSH. Në total vlerë është **9,961,006 lekë pa TVSH** ose **11,953,207 lekë me TVSH.**

Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimve është i konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, etj.

Vlera prej **11,953,207 lekë me TVSH** *që do ti paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.*

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Përdorime të fondeve publike pa efektivitet dhe eficensë.

Shkaku: Kërkesë mbi përcaktimin e mbikëqyrjesit dhe kolaudatorit në kundështim me aktet ligjore.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime:

- Bashkia Tiranë, të marrë masa nëpërmjet një grupi të vecantë pune, të analizojë vlerën **11,953,207 lekë me TVSH** të mbikëqyrjes dhe kolaudimit, ku mbikëqyrjesi dhe kolaudatori të paguhet nga Bashkia Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi. *Varësia dhe likuidimi për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin nga Bashkia Tiranë, do të rrisë sigurinë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.*

- Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interest ndëmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

Në zbatim të pikës 1/ç të Programit të Auditimit në Bashkinë Tiranë, nga audituesit e KLSH-së u krye auditimi i zbatimit të procedurave të koncensionit me objekt: "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1".

A. Mbi procedurat e PPP, për përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore

- Në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Kryetari i Bashkisë Tiranë ka ngritur Komisionin për ndjekjen e procedurave të Koncesionit/PPP, për përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë, në zonat Tirana 1. Ngritja e komisionit për PPP mbeshtetet në nenin 8, pika 2, neni 9, pika 1 nënpika 1.1, shkronja ñbò, neni 23 pika 11, nenit 33, shkronja ñçò, nenit 64 shkronja ñaò të ligjit nr. 139/2015 ñPër vetqeverisjen vendoreò neni 18 të ligjit nr. 125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin publik privatò të ndryshuar, Vendimit nr. 575 datë 10.07.2013 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion/PPPò, të ndryshuar, Vendimit nr. 353, datë 19.04.2017 të Këshillit të Ministrave ñPër caktimin e autoriteteve kontraktore për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat për dhënien me koncesion/ parteneritet publik privat, të projektit me objekt ñ*Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës*ò, si dhe në vazhdimësi të korespondencave nr. Prot. 12633/1, datë 10.04.2018, nr. 17330 prot. Datë 03.05.2018, të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe me shkresën nr. 4644/1 prot. Datë 31.05.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë drejtuar Bashkisë Tiranë. Komisioni për ndjekjen e procedurave përbëhet nga: [- Drejtori i Përgjithshëm i Punëve Publike, ñT.T.ò; - Drejtori i Përgjithshëm i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ñD. B.ò; - Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar, ñJ.H.ò; - Drejtori i Përgjithshëm Juridik, i Aseteve dhe Licensimit, ñL.D.ò; - Drejtori Juridik, ñA.D.ò; - Drejtori i Prokurimeve, ñJ.Z.ò; - Përfaqësues i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ñA.A.ò; - Përfaqësues i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ñA.P.ò; - Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ñM.B.ò].

Për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit grupi auditimit u mbështet në:

- VKM nr. 575, datë 10.07.2013, ñPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/PPPò. Ligji 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. Kontrata e Koncesionit/PPP me nr. Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 **(**protokolluar nx BT me nr. Prot. 10586, datë 11.10.2018**)** ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1.

Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve me datë nr. 04.11.2018 ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1ò e lidhur ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe mbikëqyrësit. Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimitò ndryshuar; UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; etj,.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, mbi dokumentet e procedurës konkurruese, konstatohet:

Komisioni ka hartuar dokumentet e procedurës konkurruese, në zbatim të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, ñPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/PPPò, në zbatim të ligjit 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Të dhëna për procedurën:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin ekatër objekteve arsimore në Zonën Tirana 1*		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit ñI hapurò REF-32396-11-02-2017	**1.1 Njësia për ndjekjen e procedurave të koncesionit/partenriteti publik privat** Z. T.T., Z. D.B., Znj. L.D., Z. J.Z., Znj. J.H., Znj. A.P., Znj. M.B., Z. E.M., Z. E. M.	
4. Fondi i llogaritur për projektim, ndërtim, mbikqyrje , mobilim (pa tvsh) **1.940.859.276** lekë me marzh fitimi 6,28 % në vit	**5. Oferta fituese (pa tvsh)** 1,940,622,572 lekë	**6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 236,704 lekë
7/1 Data e hapjes së procedurës Data 08.01.2018 **7/2 Kohezgjatja e kontrates, 7 vite e 18** muaj	**8. Burimi Financimit** Fillimisht Konecsionari, dhe me pas Bashkia Tirane për 7 vite me marzh fitimi	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër **4** b) Sõkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE

Në këtë Lot, janë përcaktuar ***5 tipe kryesore shkollash***, nga të cilat 3 shkolla në Njësinë Administrative (në vijim ñNjAò) nr. 11 dhe 2 shkolla në NjA nr. 9 dhe konkretisht:
Sheshi 9/1: (Shkolla 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkolla 2, Tip 4).
Sheshi 11/1: (Shkolla 3, Tip 2 + Kopësht dhe Shkolla 4, Tip 4).
Sheshi 11/2: (Shkolla 5, Tip 2 + Kopësht).
Sipas studimit të fizibilitetit janë përcaktuar përllogaritjet e kostove direkte të investimit për projektim, ndërtim, mbikqyrje, kolaudim bashkë me kostot e mobilimit dhe të mirëmbajtjes. Këto përllogaritje të vlerave të kostove, janë vendosur si kritere të vecanta kualifikuese në lidhje me aftësinë zbatuese të koncesionarit mbi punët, projektet dhe furnizimet e ngjashme. Në fakt publikimeve në APP dhe analizës së fizibilitetit *2,364,385,597 lekë pa TVSH*.
Nga auditimi i dokumenteve të procedurës së koncesionit, nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik. Kërkesat e veçanta të kualifikimit nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Sipas DSK kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit.
Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:
Eksperiencë në Ndërtim
a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **30% e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 419.987.432 lekë pa TVSH (pasi kosto e ndërtimit është 1,399,958,107 lekë, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. **Ose**
b. Punë të ngjashme deri nëe një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo më të vogel sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2.799.916.214 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.
Sa më sipër, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet:
a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50% e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Pra AK ka ndryshuar pikën a, të punëve të ngjashme për një objekt nga 50 % në 30 % dhe ka lënë të pandryshuar pikën ñbò me shumë objekte në dyfishin e vlerës. Veprimi i mësipërm favorizon operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30

% të vlerës dhe vështirësia e pjesmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit.
Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni prokurimit publik.

-Në pikën **2.1** AK kërkon Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim ku të përfshihen kategorite: 2/a (Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale ï turistike - vepra arti në infrastrukturë.), 2/b (Projektim arkitektonik për objekte sportive) 2/d (Projektim peisazhi,sistemim siperfaqe të gjelberta, lulishte e parqe) 3/a (Objekte civile - industriale ï turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.), 3/c(Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme ï metalike ï 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.) 4/a (Instalime hidrosanitare.), 4/b (Instalime termoteknik ï ventilimi ï kondicionimi, 4/c (Linja e rrjeta elektrike-telefonike-radiotelefoni-citofoni-sistem alarmi-televiziv etj, për objekte civile, industriale, turistike), 6/a (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)
8/a (Bazamente gjeodezike - rivelime në të gjitha shkallët), 8/b (Projektim fotogrametrik - hartografik - topografik.), 9/a (Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.), 10/c (Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike - diellore- era etj.), 10/e (Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.) 11/a (Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore).
- Në pikën **2.2** AK kërkon që Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencat profesionale të stafit kryesor përgjegjës *për zbatimin e kontratës* në kategorite si më poshte shenuar, shoqëruar patjeter me CV, kontratat individuale të punes (të vlefshme), si dhe stafi i mëposhtëm duhet të ketë eksperiencë të paktën *5 vite në sektoret përkatës*.
1. Projektues Arkitekt me Kat 2/a/b-1-2/d (Projektim arkitekturor për objekte banimi - industriale ï objekte turistike, objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara, qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore, projektim peisazhi, sistemim siperfaqe të gjelberta, lulishte e parqe).
2. Projektues Konstruktor me Kat 3/a/c ï 1 - 2 (Objekte civile - industriale ï turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate, 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme ï metalike ï 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët)
3. Projektues Instalator me Kat 4/a/b/c (Projektim të Instalimeve hidrosanitare, Projektim të Instalimeve termoteknike ï kondicionimi, si dhe impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burme të rinovueshme, projektim të linjave e rrjeteve elektrike për objekte civile, industriale).
4. Projektues Rrugë-Hekurudha me Kat 6/a. (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)
5. Projektues Gjeodet me Kat 8/a/b (Rivelime inxhinierike, rivelime inxhinierike kadastrale).
6. Projektues gjeologo inxhinierik ï hidrogjeologjiko me Kat 9/a (Studim/Vlerësim gjeollgo inxhinierik i truallit për objekte civile ï ekonomike deri 5 kate)
7. Projektues i Impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike me Kat. 10/c/e (Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme ï diellore ï era etj, Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës ï linja të tensionit të ulët ï të mesëm)
8. Projektues të sinjalizimit rrugor me Kat 11/a (Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime).

Sa më sipër, në lidhje me pikën 2.2, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për cdo inxhinier në zbatim licensa e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues janë kërkuar gjithashtu edhe licensat e projektimit.
Gjithashtu Vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi:

Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë.

-Në pikën **5** Ak ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë *<u>për të pakten 6 (gjashte) muajt e fundit</u>*, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, punonjesit si me poshte: Arkitekt 2 (dy) Inxhinier Ndertimi 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik 1(një) Inxhinier Topograf / Markshaider / Gjeodet / Gjeomatik 1 (një) Inxhinier Mjedisi 1(një) Inxhinier Mekanik 1(një) Inxhinier Gjeolog 1(një) Inxhinier Elektrik 1(një).

-Në pikën **5.1** përcakton që OE të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne listpagesat e shoqërisë për *<u>6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 50 (dyzet) punonjës</u>* të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten: - Grupi I - 10 (dhjetë) punonjës - Grupi II - 34 (njëzetë e kater) punonjës - Grupi III ï 2 (dy) punonjës - Grupi IV - 2 (dy) punonjës - Grupi V- 2 (dy) punonjës.

Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 40 punonjës me dëshimi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifkime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 20 apo 30 punonjës me ISHTI në listë pagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë.

Ndërkohë, në pikën **5.1.2**. AK kërkon që Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar Inxhinier ï Auditues energjie (1 person) dhe Ekspert zjarrfikes te certifikuar (1 person) të pakërkuar në listëpagesat *<u>6 muajt e fundit,</u>* por kërkon për inxhinierin e eficenses së energjisë duhet të ketë keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme për të pakten periudhen e parashikuar të ndërtimit), Certifikata (Dip) për eficensen e energjise, Diploma, për ekspertin zjarrfikës çertifikata e ekspertit zjarrëfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme për të paktën periudhen e parashikuar të ndertimit. Në analogji me Lotin 4 ñTirana 4ò, eksperti zjarrëfikës dhe audituesi energjisë kërkoheshin të ishin në listëpagesë minimumi 3 muaj.

-Në pikën **6** AK kërkon që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa per *<u>6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm</u>*.

Kërkesa për 1 mjek ka qënë në bazë të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punëò, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 òPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, gërma ñbò dhe pika 4 gërma ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***.

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò. Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Në analogji me Lotin 4 ñTirana 4ò, nuk kërkohet që çdo anëtar i BOE të ketë mjek.

-Në pikën **19**. AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjestim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshembajtje te pakten 850 kg ne 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinc. Është kërkuar Fabrike Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet të paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqëruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerase duhet të jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.* Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë. *Në lidhje më këtë kërkesë AK duhet të shtonte specifikimin për kontratë furnizimi me fabrikën e betonit.*

Në fund të kërkesave për Operatorët Ekonomikë, AK kërkon që OE pjesmarrës në procedurën koncesionare /PPP duhet tõ ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedurë Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet.
Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe* *që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe* *që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit* *që do të kolaudojë.*

B. Mbi vlerësimin e ofertave.

Sipas njoftimit të fituesit datë 01.02.2018, konstatohet se në procedurë ka marrë pjesë 4 (katër) operatorë ekonomik sic paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Shoqëria	Oferta për ndërtimin pa TVSH	Kualifikimi
1	ñS.ò shpk	Pa oferte	Sõkualifikuar
2	ñF. s.p.aò	Pa oferte	Sõkualifikuar
3	ñB.ò shpk	1.793.353.970	Sõkualifikuar
4	BOE ñA. K.ò shpk & ñM. E.ò shpk & ñZ. & C.ò shpk	(1.600.861.766 Ndërtimi) + (339.760.806 Mirëmbajtja)	Kualifikuar

Komisioni vendos për të sõkualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomik ñS.ò shpk
2.Operatori Ekonomik ñ F.ò S.P.A

3.Operatori Ekonomik ñB.ò shpk,

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

a- Operatori ekonomik ñS.ò SHPK nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në DSK. Operatori Ekonomik ñS.ò SHPK sôkualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Ofertës Financiare sipas Shtojcës 1 kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të koncensionit për këtë procedurë.

b- Operatori ekonomik ñF. s.p.aò nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit për këtë procedurë. Operatori Ekonomik ñF. s.p.aò sôkualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Ofertës Financiare sipas Shtojcës 1 kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të koncensionit për këtë procedurë.

c- shoqëria ñB.ò shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 9932 Prot. datë 14.11.2017 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në muajin tetor pra pa përfshirë faturën koherente të muajit tetor 2017 dhe Nentor 2017. Refruar Nenit 9 (ñPagesa dhe afati për kryerjen e sajò), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 ñPër miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarëò, përcaktohet shprehimisht që: ñKlienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për proçedurën e prokurimit konkretisht muajin Tetor 2017, Nentor 2017. Pra Operatori ekonomik ñB.ò shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma ñfò të vendosur në DSK, côka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma ñcò ku ndër të tjera citohet se òMosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, tëkonfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.ò

2. Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3 të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit/PPP/Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1 gërma a.

3. Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga taksave vendore për Bashkinë Tiranë të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, 2017.

4. Operatori Ekonomik në përputhje të kapacitetit teknik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë që të vërtetojë përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik (a. Eksperiencë në Ndërtim, b.Eksperiencë në mirëmbajtjeje, c.Eksperiencë në Projektim, d.Eksperiencë në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve , orendi dhe paisjeve laboratorike). Shoqëria B. shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave në Ndërtim, në mirëmbajtjeje, c.në Projektim, në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve, orendi dhe paisjeve laboratorike) për të realizuar kontratën për këtë procedurë Koncesioni/PPP.

5. Shoqëria B., nuk ka paraqitur Liçencë të shoqërisë për projektim të vlefshme.

6. Nuk ka paraqitur Liçencsa profesionale të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.

7. Në liçencën e shoqërisë i mungojnë kategoritë NS-9C dhe NS-18.

8. Në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr. Prot TR00045597, datë 05.12.2017 për muajt Shtator 2015-Shtator 2017 si dhe në list pagesat për periudhën Shtator 2015-Shtator 2017, rezulton të ketë një numër mesatar prej 43 punonjësish.

9. Nuk ka paraqitur asnjë punonjes të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.
10. Nuk ka paraqitur elektronikisht inxhinier auditues dhe nuk ka paraqitur ekspert zjarrfikës si staf të punësuar pranë shoqërisë.
11. Nuk ka paraqitur Certifikaten PAS 99-2012 (e vlefshme), certifikatë ISO 27001-2013 (e vlefshme), certifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme),ISO EN3843-2-2006 (e vlefshme).
12. Në shtojcën 8 dhe OE ka paraqitur dokumemtacion të saktë vetëm për kamionçinën më targë TR 4169 K me tonazh 3.1 TON.
13. Nga verifikimi i dokumentatve të koncesionit të ngarkuara në sistemin elektronik të app-së rezulton se shoqëria B. shpk nuk ka paraqitur asnjë shoqëri supervizioni apo kolaudator ashtu siç edhe është kërkuar nga AK.
Bashkia Tiranë lajmëron se oferta e paraqitur më datë 08.01.2018 nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ñA. K.ò shpk & ñM. E.ò shpk & ñZ. & C.ò shpk, për marrjen me koncesion/PPP te objektit ñPër Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e TiranësñPër Projektimin , Financimin,Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1ò është pranuar dhe ankesa nuk ka patur.
- Kontrata e punës publike me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 **(**protokolluar nr BT me nr. Prot. 10586, datë 11.10.2018**)** të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Bashkisë Tiranë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik midis shoqërive J.V ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK, që në vijim do të quhet ñKoncesionariò formuar sipas Aktmarrëveshjes Nr. 5937 Rep, Nr. 1701 Kol datë 28.12.2017 pranë noteres N. P.Gj. me këto të dhëna:
- Shoqëria ñA. K.ò SHPK, me nr. NIPPT K21622001M dhe licencë N.4194/6, datë 04.12.2019 me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. A. Ç..
- Shoqëria ñM-Eò SHPK, me nr. NIPPT-I L52025007R, me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. G. M..
- Shoqëria ñZ. & C.ò SHPK, me nr. NIPPT K61731002D dhe licencë N.0433/17, datë 25.10.2018 me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. A. P..
Me datë 28.12.2017 me nr. 5937 rep dhe nr. 1701 kol është lidhur Akt -Marrëveshje për bashkëpunim të përkohshëm midis OE ñA. K.ò SHPK, OE ñM-Eò SHPK & OE ñZ. & C.ò SHPK me objekt formimin e një shoqërie të tipit Joine Venture (JV) ku përfaqësuesi i BOE është vendosur shoqëria ñ**A. K.**ò SHPK. Për sigurimin e këtij bashkëpunimi të dy palët marrin përsipër që në kuadrin e pjesëmarrjes në tenderin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò për projektimin, financimin, ndërtimin, mobilimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e pesë objekteve arsimore në zonën Tirana 1, të përmbushin detyrimet:
- Shoqëria ñA. K.ò SHPK të kryejë punimet në masën 86.95 % të punimeve totale.
- Shoqëria ñM. E.ò SHPK të kryejë punimet në masën 12.90 % të punimeve totale.
- Shoqëria ñZ. & C.ò SHPK të kryejë punimet në masën 0.15 % të punimeve totale.
Me datë 17.11.2019 me nr. 4867 rep dhe nr. 1407 kol, është hartuar Shtesë Kontrate për Akt Marrëveshjen për BPOE nr. 5937 rep/1701 kol datë 28.12.2017 mes palëve kontraktuese: ñA. K.ò SHPK, OE ñM-Eò SHPK & OE ñZ. & C.ò SHPK, me objekt se shoqëria ñA. K.ò SHPK do të jetë subjekti ndërtues që do të realizojë 100 % të ndërtimit të objektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës ñPër projektimin, financimin, ndërtimin, mobilimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e pesë objekteve arsimore në zonën Tirana 1ò në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektet e miratuara nga AK.

Vlera totale e kontratës koncesionare dhe pagesa e koncesionit.
Ndërtimi i shkollave dhe punimet e ndërtimit do të realizohen me financimin e koncesionarit, i cili merr përsipër riskun dhe koston e investimit për zbatimin e objektit të kësaj kontrate, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në të, duke patur parasysh se në përputhje me DSK dhe

ofertën e koncesionarit, AK ka marrë përsipër tõi paguaj koncesionarit vlerën prej **1,940,622,572**lekë pa TVSH ose **2,328,747,087.40** lekë me TVSH. Marzhin e fitimit në masën **6.28 %,** që përllogaritet çdo vit mbi vlerën e mbetur të investimit direkt dhe mbi koston vjetore të mirëmbajtjes, të përllogaritur sipas kalendarit të pagës në Aneksin.
Koncesionari ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK me datë 17.10.2018, me numër serie 71466673 ka siguruar kontratën koncesionare në kompaninë e sigurimit Albsig, në shumën **283,691,523** lekë me TVSH (10% e vlerës së kontratës), si kusht për sigurimin e egzekutimit të kontratës së sipërmarrjes. Me datë 05.11.2018 dhe nr. 4690 rep, nr. 1395 kol është mbajtur Kontratë Garancie ndërmjet shoqërisë së sigurimeve ñAlbsigò SHA përfaqësuar nga z. M. B. dhe shoqërisë ñA. K.ò SHPK përfaqësuar nga z. A. Ç..
- Shoqëria Koncesionare ñA. K.ò SHPK ka paraqitur pranë BT shkresën me nr. Prot. 39681/1, datë 25.10.2018 mbi propozimet e saj në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 i kontratës nr. 9513 rep, nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 për mbikëqyrës punimesh subjektet I. shpk, KKG Project shpk, Joint Venture ñD-Eò shpk & ñ Y.A.ò, si dhe propozimin në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, neni 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò i kontratës nr. 9513 rep, nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 për kolaudator punimesh, T. shpk, K. shpk, T. shpk.
- Me datë 29.10.2018 Drejtori i Përgjithshëm të Punëve Publike në BT me shkresën me nr. 39681/2 prot (datë 27.10.2020) i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 1ò se duke marrë parasysh reputacionin personal, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit zgjidhen:

1.Për mbikëqyrës punimesh JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò
2.Për kolaudator ñT.ò SHPK.

Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò është lidhur ndërmjet shoqërisë koncesionare ñZ.M.Aò shpk.
<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Shoqërinë koncesionare Tirana 1 dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>
Ndërkohë në ofertën e koncesionarit, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 14,161,791 lekë pa TVSH ose 16,994,149 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 561,098 lekë pa TVSH ose 673,318 leke me TVSH. Në total vlerë është **14,722,889 lekë pa TVSH** ose **17,667,467 lekë me TVSH.**
Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimve është ose konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, etj.

Sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur mbi përzgjedhjen e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, rezulton:
-Mbikëqyrësi JV ñ**D-E**ò SHPK & ñ Y.A.ò dhe kolaudatorit i punimeve ñ**T." SHPK** të propozuar nga koncensionari ñZMAò SHPK dhe të përzgjedhur nga AK për kontratën koncesionare me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018, Kreu V, Pika 5, Nënpikat 5.1.1/5.1.2 (për mbikëqyrësin) dhe Kreu V, Pika 5.2, Nënpikat 5.2.1 dhe 5.2.2 (për kolaudatorin) është në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse propozimi për 3 (tre) shoqëritë mbikëqyrëse dhe

kolauduese të punimeve të propozuar nga Koncesionari dhe shoqëria e përzgjedhur për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve nga NjZP apo nga AK Bashkia Tiranë, nuk është bazuar në argumente që vertetojnë përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën e tyre.
Për emërimin/përzgjedhjen e mbikëqyrësit dhe/ose kolaudatorit, nuk ka asnjë dokument si, shkresë apo raport vlerësimi që të pasqyrojë propozimin e bërë nga NJZP apo të AK duke marrë parasysh eksperiencën, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit.
Ky veprim është në kundërshtim me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 7 i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë***...ò, dhe Nenin 12, i cili thekson se: ñ...*Koladatori i objektit i kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë***...ò. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.
Kontrata e lidhur për mbikëqyrjen e punimeve me datë 27.10.2020 ndërmjet Koncensionarit " SH.K.T4." SHPK dhe shoqërisë mbikëqyrëse "A.MK." SHPK është një kontratë e thjeshtë dhe jo Noteriale, dhe mbi të gjitha nuk buron nga zhvillimi i një procedure prokurimi sipas ligjit nr. 9643, datë datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar*, ku punëdhënës është " SH.K.T4." SHPK dhe punëmarrës është shoqëria "A.MK." SHPK. Pra në rastin konkret, shoqëria "A.MK." SHPK në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve është propozuar nga " SH.K.T4." SHPK dhe për punën e kryer do të paguhet në vlerë j* **17,667,467 lekë me TVSH** *po nga " SH.K.T4." SHPK dhe jo nga Autoritetu Kontraktues Bashkia Tiranë, duke bërë të mundur përdorimin jo me efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kontratën Koncesionare .*

►**Titulli i gjetjes: Kërkesat kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë.**

Situata: Kërkesat e veçanta të kualifikimit për objektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën **Tirana 1**ò, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Sipas DSK kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit. - Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Eksperiencë në Ndërtim
a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **30% e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 307,075,859 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. **Ose**
b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo me te vogel sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2,047,172,392 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.
Sa më sipër, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50% e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Pra Ak ka ndryshuar pikën a, të punëve të ngjashme për një objekt nga 50% në 30% dhe ka lënë të pandryshuar pikën b me shumë objekte në dyfishin e vlerës. Veprimi i mësipërm favorizon operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30 % të vlerës dhe vështirësia e pjesmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit.
Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni prokurimit publik.
- Në lidhje me pikën **2.2**, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për cdo inxhinier në zbatim licensa e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues janë kërkuar gjithashtu edhe licensat e projektimit. Gjithashtu Vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi:
Mbështetur në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori license i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë.
- Në pikën **5** Ak ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë *për të pakten 6 (gjashte) muajt e fundit*. Në pikën **5.1** përcakton që OE të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne listpagesat e shoqërisë për *6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 50 (dyzet) punonjës* të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI
Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 50 punonjës me dëshimi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifkime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 30 apo 40 punonjës me ISHTI në listë pagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë.
- Në pikën **6**, kërkohet që Operatori/et Ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, ***1 mjek***, bazuar në bazë të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin në punëò, VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 òPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, gërma ñbò dhe pika 4 gërma ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***. Pra kërkesa e mjekut është shfuqizuar.
Në pikën **19**. AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjestim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshembajtje te pakten 850 kg ne 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinc. Është kërkuar Fabrike Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet të paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqëruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerase duhet të jete e noterizuar, ku*

të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë. *Në lidhje më këtë kërkesë AK duhet të shtonte specifikimin për kontratë furnizimi me fabrikën e betonit.*
Kriteri: VKM nr. 575, datë 10.07.2013, ñPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/PPPò. Ligji 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit duke fazorizuar operatorë ose bashkim operatorësh të caktuar
Shkaku: Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 ñPër prokurimin publikòi ndryshuar
Rëndësia: E Lartë
Rekomandime: Bashkia Tiranë, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve për Lotet 2 dhe 3 që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriteret në lidhje me punët e ngjashme, stafin teknik, licensat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurenca. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

►**<u>Titulli i gjetjes:</u> Përcaktimi i mbikëqyrjesit dhe kolaudatorit në kundështim me aktet ligjore.**

Situata: Në Dokumentet Standarte të Koncesionit kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesmarrës në procedurën koncesionare /PPP duhet ti ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.*
- Me datë 29.10.2018 Drejtori i Përgjithshëm të Punëve Publike në BT me shkresën me nr. 39681/2 prot (datë 27.10.2020) i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 1ò se duke marrë parasysh reputacionin personal, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit zgjidhen:

1. Për mbikëqyrës punimesh JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò
2. Për kolaudator ñT.ò SHPK.

Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1ò është lidhur ndërmjet shoqërisë koncesionare ñZ.M.Aò shpk.

<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Shoqërinë koncesionare Tirana 4 dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>

Ndërkohë në ofertën e koncesionarit, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 14,161,791 lekë pa TVSH ose 16,994,149 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 561,098 lekë pa TVSH ose 673,318 leke me TVSH. Në total vlerë është **14,722,889 lekë pa TVSH** ose **17,667,467 lekë me TVSH.**

Pra sa më sipër, konstatohet konfikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimve është ose konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, etj.

Vlera prej **17,667,467 lekë me TVSH** *që do t'i paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.*

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Përdorime të fondeve publike pa efektivitet dhe eficensë.

Shkaku: Kërkesë mbi përcaktimin e mbikëqyrjesit dhe kolaudatorit në kundështim me aktet ligjore.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: - Bashkia Tiranë, të marrë masa nëpërmjet një grupi të vecantë pune, të analizojë vlerën **17,667,467 lekë me TVSH** të mbikëqyrjes dhe kolaudimit, ku mbikëqyrjesi dhe kolaudatori të paguhet nga Bashkia Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi. *Varësia dhe likuidimi për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin nga Bashkia Tiranë, do te rrisë sigurinë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.*

- Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interest ndëmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

d. MONITORIMI DHE ZBATIMI I KONTRATAVE TË KONCESIONIT/PPP, NDËRTIMI I SHKOLLAVE, BASHKIA TIRANË.

d/1. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të kontratës me Koncesion/PPP (PP) me objekt: "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1", rezultoi:

Të përgjithshme:

BT në kuadër të përmbushjes së përgjegjësive të saj për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, si dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimore parashkollor në kopshte dhe çerdhe, synon të përmirësojë infrastrukturën arsimore në Tiranë, duke ndërtuar shkolla të reja në mënyrë që tâu jepet një zgjidhje përfundimtare problemeve me të cilat përballet sistemi arsimor në BT, si zhvillimi i mësimit me dy turne, mbipopullimi i shkollave, etj. BT ka kryer procedurat ligjore dhe procedurat përzgjedhëse konkurruese, bazuar në ligjin nr. 125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin publik privatò të ndryshuar, në lidhje me propozimin e kërkuar për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në BT ñPër Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 ò si vijon:

Loti 1 përfshin 5 shkolla, nga të cilat 3 shkolla në Njësinë Administrative (në vijim ñNjAò) nr. 11 dhe 2 shkolla në NjA nr. 9 dhe konkretisht:

Sheshi 9/1, Rruga ñEshref Frashëriò (Shkolla 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkolla 2, Tip 4).
Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodicaò (Shkolla 3, Tip 2 + Kopësht dhe Shkolla 4, Tip 4).
Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Notiò (Shkolla 5, Tip 2 + Kopësht).

<u>Kontratat (Sipërmarrje, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve).</u>

- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 (protokolluar në BT me nr. Prot. 10586, datë 11.10.2018) të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Bashkisë Tiranë (në vijim ñBTò) përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj, nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (në vijim ñMASRò) përfaqësuar nga Ministri Znj. Lindita Nikolla dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik midis shoqërive J.V ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK, që në vijim do të quhet ñKoncesionariò formuar sipas Aktmarrëveshjes Nr. 5937 Rep, Nr. 1701 Kol datë 28.12.2017 pranë noteres N. P.Gj. me këto të dhëna:

Shoqëria ñA. K.ò SHPK, me nr. NIPPT K21622001M dhe licencë N.4194/6, datë 04.12.2019 me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. A. Ç..

Shoqëria ñM-Eò SHPK, me nr. NIPPT-I L52025007R, me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. G. M..

Shoqëria ñZ. & C.ò SHPK, me nr. NIPPT K61731002D dhe licencë N.0433/17, datë 25.10.2018 me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. A. P..

Me datë 28.12.2017 me nr. 5937 rep dhe nr. 1701 kol është lidhur Akt -Marrëveshje për bashkëpunim të përkohshëm midis OE ñA. K.ò SHPK, OE ñM-Eò SHPK & OE ñZ. & C.ò SHPK me objekt formimin e një shoqërie të tipit Joine Venture (JV) ku përfaqësuesi i BOE është vendosur shoqëria ñA. K.ò SHPK. Për sigurimin e këtij bashkëpunimi të dy palët marrin përsipër që në kuadrin e pjesëmarrjes në tenderin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò për projektimin, financimin, ndërtimin, mobilimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e pesë objekteve arsimore në zonën Tirana 1, të përmbushin detyrimet:

-Shoqëria ñA. K.ò SHPK të kryejë punimet në masën 86.95 % të punimeve totale.
-Shoqëria ñM. E.ò SHPK të kryejë punimet në masën 12.90 % të punimeve totale.
-Shoqëria ñZ. & C.ò SHPK të kryejë punimet në masën 0.15 % të punimeve totale.

Me datë 17.11.2019 me nr. 4867 rep dhe nr. 1407 kol, është hartuar Shtesë Kontrate për Akt Marrëveshjen për BPOE nr. 5937 rep/1701 kol datë 28.12.2017 mes palëve kontraktuese: ñA. K.ò SHPK, OE ñM-Eò SHPK & OE ñZ. & C.ò SHPK, me objekt se shoqëria ñA. K.ò SHPK do të jetë subjekti ndërtues që do të realizojë 100 % të ndërtimit të objektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës ñPër projektimin, financimin, ndërtimin, mobilimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e pesë objekteve arsimore në zonën Tirana 1ò në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektet e miratuara nga AK.

Projekti është hartuar nga ñBOERIò Stefano Boeri dhe Architeti ñA. K.ò SHPK & ñZ. & C.ò SHPK. Bazuar në pikën 1.1 ñPalëtò të Kontratës Nr. 9513 Rep, Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 me palë kontraktuese Bashkia e Tiranës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues do të përfaqësohet nga Bashkia e Tiranës.

<u>Vlera totale e kontratës koncesionare dhe pagesa e koncesionit.</u>

Ndërtimi i shkollave dhe punimet e ndërtimit do të realizohen me financimin e koncesionarit, i cili merr përsipër riskun dhe koston e investimit për zbatimin e objektit të kësaj kontrate, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në të, duke patur parasysh se në përputhje me DSK dhe ofertën e koncesionarit, AK ka marrë përsipër tâi paguaj koncesionarit vlerën prej **1,940,622,572.83** lekë pa TVSH ose **2,328,747,087.40** lekë me TVSH, që përmban komponentët e mëposhtëm:

- Vlera e investuar nga koncesionari për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe kosto mirëmbajtje të barabartë me **1,600,861,766.83** lekë pa TVSH ose **1,921,034,120.19** lekë me TVSH.
- Vlera e investuar nga koncesionari për shërbimet e mirëmbajtjes së objekteve arsimore deri në fund të kontratës, të barabartë me **339,760,806** lekë pa TVSh ose **407,712,967.2** lekë me TVSH.
- Marzhin e fitimit në masën **6.28 %,** që përllogaritet çdo vit mbi vlerën e mbetur të investimit direkt dhe mbi koston vjetore të mirëmbajtjes, të përllogaritur sipas kalendarit të pagës në Aneksin 3 (ñ*Vlera totale e kontratës*ò).
- AK do dâi paguajë koncensionarit si kontribut në këtë PPP për realizimin e ndërtimeve dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore për gjithë kohëzgjatjen e koncesionit, një shumë totale të barabartë me 2,364,096,027 lekë pa TVSH, në përputhje me shumat dhe afatet e përcaktuara në kalendarin e pagesave në Aneksin 3.
- Koncesionari ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK me datë 17.10.2018, me numër serie 71466673 ka siguruar kontratën koncesionare në kompaninë e sigurimit Albsig, në shumën 283,691,523 lekë me TVSH (10% e vlerës së kontratës), si kusht për sigurimin e egzekutimit të kontratës së sipërmarrjes. Me datë 05.11.2018 dhe nr. 4690 rep, nr. 1395 kol është mbajtur Kontratë Garancie ndërmjet shoqërisë së sigurimeve ñAlbsigò SHA përfaqësuar nga z. M. B. dhe shoqërisë ñA. K.ò SHPK përfaqësuar nga z. A. Ç..

<u>Kohëzgjatja e koncesionit.</u>

- Kontrata e Koncesionit (në vijim ñKKò) do të ketë një kohëzgjatje totale prej 8 (tetë) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit *(17.10.2018*). Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të filluar punimet e ndërtimit dhe ofruar shërbimet e mirëmbajtjes janë të kushtëzuara nga dorëzimi i shesheve me dokumentacionin përkatës të sheshit (ñ*Data e fillimit*ò).
- Afati i ndërtimit (pika 2.4.3) të kontratës së shkollave duhet të përfundohet <u>*brenda*</u> një afati prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të punimeve (neni 4 i kontratës). Afati i ndërtimit do të quhet se është plotësuar në datën kur është lëshuar *Akti i Kolaudimit* në përputhje me ligjin e zbatueshëm.
- Pas ndërtimit dhe vënies në funksion të objekteve arsimore, kontrata do të mbetet në fuqi edhe për 7 (shtatë) vjet (2.4.2) nga data e ìertifikimit të ndërtimit, për mirëmbajtjen e objekteve arsimore.

<u>Procedura e lidhjes së kontratës së mbikëqyrësit të punimeve.</u>

- Shoqëria Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK ka paraqitur pranë BT shkresën me nr. Prot. 39681/1, datë 25.10.2018 mbi propozimet e saj në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 i kontratës nr. 9513 rep, nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 për mbikëqyrës punimesh subjektet e mëposhtme:

1. ñI.ò shpk
2. KKG Project shpk

3. Joint Venture ñD-Eò shpk & ñ Y.A.ò,

si dhe propozimin në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, neni 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò i kontratës nr. 9513 rep, nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 për kolaudator punimesh si vijon:

1. ñT.ò shpk
2. ñK.ò shpk
3. ñT.ò shpk

- Me datë 29.10.2018, z. ñT.T.ò në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Punëve Publike në BT me shkresën me nr. 39681/2 prot (datë 27.10.2020) i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 1ò se duke marrë parasysh reputacionin personal, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit zgjidhen:

1. Për mbikëqyrës punimesh JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò
2. Për kolaudator ñT.ò SHPK.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të kontratës koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò është lidhur kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 26 prot, datë 04.11.2018., ndërmjet shoqërisë koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me NIPT L81729026T, përfaqësuar nga administratori Z. E. B. dhe mbikëqyrësit Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò, krijuar me aktmarrëveshjen Nr. Ekstra Prot, datë 27.12.2017, me këto të dhëna:

Shoqëria ñDerbi-Eò SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K77916947A përfaqësuar nga administratori Z. ñB. D.ò, në fushën e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit MK.1713/5 datë 05.05.2016.

Z. ñ Y.A.ò, person fizik shqiptar, me NIPT K43014201S, me licencë në fushën, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit MK. 0678/2 datë 17.09.2012. Në zbatimin e kësaj kontrate BOE do të përfaqësohet nga Z. ñ Y.A.ò. Vlera e kësaj kontrate është 14,161,791 lekë pa TVSH ose 16,994,149.20 lekë me TVSH. Afati i përgjithshëm për realizimin e objektit të kësaj kontrate fillon me firmosjen e kontratës dhe përfundon me lëshimin e ì ertifikatës finale të përfundimit nga AK.

<u>Problematika të konstatuara:</u>

1. Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë dispozision grupit të auditimit, konstatohet se nuk ka asnjë dokument si; shkresë apo raport vlerësimi e cila të pasqyrojë propozimin e bërë nga NjZP mbi përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punime dhe kolaudatorit duke marrë parasysh eksperiencën, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Po cilat janë rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit mbështetur në ligjin e zbatueshëm?.

Po tëi referohemi kuadrit ligjor të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, konkretisht: Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, UKM nr. 354, datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò zgjedhja e mbikëqyrësit të punimeve dhe koladatorit, duhej të ishte vepruar ndryshe, argumentuar si vijon:

- Autoriteti Kontraktues (BT) në kontratën për punë publike me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018, Kreu V, Pika 5, Nënpikat 5.1.1/5.1.2 i kanë krijuar/dhënë komoditetin Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK, për të zgjedhur dhe paraqitur në BT subjekte mbikëqyrëse punimesh ndërtimi, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse 3 (tre) shoqëritë mbikëqyrëse të punimeve të propozuar nga Koncesionari dhe shoqëria e përzgjedhur për mbikëqyrjen e punimeve është vepruar pa argumentuar përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën nga AK Bashkia Tiranë. Parashikimi në KK Kreu V, pika 5 mbi caktimin e mbikëqyrësit të punimeve si dhe rruga e ndjekur nga AK për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve rezulton e tillë që Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria JV ñ**D-E**ò SHPK & ñ Y.A.ò rezulton në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë Koncesionare , fakti që kjo shoqëri është propozuar nga Shoqëria Koncesionare **"Z.M.A**ò SHPK dhe do të paguhet nga nga kjo shoqëri Koncesionare . Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 7 i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë***...ò.
- Autoriteti Kontraktues (BT) në kontratën për punë publike me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018, Kreu V, Pika 5.2, Nënpikat 5.2.1 dhe 5.2.2 i kanë dhënë komoditetin koncesionarit shoqërinë SPV ñ**SH.K.T1.**ò SHPK, për zgjedhur dhe paraqitur në BT subjekte kolauduese punimesh ndërtimi, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse 3 (tre) shoqëritë kolauduese të punimeve të propozuar nga Koncesionari dhe shoqëria kolauduese e përzgjedhur për kolaudimin është vepruar pa argumentuar përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën nga AK Bashkia Tiranë. Parashikimi në Kontratën Koncesionare Kreu V, pika 5.2 mbi caktimin e kolaudatorit të punimeve si dhe rruga e ndjekur nga AK për caktimin e kolaudatorit të punimeve rezulton e tillë që Kolaudatori i punimeve shoqëria ñ**T." SHPK** rezulton në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë Koncesionare , fakti që kjo shoqëri është propozuar nga Shoqëria Koncesionare **"Z.M.A**ò SHPK dhe do të paguhet nga nga kjo shoqëri Koncesionare . Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 12, i cili thekson se: ñ...*Koladatori i objektit i kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse për kolaudim punimesh* ***dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë***...ò. Sa më sipër mgarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.

Leje të ndryshme, si Leje Zhvillimore, Leje Ndërtimi, Leje Mjedisi. Projektuesi i projektit, Oponenca teknike.

a. Lejet e zhvillimit;

- Kryetari i BT bazuar në (Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave datë 28.02.2020 ndërmjet KKT, përfaqësuar nga Z. ñ E. R.ò dhe BT përfaqësuar nga Z. ñ E. V.ò) me Vendimin VKT. Nr 4 datë 06.04.2020 ka vendosur: Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore, në Bashkinë e Tiranës, zona 1, Sheshi 11/2, rruga òVangjel Notiò në pronë të BT me zhvillues Bashkia Tr dhe subjekt ndërtues ñZ.M.A.ò SHPK si dhe hartën e Pranëvendosjes së strukturave në shkallën 1:500.

Treguesit e zhvillimit:

[Sipërfaqja e përgjithshme e truallit 5,590 m^2; Sipërfaqjaa e truallit e zënë nga struktura 2,800 m^2; Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit 7,800 m^2; Koeficienti i shfrytëzimit 50%; Intensiteti i ndërtimit 1.4; Lartësia maksimale e strukturës 17 m; Numri i kateve mbi tokë 1-2-3-4-5; Numri i kateve nëntokë 0]ô

- Sheshi 11/2 është në një zonë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes, ndodhet pranë qendrës së banuar të zonës dhe ka akses të lehtë. Ky shesh karakterizohet nga një sipërfaqe e sheshtë.

- KKT me Vendimin nr. 07, datë 12.07.2019 ka vendosur: Miratimin e Lejës së Zhvillimit për objektin ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore, në Bashkinë e Tiranës, zona 1, Sheshi 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò si dhe harten e Planvendosjes së strukturave në shkallën 1:500.
Treguesit e zhvillimit:
[Sipërfaqja e përgjithshme e truallit 8963 m^2; Sipfaqja e truallit e zënë nga struktura 3993 m^2; Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit 11900 m^2; Koeficienti i shfrytëzimit 44.5 %; Intensiteti i ndërtimit 1.32; Lartësia maksimale e strukturës 18.15 m; Numri i kateve mbi tokë 1-6; Numri i kateve nën tokë 1]
Kufizimet nga kufiri i pronës:[Nga Jugu: Prona me nr. 1/645; 1/643; 1/642; Nga Veriu: Prona me rrugën ñPaisi Vodicaò; Nga Lindja: Prona me nr. 4/305; 4/227; Nga Perëndimi: Prona me nr. 1/642].
- KKT me Vendimin nr. 08, datë 12.07.2019 ka vendosur: Miratimin e Lejës së Zhvillimit për objektin ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore, në Bashkinë e Tiranës, zona 1, Sheshi 9/1, rruga ñEshref Frashëriò si dhe hartën e Planvendosjes së strukturave në shkallën 1:500.
Treguesit e zhvillimit:
[Sipërfaqja e përgjithshme e truallit 12232 m^2; Sipëfaqja e truallit e zënë nga struktura 3435.4 m^2; Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit 9815 m^2; Koeficienti i shfrytëzimit 28%; Intensiteti i ndërtimit 0.8; Lartësia maksimale e strukturës 24 m; Numri i kateve mbi tokë 1,2,3,4; Numri i kateve nën tokë 0].
Kufizimet nga kufiri i pronës:
[Nga Jugu: Prona me nr.4/174; 4/589; 4/228; 4/289; Nga Veriu: Prona me nr. 4/153; 4/133; 4/132; 4/478; 4/591; Nga Lindja: Prona me nr. 4/305; 4/227; Nga Perëndimi: Prona me nr. 4/165].

3 **Titulli i gjetjes: Vonesa në procesin e zbardhjes së lejeve të ndërtimit dhe vazhdim i punimeve për 5 (pesë) shkolla pa leje ndërtimi, për kontratën me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018.**

Situata: Kryetari i BT, me shkresën me nr. 34277/2, datë 09.10.2019 mbështetur në KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, Kreu IV, Pika 4.4.2, paragrafi ñcò dhe pika 4.5 në pozicionin e zhvilluesit/investitorit, duke përfaqësuar Institucionin Bashkia Tiranë, ka autorizuar Shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK të paraqesë kërkesë dhe të realizojë të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor për projektimin, menaxhimin e dorëzimin e dokumentacionit për aplikim për leje ndërtimi.
- Në vijim, Shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK me shkresën me nr. 21 prot, datë 09.10.2019, autorizon shoqërinë ñA. K.ò SHPK që të përfaqësojë shoqërinë koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK në procedurën e aplikimit për Leje Ndërtimi për objektin: ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, ñZona Tirana 1òò.
Grupit të auditimit deri në fund të auditimit (datë 12.02.2021), nuk ju paraqit zbardhja e lejeve të ndërtimit për 5 (pesë) objektet arsimore që po ndërtohen në sheshtët: Sheshi 9/1, rruga ñEshref Frashëriò; Sheshi 11/2, rruga òVangjel Notiò dhe Sheshi 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò.
Sa më sipër zgjatja/vonesa e procedurës së lëshimit të lejes së ndërtimit dhe ndërkohë vazhdimi i punimeve të ndërtimit për objektet arsimore vazhdon, nuk është në përputhje me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"* të ndryshuar, neni 29 dhe neni 39, dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë.
- Për shkak të zgjatjes së procedurës për Lejen e Ndërtimit nga Bashkia e Tiranës, për objektet arsimore që do të ndërtohen në sheshet e ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò pranë lagjes ñDon Boskoò, në Sheshin 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò dhe në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò, nga mbikëqyrësi i punimeve JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò, nuk janë mbajtur dokumentet teknike si:
- Akt kontrolli në kuotës ± 0.00;

- Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit (në përfundim të kësaj faze);
Kriteri: Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"* të ndryshuar, neni 29 dhe neni 39; VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar; UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 4.
Ndikimi/Efekti: Punime ndërtimi me risk përsa i përket, zbatimit të kushteve urbanistike, kondicioneve urbane dhe zbatimit të treguesve që përcaktohen në lejen e ndërtimit.
Shkaku: Lirimi i shesheve të ndërtimit pjesor dhe me shumë vonesë, për shkak të ekzistencës së pronës private në sheshet e ndërtimit. Neglizhencë e shoqërisë koncesionare ñZ.M.A.ò shpk mbi plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për leje ndërtimi.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandime: Nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, të merren masa të menjëhershme për dhënien e lejeve të ndërtimit për pesë objektet arsimore në lotin 1 ñZonën Tirana 1ò duke mundësuar realizimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit (konformë kushteve urbanistike dhe treguesve zhvillimor për zhvilluesin Bashkia Tiranë), projektin e zbatimit, kushtet teknike të zbatimit dhe të sigurojë cilësinë e objekteve arsimore dhe materialeve të ndërtimit sipas kërkesave të projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

c. Nga auditimi mbi pajisjen me Leje Mjedisi.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM) për zhvillimin e projektit ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranësò me nr. 4687 prot, datë 27.09.2019 (Nr. Identifikimi 969, Vendimi 53) ka lëshuar Vendimin për VNM paraprake për personin juridik ñA. K.ò SHPK përfaqësuar nga z. A. Ç., për vendndodhjen:
Zona 1 ñSheshi 11/1 Rruga ñPaisi Vodicaò Bashkia Tiranë me këto të dhëna teknike.
Sipërfaqja e truallit: 11,890 m^2.
Sipërfaqja e njollës: --- m^2.
Koeficienti i shfrytëzimit: 15%.
Numri i kateve: 5 kate mbi tokë, 1 kat nëntokë.
AKM pas përfundimit të procedurës paraprake të VKM-së, ka vendosur që ky projekt nuk duhet tõ nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar për zhvilluesin.
- AKM, për zhvillimin e projektit ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranësò me nr. 4688 prot, datë 27.09.2019 (nr. identifikimi 970, Vendimi 53) ka lëshuar Vendimin për VNM paraprake për personin juridik ñA. K.ò SHPK përfaqësuar nga z. ñA. Ç.ò, për vendndodhjen:
Shkollat Tip 1 dhe Tip 4 dhe Kopësht në sheshin **9/1** rruga ñEshref Frashëriò pranë rrugës ñDon Boskoò bashkia Tiranë me këto të dhëna teknike.
Sipërfaqja e truallit: 12,985 m^2.
Sipërfaqja e njollës: 3435.4 m^2.
Koeficienti i shfrytëzimit: 15%.
AKM pas përfundimit të procedurës paraprake të VKM-së, ka vendosur që ky projekt nuk duhet tõ nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar për zhvilluesin.
Sa më sipër trajtuar, mund të themi se, në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.07.2014 ñPër përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-sëò, shoqëria ñA. K.ò SHPK ka kryer pagesën 30,000 lekë për një VNM paraprake, pra në total për të 2 (dy) sheshet e ndërtimit ka paguar 2 x 30,000 lekë = 60,000 lekë.
<u>Problematikë e konstatuar:</u>
Referuar llogaritjes së kostos së ndërtimit, Studimin e Fizibilitetit të miratuar nga Titullari i AK përmes Raportit Përmbledhës nr. 34198, datë 09.11.2016, pika 1.3.1.3. ñKostot e tjera të

drejtëpërdrejta të investimitò kosto për leje mjedisore është llogaritur në shumën 150,000 lekë. *Diferenca prej 90,000 lekë duhet të reflektohen në koston direkte të investimit.*

►**Titulli i gjetjes: Zbatimi i punimeve të ndërtimit pa Leje Mjedisi.**

Situata: Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e punimeve sipas Kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 me operator ekonomik fitues shoqërinë Koncesionare ñA. K.ò SHPK për shkollën, Tip 2 + Kopësht që po ndërtohen në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò nga shoqëria Koncesionare nuk është bërë kërkesë për Leje Mjedisi pranë AKM.
Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e zbatimit rezulton se, AKM ka pajisur shoqërinë ñA. K.ò SHPK me leje mjedisi për objektet arsimore që po ndërtohen në sheshin e ndërtimit 11/1 rruga ñPaisi Vodicaò dhe në sheshin e ndërtimit 9/1 rruga ñEshref Frashëriò në vlerën 60,000 lekë dhe jo në vlerën 150,000 lekë siç është llogaritur në rraportin përmbledhës nr. 34198, datë 09.11.2016, pika 1.3.1.3 ñKostot e tjera të drejtpërdrejta të investimitò. Sa më sipër vazhdimi i punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes së mjedisit është në kundërshtim me pikën 4.4.2 germa (c) të kontratës Koncesionare ; ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPer kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimitò i ndryshuar, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë Koncesionare , Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve.
Kriteri: KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò.
Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPer kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimitò i ndryshuar, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Punime ndërtimi me risk përsa i përket, zbatimit të kushteve sipas lejes mjedisore.
Shkaku: Neglizhencë e shoqërisë Koncesionare ñA. K.ò shpk mbi plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për leje mjedisi.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: 8.1. Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tôi kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA. K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për leje mjedisi për objektin arsimor që po ndërtohet në sheshin e ndërtimit 11/2, për të garantuar parandalimin dhe kontrollin për çdo ndikim apo ndotje mjedisore.
8.2. AK Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për lejet mjedisore, duhet të reflektojë diferencën prej 90,000 në koston direkte të investimit në kalendarin e pagesave.

d. Hartimi i Projektit.
Projekti i zbatimit me objekt ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranëò, Sheshi 9/1, rruga ñEshref Frashëriò Tiranë, është hartuar BOE ñStefano Boeri Architettiò, ñA. K.ò SHPK nr. lic N.4194/4 dhe ñZ. & C.ò SHPK Nr. lic. 0433/17.
Projekti arkitektonik: (Ark. ñR. M.ò; Ark. ñF.T.ò; Ark. ñA.Q.(B.)ò).
Projekti Konstruktiv: (Ing. Konstruktor. ñH.K.ò; Ing. ñK.S.ò; Ing. Konstruktor.òR. T.ò).
Projekti Hidroteknik: (Ing. Hidroteknik. ñR. Th.; Ing. Hidroteknik. ñM.M.ò).
Projekti elektrik: (Ing. ñS.P.ò; Ing. ñE.Sh.ò).
Projekti mekanik: (Ing. Mekanik. A. P.; Ing. Mjedisi. ñL.Xh.ò).
Vlerësimi i ndikimit në Mjedis: (Ing. ñE.Q.ò).
Gjeolojgjia dhe sizmika: (Shoqëria ñA.Gj.2000ò; Prof. Dr. ñSh.A.ò; Ing. Gjeolog. ñS.A.ò; Ing. Gjeoteknik. ñA.M.ò).
Oponenca për Projektin e Zbatimit është bërë në Institutin e Ndërtimit me nr. 361/2 prot, datë 08.10.2019, mbështetur në kërkesën së bërë nga shoqëria Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK nr. 19 prot, datë 27.09.2019.

3 **<u>Titulli i gjetjes</u>: Hartimi i Projekt idesë dhe Projektit të Zbatimit si dhe aplikimi nga shoqëria Koncesionare për leje ndërtimi, pa kryer më parë Oponencën Teknike.**

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se Oponenca Teknike është bërë e pjesshme, nga shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK vetëm për objektin ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë, Zona Tirana 1ò, Sheshi 9/1, Rruga ñEshref Frashëriò Tiranë dhe nuk rezulton të jetë bërë oponencë teknike në vlerën 729,484 lekë për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodica ò Tiranëò dhe për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Noti ò Tiranëò.
Sa më sipër, Shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK, nuk ka kryer oponencën teknike për projektin e zbatimit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodicaò Tiranëò dhe për projektin e zbatimit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Noti ò Tiranëò, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, <u>ku përcakton se:</u> ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò. Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkina Tiranë dhe Mbikëqyrësi i punimeve.
Kriteri: KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò, pika 4.4.2 germat (a), (b) dhe (c); Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPer kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimitò i ndryshuar, neni 6; UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 4.
Ndikimi/Efekti: Hartimi i projektit të zbatimit pa plotësuar rekomandimet që dalin nga kryera e oponencës teknike dhe aq më tepër aplikimi nga sipërmarrësi i punimeve për leje ndërtimi pa kryer oponencën teknike.
Shkaku: Neglizhencë e shoqërisë Koncesionare ñA.K.ò SHPK mbi plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për kryerjen e oponencës teknike.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: -Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tõi kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA. K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për kryerjen e oponencës teknike për objektet arsimore që po vazhdojnë të ndërtohet me një projekt zbatimi pa kryer më parë oponecën teknike, si një detyrim ligjor.
- AK Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për oponencën teknike, duhet të reflektojë diferencën prej 729,484 lekë në koston direkte të investimit.

<u>Dorëzimi i zonës së koncesionit (sheshit të ndërtimit).</u>
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi dorëzimin e sheshit (***Aneksi 5***) rezulton të jetë dorëzuar pjesërisht nga Bashkia Tiranë 3 (tre) sheshe ndërtimi, si vijon:
1. Sheshi 9/1, NJA nr. 9, rruga "Eshref Frashëri".
- Me datë 10.04.2019, është dorëzuar sheshi 9/1 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 1, Tip 1 + Kopësht dhe shkollës 2, Tip 4, pranë lagjes ñDon Boskoò NjA nr. 9, Bashkia e Tiranës. Sheshi konsiderohet pjesërisht i lirë sepse pasuria nr. 4/445 me sipërfaqe 749 m^2 volum 24, fq. 136, ZK nr. 8330, pjesë e sheshit të ndërtimit rezulton e okupuar nga z. ñH.B.ò dhe gjithashtu rezulton se në kufijtë e sheshit të ndërtimit mbivendoset muri rrethues i një ndërtese e cila nuk është pjesë e sheshit të ndërtimit. Vertetimi i dorëzimit të sheshit është nënshkruar nga të gjitha palët: Bashkia Tiranë nëpërmjet NjZP; Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Koncesionari.

zona është pjesë e njësisë strukturore Tr/424 me kategori primare përdorimi toke për arsim. brenda njësie vërehen banesa të ulta një familjare, kryesisht ndërtime informale.
Problematikë e konstatuar:
Dorëzimi i pjesshëm me datë 10.04.2019 i sheshit 9/1 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 1, Tip 1 dhe shkollës 2, Tip 4, pranë lagjes ñDon Boskoò NjA nr. 9, Bashkia e Tiranës, rezulton të jetë realizuar jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe është në përputhshmëri me pikën 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò të kontratës Koncesionare nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, por bazuar në pikën 2.7.1 germa ñcò të kontratës Koncesionare *data e nënshkrimit të Vërtetimit të Dorëzimit të Pjesshëm do të konsiderohet si* ***Data e Fillimit të Pjesshëm*** *të punimeve*, ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 04.09.2019, pra rreth 166 ditë me vonesë, për shkak të mos lirimit të plotë të sheshit 9/1 nga Bashkia Tiranë.

2. Sheshi 11/1, NJA nr. 11, rruga "Paisi Vodica".

- Me datë 03.04.2019, është dorëzuar sheshi 11/1 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 3, Tip 2 + kopësht dhe shkollës 4, Tip 4, rruga ñPaisi Vodicaò NjA nr. 11, Bashkia e Tiranës. Sheshi konsiderohet pjesërisht i lirë sepse janë konstatuar objekte ndërtimore brenda zonës së sheshit të ndërtimit për të cilat Bashkia Tiranë ka marr përsipër angazhimin për tëi liruar plotësisht sheshin ndërtimor.

Problematikë e konstatuar:
Dorëzimi i pjesshëm me datë 03.04.2019 i sheshit 11/1 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 3, Tip 1 + Kopësht dhe shkollës 4, Tip 4, pranë lagjes ñPaisi Vodicaò NjA nr. 11, Bashkia e Tiranës, rezulton të jetë realizuar jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe është në përputhshmëri me pikën 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò të Kontratës Koncesionare nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, por, bazuar në pikën 2.7.1 germa ñcò të Kontratës Koncesionare *data e nënshkrimit të Vërtetimit të Dorëzimit të Pjesshëm do të konsiderohet si* ***Data e Fillimit të Pjesshëm*** *të punimeve*, ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 02.09.2019, pra rreth 164 ditë me vonesë, për shkak të mos lirimit të sheshit të plotë 11/1 nga Bashkia Tiranë.

3. Sheshi 11/2, NJA nr. 11, rruga "Vangjel Noti".

- Me datë 24.10.2019, është dorëzuar sheshi 11/2 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 5, Tip 2 + kopësht, rruga ñVangjel Notiò NjA nr. 11, Bashkia e Tiranës. Sheshi konsiderohet pjesërisht i lirë sepse brenda sheshit të ndërtimit ekzistojnë 6 (gjashtë) struktura ndërtimore me 1 kat secila, ku palët kanë marrë angazhimin për të bërë lirimin e sheshit. Bashkia Tiranë ka marrë përsipër angazhimin për të liruar plotësisht sheshin ndërtimor.

Problematikë e konstatuar:
Dorëzimi i pjesshëm me datë 24.10.2019 i sheshit 11/2 pjesë e zonës së koncesionit për ndërtimin e shkollës 5, Tip 2 + Kopësht rruga ñVangjel Notiò NjA nr. 11, Bashkia e Tiranës, rezulton të jetë realizuar më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe është në përputhshmëri me pikën 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò të kontratës Koncesionare nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, por, bazuar në pikën 2.7.1 germa ñcò të kontratës Koncesionare *data e nënshkrimit të Vërtetimit të Dorëzimit të Pjesshëm do të konsiderohet si* ***Data e Fillimit të Pjesshëm*** *të punimeve*, ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 04.05.2020, pra rreth 184 ditë me vonesë, për shkak të mos lirimit të plotë të sheshit 11/2 nga Bashkia Tiranë.

Njësia e zbatimit të projektit (NjZP)

- Kryetari i BT me Urdhërin nr. 7710/3, datë 21.02.2019, ka urdhëruar ngritjen e NjZP në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së e detyrimeve kontraktuale me përbërjen si vijon: ñH.H.ò, Kryetar (Përfaqësues i BT); ñI.Q.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT);

ñB.D.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT); ñE.R.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT); ñJ.Gj.ò Anëtar (Përfaqësues i MASR).
- Kryetari i BT me Urdhërin nr. 5102 prot, datë 03.02.2020, ka urdhëruar ngritjen e NjZP në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së e detyrimeve kontraktuale.
- Kryetari i BT me Urdhërin nr. 2029/3, datë 05.02.2020, ka urdhëruar ngritjen e NjZP në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së e detyrimeve kontraktuale me përbërjen si vijon: ñH. H.ò Kryetar (Përfaqësues i BT); ñI. Q.ò Anëtar (Përfaqësues i BT); ñA. D.ò Anëtar (Përfaqësues i BT); ñE.Rr.ò Anëtar (Përfaqësues i BT); ñS.K.ò Anëtar (Përfaqësues i MASR).

3 **<u>Titulli i gjetjes</u>: Ngritja me vonesë e NjZP nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë.**

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se NjZP në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale është ngritur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me Urdhërin nr. 7710/3, datë 21.02.2019. Në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò, datë 17.10.2018, NjZP duhej të ishte ngritur një muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës Koncesionare, pra me datë 17.11.2018 dhe jo me datë 21.02.2019. Pra NjZP është ngritur rreth 4 (katër) muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me Kontratën Koncesionare /PPP ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol., datë 17.10.2018, pika 6.1 ku thekson se: ñ*Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e Kontratës, AK krijon Njësinë e Zbatimit të Projektit e cila do të përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen si më poshtë ("NJZP")*...ò. Për ngritjen e NjZP me shumë vonesë ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë, për mos zbatim të përmbushjes së detyrime kontraktuale të KK.
Kriteri: KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò, pika 6.1 dhe pika 6.2.
Ndikimi/Efekti: Hartimi i projekt idesë dhe projektit të zbatimit pa plotësuar rekomandimet që dalin nga kryera e oponencës teknike dhe aq më tepër aplikimi nga sipërmarrësi i punimeve për leje ndërtimi pa kryer oponencën teknike.
Shkaku: Neglizhencë e Autoritetit Kontraktues Bashkia Tiranë, për përcaktimin e NjZP në afatet e parashikuara në kontratë.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandime: Nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, të merren masa që në vazhdimësi për zbatimin e KK në ndërtimin e objekteve arsimore për lotin 2 dhe 3 për krijimin e NjZP në aftin kohor të përcaktuar në KK , si një detyrim kontraktual.

<u>Zbatimi i punimeve në 5(pesë) objektet arsimore + kopshte.</u>
Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Librezat e masave, Ditarit të punimeve, grafiku i punimeve, etj, me të dhëna të përgjithshme si në tabelë.

Zbatimi i Kontratës Koncesionare /PPP "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë Tiranë për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1".		
14.Lidhja e kontratës Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018. Nr. 29970 prot, datë 10.09.2020 ñSH.K.T1.ò SHPK.	**15.Vlera e kontratës** **2,086,147,490** lekë me tvsh ñJ.V ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK përfaqësuar nga shoqëria J V ñA. K.ò SHPK.	**16.Likuiduar:** - Likuidimet fillojnë mbas për përfundimit të objekteve arsimore dhe kolaudimit të tyre.

17. Situacioni Përfundimtar **-** Nuk ka likuidime	**18.Afati i punimeve të kontratës në muaj;** 18 muaj Afati i KK është 8.6 vjet Afati i shërbimit të mirëmbajtjes është 7 vjet Fillimi punimeve: 17.10.2018 Përfundimi punimeve: 18 muaj sipas kontratës.	**19. Zgjatja e kontratës** Sôka

20. **Mbikëqyrësi i punimeve** ñJV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò.	Licenca nr. MK.2892/4	Kontrata nr. - prot, datë 27.10.2020
21. **Kolaudatori i punimeve** BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK	Licenca Nr: MK ---	Kontratë e kolaudimit nr. prot ------ datë ------.
22.Akt Kolaudimi: ----	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim:** ---	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga auditimi në objektet arsimore rezulton se punimet civile të ndërtimit për Kontratën e Koncesionit/ PPP me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 me objekt *"Për përmirësimin e infratsrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 1",* rezultojnë si vijon:

Punimet e ndërtimit për objektet arsimore në sheshin 9/1, rruga "Eshref Frashëri" pranë lagjes "Don Bosko".

Dorëzimi i sheshit të ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò për shkollën 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkollën 2, Tip 4 është bërë me datë 10.04.2019.
Punimet e ndërtimit në sheshin 9/1, rruga ñEshref Frashëriò për shkollën 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkollën 2, Tip 4, kanë filluar me datë 04.09.2019.
Akti i piketimit në objektin në sheshin 9/1, rruga ñEshref Frashëriò për shkollën 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkollën 2, Tip 4, është mbajtur me datë 04.09.2019.
Vlera totale e kontratës (studim projektim, oponenca teknike, punime ndërtim montimi, pajisje laboratori, mbikëqyrja, kolaudimi, mirëmbajtje, fitimi i planifikuar) është 641,388,964.10 lekë me TVSH.
Vlera e kontratës për ndërtimet e objekteve arsimore në sheshin 9/1 është 553,997,380 lekë me TVSH. Drejtuesi teknik i kontratës është caktuar ing. ñR. Th.ò.
Sipërfaqet e ndërtimit:
Shkolla 1: Shkollë Tip 1 + Kopësht ka sipërfaqe 5812 m^2.
Shkolla 2: Shkollë Tip 4 ka sipërfaqe 4000.5 m^2.
Sipërfaqja totale e ndërtimit është 9812.50 m^2.
Nga auditimi i dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit rezulton se janë kryer punimet topografike dhe piketimet e objektit.
Nga auditimi i situacioneve pjesore nga nr. 1 deri tek situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve 4.09.2019 deri në shtator 2020), projektit të zbatimit dhe preventivit bazë dhe preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime të kryera jo në përputhje me projektin e hartuar nga shoqëria Koncesionare .
Objekti është ndërtuar me skelet b/a, ndërsa muret janë ndërtuar me tulla të lehtësuara dhe kanë funksion ndarës dhe jo mbajtës. Objekti në total ka dimensionet në plan 68.45 m me 96.40 m. lartësia totale është 11.22 m dhe 12.42 m.
Janë realizuar nënshtresat e zhavorrit t=20 cm dhe shtresa e betonit të varfër 10 cm.
Themelet janë trajtuar me prajmër hidroizolues.
Janë realizuar elementet vertikale (Kolona e mure b/a) me beton C 30/37.
Elementet horizontale trarë janë realizuar b/a me beton C25/30.
Soletat e ndërkateve janë monolite b/a t=15 cm me beton C25/30.

Gjate realizimit të strukturave mbajtëse b/a janë mbajtur proces-verbalet e punimeve të maskuara si dhe janë mbajtur kubikët e betonit.
Gjithashtu duke filluar nga faza e betonimit të themeleve, e në vazhdim janë realizuar punimet e tokëzimit.
Seksioni 1-palestra (shkolle 9 vjeçare) me përmasat në plan 30.25 x 18.90 m në formë ñLò dhe numër katesh arkitekture 2, ndërsa nga ana konstruktive ndahet në 4 kuota, ku një kuote është nën toke. Lartësia e katit 1 është 8.10 m, ndërsa lartësia e katit 2 është 8 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure,
Soletat janë monolite h=15 cm. Kolonat kanë dimensionet 40 x 100 cm dhe ngrihen mbi kuoten -3.68 m dhe 30 x 40 në kuoten +-0.00. Trarët janë me dimensione 40 x 100 për kuoten +4.42 m dhe 12.42 m, me trarë lidhës 25 x 50 cm , ndërsa për kuotën +7.82 m, kemi vetem trarë perimetral me permasat 40 x 50 cm. Ky seksionet nga kuota -3.68 deri në +-0.00 kufizohet në perimeter nga mure b.a me gjerësi t=30 cm. Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me permasa 160x80 cm, 120x80 cm dhe 60x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastic në kuoten -3.68 m dhe pllakë me h=60 cm në kuotën +-0.00.
Seksioni 2 (shkolle 9 vjeçare) Seksioni 2 ka përkatësisht përmasat në plan 21.8x52.45 m dhe numër katesh 3 mbi nivelin 0.
Lartësia e katit përdhe është 4.42m, ndërsa katet 1&2 me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure .
Soletat janë monolite me h=15 cm.
Kolonat kanë dimensionet 30x80 cm dhe ngrihen mbi kuoten -1.10 m.
Trarët janë me dimensione 30x50 cm për kuoten në të gjitha kuotat .
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 120x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastic në kuoten -1.10 m dhe me mure b.a t=0.3 m që shkojnë në kuoten +-0.00
Seksioni 3 & 4(kopësht) Seksioni 3&4 ka përkatësisht përmasat në plan 21.8x52.15 m në forme ñLò dhe numer katesh 3 mbi nivelin 0.
Lartesia e katit përdhe është 4.42 m, ndërsa katet 1&2 janë me me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure .
Soletat janë monolite me h=15 cm.
Kolonat kanë dimensionet 30x80 cm & 30x60 cm dhe ngrihen mbi kuotën -1.10 m.
Trarët janë me dimensione 30x50 cm për kuotën në të gjitha kuotat .
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 120x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastik në kuotën -1.10 m dhe me mure b.a t=0.3 m që shkojnë në kuotën +-0.00.
Seksioni 5(shkollë e mesme) Seksioni 5 ka përkatësisht përmasat në plan 16.2x43.85m dhe numër katesh 3 mbi nivelin 0.
Lartësia e katit përdhe është 4.42 m, ndërsa katet 1&2 janë me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure .
Soletat janë monolite me h=15 cm.
Kolonat kanë dimensionet 30x80 dhe ngrihen mbi kuoten -1.10 m.
Trarët janë me dimensione 30x50 cm për kuotën në të gjitha kuotat .
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në formë ñTò, ñLò me përmasa 120x80 cm, të konceptuar si trarë ne bazament elastik ne kuotën -1.10 m dhe me mure b.a t=0.3m qe shkojne ne kuotën +-0.00.
Seksioni 6 (shkollë 9 vjeçare & e mesme) Seksioni 6 ka përkatësisht përmasat në plan 16.2x52.45m dhe numër katesh 3 mbi nivelin 0.
Lartësia e katit përdhe është 4.42m, ndërsa katet 1&2 me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure.
Soletat janë monolite me h=15 cm.
Kolonat kanë dimensionet 30x80 cm dhe ngrihen mbi kuoten -1.10m

Traret janë me dimensione 30x50 cm për kuoten në të gjitha kuotat.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në formë ñTò, ñLò me përmasa 120x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastic në kuotën -1.10 m dhe me mure b/a t=0.3 m që shkojnë në kuoten +-0.00.
Aktualisht kanë përfunduar strukturat b/a të karabinasë për të gjitha seksionet nga S1.S2....S6 duke perfshirë edhe muraturen e tullës.
Muret e tullës parametrale janëe realizuar me 2x12 cm me polisterol në mes. Çdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me përmasa 12x15 cm me beton C 25/30 dhe te armuara me hekur 4 Ø10 me stafa Ø8 çdo 25 cm. Lidhja e mureve me elementet b/a të kolonave është bërë me hekur Ø çdo 50 cm.
Muret ndarës të objektit jenë realizuar mur tulle 12 cm. Çdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me permasa 12x15 cm me beton C 25/30 dhe të armuara me hekur 4Ø10 me stafa Ø 8 cdo 25 cm dhe me kolonçina antisizmike me përmasa 12x15 cm të armuara me hekur 4 Ø10 me stafa Ø8 çdo 25 cm.
Janë realizuar punimet e suvatimeve të brendshme e të jashtme në masën 80 %. Krahas suvatimeve të brendëshme janë realizuar plotesisht instalimet elektrike të kutive shpërndarëese dhe tubove elektrike.
Janë realizuar instalimet e tubove hidraulike ne nyjet sanitare. Janë realizuar punimet e tubove për instalimet e MNZ. Për kontrollin e cilesisë së punimeve, krahas personelit inxhinjero teknik të objektit. Firma zbatuese ka ngritur një grup pune që kontrollon e miraton punimet sipas fazave.
Punime ndërtimi në proces:
Përfundimi i punimeve të suvatimit të brendshëm e te jashtëm. Punimet e fasadës, suvatim me grafiato për katin përdhe deri në nivelin +2.82, të veshjes së fasadës me terakote si dhe të realizimit të mureve brisole me tulla dekorative. Punimet e izolimit të tarracës, për të gjithë objektin. Punimet e instalimeve elektrike, të ngrohjes me kaldaje me pelet, furnizimit me ujë e shkarkimeve, si dhe instalimet në ambientet teknike.
Punimet e sistemimeve në sheshin e brendshëm te objektit.
- Realizimi i volumeve të punimeve të ndërtimit në sheshin 9/1 (Shkolla 1: Tip 1 + Kopësht me sipërfaqe ndërtimi 5812 m^2) dhe (Shkolla 2: Tip 4 me sipërfaqe ndërtimi 4000.50 m^2) referuar situacioneve pjesore nga nr. 1 deri tek situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve deri në shtator 2020), është në vlerën 272,228,027 lekë me TVSH ose në masën 49.13 % (272,228,027 / 553,997,380*100).
- Realizimi i volumeve të punimeve referuar faktit në objekt deri në datë 30.12.2020, është në vlerën 315,778,506.6 lekë me TVSH ose në masën 57 %.

Punimet e ndërtimit për objektet arsimore në sheshin 11/1, rruga "Paisi Vodica".
Dorëzimi i sheshit të ndërtimit 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò për shkollën 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkollën 2, Tip 4 është bërë me datë 03.04.2019.
Punimet e ndërtimit në Sheshin 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò për shkollën 3, Tip 2 + Kopësht dhe Shkollën 4, Tip 4, kanë filluar me datë 02.09.2019.
Akti i piketimit në objektin në Sheshin 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò për shkollën 3, Tip 2 + Kopësht dhe Shkollën 4, Tip 4, është mbajtur me datë 02.09.2019.
Vlera totale e kontratës (studim projektim, oponenca teknike, punime ndërtim montimi, pajisje laboratori, mbikëqyrja, kolaudimi, mirëmbajtje, fitimi i planifikuar) është 772,182,602.97 lekë me TVSH.
Vlera e kontratës për ndërtimet e objekteve arsimore në sheshin 11/1 është 674,183,613 (451,763,818 + 222,419,795) lekë me TVSH. Drejtuesi teknik i kontratës është caktuar ing. ñR. TH.ò.
Sipërfaqet e ndërtimit:
Shkolla 3: Shkollë Tip 2 + Kopësht ka sipërfaqe 7,898 m^2.

Shkolla 4: Shkollë Tip 4 ka sipërfaqe 4,000.5 m^2.
Sipërfaqja totale e ndërtimit është 11,898.50 m^2.
Nga auditimi i dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit rezulton se janë kryer punimet topografike dhe piketimet e objektit. Objekti është ndërtuar, me skelet b/a, ndërsa muret janë tulla të lehtësuara dhe kane funksion ndarës jo mbajtës.
Objekti në total ka dimensionet në plan 21.3 m me 157.8 m dhe 29.96 m me 30.26 m. Lartësia totale është e ndryshueshme sipas seksioneve dhe varion nga 4.47 m që është lartësia e seksionit G6 ne 23 m.
Sipas projektit janë realizuar nënshtresat e zhavorrit t= 50 cm e të shtresës së betonit të varfër t=10 cm. Themelet janë b/a marka C 20/25 të vazhduara me gjerësi e prerje sipas projektit, dhe mure perimetrave t=30 cm për te arritur nivelin e kuotës 0.00 të objektit, si dhe me trarë tërthore me përmasa 30x50 cm. Hekuri i përdorur është në përputhje me projektin e specifikimet teknike S-500. Themelet janë trajtuar me prajmër hidroizolues .
Mbushja e themeleve është bere me çakall çdo 30 cm.
Shtresa e kuotës -4.07 është realizuar b/a me beton C20/25 dhe zagarë hekuri Ø8 çdo 20 cm
Janë realizuar elementet vertikale (Kolona e mure b/a) me beton C 30/37.
Elementet horizontale trarë janë realizuar b/a me beton C25/30. Soletat e ndërkateve janë soleta me polisterol b/a t=25/30 cm me beton C25/30.
Gjate realizimit të strukturave mbajtëse b/a janë mbajtur proces verbalet e punimeve të maskuara si dhe janë mbajtur kubiket e betonit.
Gjithashtu duke filluar nga faza e betonimit te themeleve e ne vazhdim janë realizuar punimet e tokëzimit. Përkatësisht ne:
Seksioni G-6-Kopeshti me përmasat në plan 30.26x 29.96m në formë katrore të rregullt dhe numër katesh arkitekture 1, ndërsa nga ana konstruktive ndahet ne 4 kuota, ku një kuotë është nën toke. Lartësia e katit është 4.07m, ndërsa sistemi struktural konsiston ne rama dhe mure .
Soletat janë të tipit kesonë me polisterol h=30 cm beton me marke C 25/30. Kolonat kanë dimensionet 35x60 dhe ngrihen mbi kuotën -1.10m nga kuota e dyshemesë dhe janë realizuar ne përputhje me projektin me beton C 30/37. Trarët janë me dimensione 35x55 për kuotën në të gjitha kuotat, beton me marke C 25/30.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar me beton C 25/30 në forme ñkatroreò, me përmasa 60x70 cm, si të konceptuar si trarë në bazament elastik në kuotën -1.10 m dhe me mure b/a t=0.3m që shkojnë në kuotën -4.07 në përputhje me projektin e zbatimit.
Në seksionin G-6 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, punimet e nuraturës, si dhe suvatimet e brendshme.
Në ketë seksion janë kryer punimet elektrike (tubo e kuti shpërndarëse) dhe hidraulike në ambientet sanitare (tubot). Janë realizuar punimet e tubove për instalimet e MNZ. Janë në proces punimet e izolimit të tarracës.
Seksioni G-5 (shkolle 9 vjeçare) Seksioni 2 ka përkatësisht përmasat në plan 22.95x21.3 m dhe numër katesh 5 me një kat nëntoke. Lartësia e katit përdhe është 4.07m, ndërsa katet e tjera me lartësi 3.40 m. Sistemi struktural konsiston ne rama dhe mure. Soletat janë soleta kesonë me polisterol h=25cm. beton me marke C 25/30. Kolonat kane dimensionet 35x80 dhe 35x60 janë realizuar në përputhje me projektin me beton C 30/37. Kafazi i ashensorit është b/z me b=30 cm dhe në përputhje me projektin janë realizuar me beton C30/37. Trarët janë me dimensione 35x55 për kuotën në të gjitha kuotat, beton me markë C 25/30. Themelet janë realizuar me trarë tëe vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 130x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastik dhe me mure b/a t=0.3 m që shkojnë në kuotën -4.07, kuota e dyshemesë. Themeli i ashensorit është bazament pllake me h=0.6 m dhe realizuar me beton me klasë C 25/30. Në seksionin G-5 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, punimet e nuraturës, si dhe janë në proces punimet në suvatimet e brendshme. Në ketë seksion janë kryer punimet elektrike (tubo e kuti shpërndarëse) dhe hidraulike ne ambientet sanitare (tubot). Janë realizuar punimet e tubove për instalimet e MNZ. Janë në proces punimet e izolimit të tarracës.

Seksioni G-4-Hapesire për shumë qëllime me përmasat në plan 23.37x 21.3 m në formë ñkatroreò dhe numër katesh arkitekture 2. Lartësia e katit përdhe është 4.07 m, ndërsa katet e tjera me lartësi 3.40 m. Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure. Soletat janë soleta me polisterol h=25 cm. Kolonat kane dimensionet 35x60 cm dhe në përputhje me projektin janë realizuar me beton C30/37. Trarët janë me dimensione 30x50 për kuotën në të gjitha kuotat. Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 100x80 cm, te konceptuar si trarë në bazament elastik në kuotën -1.10 m dhe me mure b.a t=0.3m që shkojnë në kuotën +-0.00. Ne seksionin G-4 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, punimet e nuraturës, si dhe janë në proces punimet në suvatimet e brendshme. Në këtë seksion janë kryer punimet elektrike (tubo e kuti shpërndarëse) dhe hidraulike në ambientet sanitare (tubot). Janë realizuar punimet e tubove per instalimet e MNZ. Janë në proces punimet e izolimit te taraces.

Seksioni G-3-Hapesire për palester me, permasat në plan 15.27 m x 21.3 m në formëñkatroreò dhe numer katesh arkitekture 3. Lartesia e katit përdhe është 4.07 m, ndërsa Lartesia e katit 1 eshte 8.10 m, ndërsa lartësia e katit 2 është 8 m. Sistemi struktural konsiston në kolona e mure dhe trare perimetrale ndërsa soleta është trajtuar me konstruksion metalik me llamarine strukturale të betonuar. Soletat janë h=10 cm. Kolonat kanë dimensionet 60x80 cm dhe ngrihen mbi kuotën +3.68 m dhe pastaj vazhdojnë me konstruksion metalik. Trarët janë me dimensione 40x55 cm me trarë lidhës 25x50. Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 180x100 cm, 120x100 cm dhe 160x100 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastic dhe realizuar me beton me markë C 25/30.

Në seksionin G-3 kanë përfunduar punimet betoni e b/a, ka përfunduar kati nëntoke si dhe kati përdhe me h=8.10 m dhe punimet në katin e dytë.

Kanë përfunduar punimet e nuraturës, si dhe janë në proces punimet në suvatimet e brendshme.

Seksioni 2(shkolle e mesme) Seksioni 2 ka përkatësisht përmasat në plan 37.64x21.3 m dhe numër katesh 4 mbi nivelin 0. Lartësia e katit përdhe është 4.07 m, ndërsa katet e tjera me lartësi 3.40 m. Sistemi struktural konsiston ne rama dhe mure. Soletat janë soleta me polisterol h=25cm. Kolonat kanë dimensionet 30x80 cm dhe ngrihen mbi kuotën 1.10 m nga kuota e themelit deri në kuoten e dyshemesë (-4.07). Trarët janë me dimensione 35x55 për kuoten në të gjitha kuotat. Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në formë ñTò, ñLò me permasa 130x80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastic nëe kuoten -1.10 m dhe me mure b.a t=0.3m që shkojnë në kuoten e dyshemese dhe realizuar me beton me markë C 25/30.

Nëe seksionin G-2 kanë përfunduar punimet betoni e b/a.

Seksioni 1 (shkolle 9 vjeçare & e mesme) Seksioni 1 ka përkatësisht përmasat në plan 13.85x12.88 m dhe numër katesh 2 dhe 6 mbi nivelin 0.

Lartësia e katit përdhe është 4.42m, ndërsa katet 1&6 me lartësi 3.40m. Sistemi struktural konsiston ne rama dhe mure. Soletat janë soleta me polisterol h=25 cm. Kolonat kane dimensionet 30x80 dhe ngrihen mbi kuotën -1.10 m. Trarët janë me dimensione 35x55 cm për kuotën në të gjitha kuotat. Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar nëe forme ñTò, ñLò me përmasa 130x100 cm, e konceptuar si trarë në bazament elastik dhe realizuar me beton me marke C 25/30. Në seksionin G-1 kanë përfunduar punimet betoni e b/a.

Gjatë realizimit të strukturave mbajtëse b/a janë mbajtur proces - verbalet e punimeve të maskuara si dhe janë mbajtur kubiket e betonit.

Gjithashtu duke filluar nga faza e betonimit të themeleve, e në vazhdim janë realizuar punimet e tokëzimit.

Muret e tullës perimetrave janë realizuar me 2 x 12 cm me polisterol në mes. Çdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me përmasa 12 x 15 cm me beton C 25/30 dhe të armuara me hekur 4Ø10 me stafa Ø8 cdo 25 cm. Lidhja e mureve me elementet b/a të kolonave është bere me hekur Ø cdo 50 cm.

Muret ndarës të objektit jenë realizuar mur tulle 12 cm Cdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me permasa 12x15 cm me beton C 25/30 dhe të armuara me hekur 4Ø10 me stafa Ø8 cdo 25 cm dhe me koloncina antisizmike me përmasa 12x15 cm të armuara me hekur 4Ø10

me stafa Ø8 cdo 25 cm.

Punime ndërtimi në proces:

Përfundimi i punimeve të muratoreve në seksionet G-1 dhe G-2.

Kryerja e punimeve të suvatimeve të brendshme.

Përfundimi i punimeve të suvatimit të jashtëm.

Punimet e izolimit të tarracës, për të gjithë objektin. Punimet e instalimeve të ngrohjes, furnizimit me uje e shkarkimeve, si dhe instalimet në ambientet teknike.

Punimet e sistemimeve në sheshin e brendshëm të objektit.

- Nga auditimi i situacioneve pjesore nga nr. 1 deri situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve 02.09.2019 deri në shtator 2020), projektit të zbatimit dhe preventivit bazë dhe preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga shoqëria Koncecionare e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Realizimi i volumeve të punimeve të ndërtimit në sheshin 11/1 (Shkolla 3: Tip 2 +Kopësht me sipërfaqe ndërtimi 7898 m^2) dhe (Shkolla 4: Tip 4 me sipërfaqe ndërtimi 4000.50 m^2) referuar situacioneve pjesore nga nr. 1 deri situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve 02.09.2019 deri në shtator 2020), është në vlerën 295,507,557 lekë me TVSH ose në masën 43.83 %(295,507,557 / 674,183,613*100).
- Realizimi i volumeve të punimeve referuar faktit për 5 (pesë) objektet arsimore deri në 31.12.2020, është në vlerën 343,833,642.63 lekë me TVSH ose në masën 53 %. Pra, ecuria e realizimit të punimeve në objektet arsimore nuk është në përputhje me afatet e përcaktuara në grafikun e punimeve.

Punimet e ndërtimit për objektet arsimore në Sheshin 11/2, rruga "Vangjel Noti".

Dorëzimi i sheshit të ndërtimit 11/2, rruga ñEshref Frashëriò për shkollën 1, Tip 1 + Kopësht dhe Shkollën 2, Tip 4 është bërë me datë 24.10.2019.

Punimet e ndërtimit në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò për shkollën 5, Tip 2 + Kopësht, kanë filluar me datë 04.05.2020.

Akti i piketimit në objektin në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò për shkollën 5, Tip 2 + Kopësht, është mbajtur me datë 04.05.2020.

Vlera totale e kontratës (studim projektim, oponenca teknike, punime ndërtim montimi, pajisje laboratori, mbikëqyrja, kolaudimi, mirëmbajtje, fitimi i planifikuar) është 507,462,553.12 lekë me TVSH.

Vlera e kontratës për ndërtimet e objekteve arsimore në sheshin 11/2 është 451,763,818 lekë me TVSH. Drejtuesi teknik i kontratës është caktuar ing. ñR.TH.ò.

Shkolla 5; shkollë tip 2 + kopësht me sipërfaqe 8005 m^2.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit rezulton se janë kryer punimet topografike dhe piketimet e objektit.

Objekti është ndërtuar sipas kateve përkatëse, me skelet b/a, ndërsa muret janë tulla të lehtesuara dhe kane funksion ndarës jo mbajtës.

Objekti në total ka dimensionet në plan 44.1 m me 59.7 m.

Lartësia totale është e ndryshueshme sipas seksioneve dhe varion nga +8.10 m që është lartësia e seksionit S2 salla e palestrës në 17 m që është S-1.

Objekti është ndare me fugë për të ruajtur një raport të gjatësisë me gjerësinë e objektit <4 (ɔ=Lmax/Lmin,4; EN 1998-1).

Sipas projektit janë realizuar nënshtresat e zhavorrit t= 50 cm e të shtresës së betonit të varfër t=10 cm. Themelet janë b/a marka C20/25 të vazhduara me gjerësi e prerje sipas projektit, dhe mure perimetrale t=30 cm për të arritur nivelin e kuotës 0.00 të objektit, si dhe me trarë tërthore me përmasa 30x50 cm. Hekuri i përdorur është në përputhje me projektin e specifikimet teknike S-500.

Themelet janë trajtuar me prajmër hidroizolues.
Mbushja e themeleve është bërë me çakall çdo 30 cm.
Shtresa e kuotës 0.00 është realizuar b/a me beton C20/25 dhe zagarë hekuri Ø8 cdo 20 cm.
Janë realizuar elementet vertikale (Kolona e mure b/a) me beton C 30/37.
Elementet horizontale trarë janë realizuar b/a me beton C25/30.
Soletat e ndërkateve janë soleta me polisterol b/a t=25/30 cm me beton C25/30.
Seksioni S-1 Seksioni 1 ka përkatësisht përmasat në plan 9.3 x 44.1 m dhe numër katesh 3 mbi nivelin 0. Lartësia e katit përdhe është 3.48 m, dhe katet e tjera me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure .
Soletat janë soleta me polisterol h=30cm.
Kolonat kanë dimensionet 70 x 40 cm dhe ngrihen mbi kuotën -3.5 m.
Trarët janë me dimensione 35 x 55 cm për kuotën në të gjitha kuotat.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 130 x 100 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastik në kuotën -3.50 m dhe me mure b.a t=0.3 m që shkojnë në kuotën +-0.00 cm.
Në seksionin S-1 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, dhe janë duke vazhduar punimet e muratures.
Seksioni S-2-Ky seksion ka përmasa 20.7 x 44.1 m dhe ka në përbërje hapësirën për palestër me, përmasat në plan 15.27 m x 21.3 m në formë ñkatroreò dhe numër katesh arkitekture 3 në ambientet ndihmese dhe 1 kat palestra. Lartësia e katit përdhe është 3.48 m dhe të parë është 3.40 m, ndërsa Lartesia e katit të palestrës është 8.10 m, dyshemeja e të cilës është në kuotën -1.20 m.
Sistemi struktural konsiston në kolona e mure dhe trarë perimetrave ndërsa soleta është trajtuar me konstruksion metalik me llamarine strukturale të betonuar.
Soletat janë me h=10 cm dhe në ambientet ndihmese të soletës është 30 cm.
Kolonat kanë dimensionet 40 x 70 cm dhe 100 x 40 cm dhe ngrihen mbi kuotën -3.68 m.
Trarët janë me dimensione 35 x 55 cm me trarë lidhës 25 x 30 cm.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 130 x 100 cm, 120 x 80 cm dhe 60 x 80 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastik.
Në seksionin S-2 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, për ambientet jashtë sallës së palestrës po kështu salla e palestrës ka përfunduar punimet deri në kuotën +6.80 m, duke përfshire edhe shtresën e betonit.
Janë në proces ndërtimi i mureve perimetrave dhe të brendshëm si dhe suvatimet e brendshme.
Seksioni S-3 Seksioni 2 ka përkatësisht përmasat në plan 20.4x44.1 m dhe numër katesh 3 kate mbi nivelin 0.
Lartësia e katit përdhe eshte 3.48 m, ndërsa katet e tjera me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure .
Soletat janë soleta me polisterol h=25cm.
Kolonat kane dimensionet 30 x 80 cm dhe ngrihen mbi kuotën -1.10 m.
Trarët janë me dimensione 35 x 55 cm për kuotën në të gjitha kuotat.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar në forme ñTò, ñLò me përmasa 130 x 80 cm, në formë ñkatroreò, me përmasa 60 x 70 cm të konceptuar si trarë në bazament elastik dhe me mure b/a t=0.3 m që shkojnë në kuotën +-0.00.
Në seksionin S-3 kanë përfunduar punimet e karabinanë b/a, punimet e nuraturës, si dhe janë në proces punimet në suvatimet e brendshme.
Seksioni S-4 Ky seksion ka përmasat në plan 9.3x 44.1 m në forme katrore të rregullt dhe numër katesh arkitekture 5.
Lartësia e katit është 3.48 m, ndërsa ndërsa katet e tjera është me lartësi 3.40 m.
Sistemi struktural konsiston në rama dhe mure. Soletat janë të tipit kesonë me polisterol h=30 cm.
Kolonat kanë dimensionet 30 x 80 cm & 30 x 60 cm dhe ngrihen mbi kuotën -3.50 m.

Trarët janë me dimensione 35 x 55 cm për kuotën në të gjitha kuotat.
Themelet janë realizuar me trarë të vazhduar 180 x 100 cm, të konceptuar si trarë në bazament elastik dhe me mure b/a t=0.3 m që shkojnë në kuotën +-0.00.
Në seksionin G-4 kanë përfunduar punimet betoni e b/a, deri në katin e tretë.
Gjatë realizimit të strukturave mbajtëse b/a janë mbajtur proces verbalet e punimeve të maskuara si dhe janë mbajtur kubiket e betonit.
Gjithashtu duke filluar nga faza e betonimit të themeleve, e në vazhdim janë realizuar punimet e tokëzimit.
Muret e tullës parametrale janë realizuar me 2 x 12 cm me polisterol në mes. Çdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me përmasa 12 x 15 cm me beton C 25/30 dhe të armuara me hekur 4 Ø10 me stafa Ø8 çdo 25 cm. Lidhja e mureve me elementet b/a të kolonave është bere me hekur Ø cdo 50 cm
Muret ndarës të objektit janë realizuar me mur tulle 12 cm. Çdo 1.2 m janë realizuar brezat antisizmike me përmasa 12 x 15 cm me beton C 25/30 dhe të armuara me hekur 4 Ø10 me stafa Ø8 çdo 25 cm dhe me kolonçina antisizmike me përmasa 12 x 15 cm të armuara me hekur 4Ø10 me stafa Ø8 çdo 25 cm.
Punime ndërtimi në proces:
Përfundimi i punimeve betoni e b/a në seksionet S-4 .
Kryerja e punimeve të nuraturës dhe të suvatimeve.
Kryerja e punimeve të instalimeve elektrike hidraulike e ngrohjes.
Punimet e izolimit të tarracës, për të gjithë objektet e përfunduara edhe me muraturat e parapetit.
Punimet e sistemimeve në sheshin e brendshëm të objektit:
- Nga auditimi i situacioneve pjesore nga nr. 1 deri situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve 04.05.2020 deri në shtator 2020), projektit të zbatimit dhe preventivit bazë dhe preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga shoqëria Koncecionare e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Realizimi i volumeve të punimeve të ndërtimit në sheshin 11/2 (Shkolla 5: Tip 2 +Kopsht me sipërfaqe totale ndërtimi 8005 m^2) referuar situacioneve pjesore nga nr. 1 deri situacioni pjesor nr. 13 (që i përket periudhës nga fillimi i punimeve 04.05.2020 deri në shtator 2020), është në vlerën 135,136,279 lekë me TVSH ose në masën 29.91 % (135,136,279/451,763,818*100).
- Realizimi i volumeve të punimeve referuar faktit në objek, është në vlerën 234,917,185.36 lekë me TVSH ose në masën 52 %.

Mbi realizimin e afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit.

► Titulli i gjetjes: Kryerje e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore jashtë afatit kohor të parashikuar në kontratën Koncesionare me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018.

Situata: Punimet civile të ndërtimit sipas KK me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Bashkisë Tiranë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. ñE. V.ò dhe BOE midis shoqërive J.V ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK, që në vijim do të quhet ñKoncesionariò, për 5 (pesë) objektet arsimore (Shkolla + kopshte) për sheshet e ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò pranë lagjes ñDon Boskoò, të Sheshit 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò dhe të Sheshit 11/2, rruga ñVangjel Notiò, rezulton si vijon:
Afati kohor i përfundimit të punimeve në kontratën Koncesionare me PPP, është parashikuar 18 muaj, dhe duke i shtuar afatim maksimal prej 6 muaj sipas pikës 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò të kontratës Koncesionare (koha maksimale për lejet zhvillimore dhe lejet ndërtimore), bëhet 24 muaj, pra 2 vjet. Meqenëse kontrata është lidhur me datë 17.10.2018,

atëhere punimet e ndërtimit duhej të përfundonin me datë 17.10.2020. Aktualisht ku realizimi i punimeve të ndërtimit paraqitet rreth 53 % për 5 (pesë) objektet arsimore konstatohet kryerje punime ndërtimi jashtë afatit kohor të KK me 115 ditë vonesë, për shkak të mos lirimeve të plota të shesheve të ndërtimeve, duke riskuar mundësinë e penaliteteve ndërmjet palëve. Sa më sipër është vepruar dhe po veprohet në kundërshtim me nenin 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò dhe nenin XVII ñSanksionetò dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë për lirimin e shesheve të ndërtimit të afatin e përcaktuar në kontratë si dhe për mos dhënien e lejeve të ndërtimit për objektet arsimore.
Kriteri: KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pesë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò, neni 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò dhe neni XVII (Sanksionet).
Ndikimi/Efekti: Kryerja e punimeve të ndërtimit jashtë afatit përfundimtar të parashikuar në KK, krijon mundësinë e rritjes së vlerës së kontratës si dhe mos realizimin e objektivave të parashikuara në projektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë Tiranëò për Lotin 1 (Tirana 1) dhe Lotin 4 (Tirana 4).
Shkaku: Neglizhencë e Autoritetit Kontraktues Bashkia Tiranë, për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: Nga shoqëria Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK, të merren masa për zbatimin e punimeve të ndërtimit në afatet kohore të përcaktuara në KK, duke eliminuar vonesat për shkak të mos lirimit të shesheve të ndërtimit ose të lirimit të pjesshëm të tyre. AK duhet të miratojë shtryjen e afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit të shkollave.

Për sa është trajtuar në Rraportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tiranë, është paraqitur observacioni me shkresë me nr. 15248/1 prot., datë 11.05.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 771/8 prot, datë 20.05.2021), lidhur mbi marrjen e masave për lidhjen e kontratës së hipotekës midis BT dhe Koncesionarit.

Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me rekomandimin për marrjen e masave për lidhjen e kontratës së hipotekës midis Bashkisë Tiranë dhe Koncecionarit, BT sqaron se sipas fjalisë së dytë , të shkronjës "f", të nenit 2.7.3 të kontratës koncesionare parashikohet se Bashkia Tiranë dhe Koncesionari kanë rënë dakord se do të nënshkruajnë kontratë hipoteke në favor të koncesionarit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga regjistrimi i objekteve arsimore (ndërtesa të shkollave)në pronësi të BT pranë Agjencisë Shtetrore të Kadastrës, si një mjet garancie të AK në lidhje me pagesat kundrejt koncesionarit. Pra, sipas parashikimeve të kontratës, ky detyrim do duhet të përmbushet pas përfundimit të ndërtimit dhe regjistrimit të objekteve arsimore.
Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:
Në lidhje me komentet e bëra në observacion nga Bashkia Tiranë, mbi lidhjen e kontratës së hipotekës midis Bashkisë Tiranë dhe Koncecionarit, observacioni merret në konsideratë dhe ndryshimi është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

d/2. Monitorimi i kontratave koncecionare/PPP mbi ndërtimin e shkollave në bashkinë Tiranë.
Monitorimi dhe inspektimi gjatë/pas ndërtimit. Përveç monitorimit dhe inspektimit nga BT (në cilësinë e investitorit) Autoriteti Kontraktues përmes NjZP mund të monitorojë dhe inspektojë gjatë fazës së ndërtimit, në prani të koncesionarit, pasi i jep një njoftim të mëparshëm. Nëse gjatë monitorimit vërehen shkelje, NjZP harton një raport me shkeljet e konstatuara dhe masat përkatëse që duhet të ndërmerren për riparimin e tyre dhe ja dërgon AK-së. Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike (DPPP) nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve të Huaja (DMIH) dhe konkretisht NjZP e përbërë nga: [ñH. H.òKryetar (Përfaqësues i BT); ñI.Q.ò

Anëtar (Përfaqësues i BT); ñA.D.ò Anëtar (Përfaqësues i BT); ñE.Rr.ò Anëtar (Përfaqësues i BT); ñS.K.ò Anëtar (Përfaqësues i MARS)].
Informon MFE se në zbatim të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kontratës së koncesionit/PPP me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 lidhur midis Bashkisë Tiranë , MASR si dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik të shpallur fitues për Zona Tirana 1, NjZP e ngritur me urdhrin nr. 29139/3, datë 16.09.2020 me cilësinë e monitoruesit të përmbushjes së detyrimeve kontraktale, referuar kuadrit ligjor ñKoncesionit/PPPò si dhe në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 121, seksioni i IV udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019. Për periudhën objekt auditimi, informimi i MFE nga NjZP është bërë si vijon:
- NJZP me shkresën nr. 29841/1 prot, datë 18.09.2020, ka informuar ARRSH dhe për dijeni SHK ñZ.M.Aò SHPK, lidhur me mbivendosjen e gjurmës së segmentit ñRehabilitimi i segmentit mbikalimi pallati me shigjeta ï rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1ò me Ndërtim i Ri Shkolle Tip 2 në NJA nr. 11, sheshi 11/2.
- NJZP me shkresën nr. 24334 prot, datë 21.07.2020 ka informuar MFE, në lidhje me ecurinë e KK/PPP në Raportimin sipas shtojcës 8.1, për periudhëm Maj-Qershor 2020.
- NJZP me shkresën nr. 27845 prot, datë 21.08.2020 ka informuar MFE, në lidhje me ecurinë e KK/PPP në Raportimin sipas shtojcës 8.1, për muajin korrik 2020 ku realizimi i punimeve rezulton në masën 56% nga planifikimi 80%.
- NJZP me shkresën nr. 34559 prot, datë 09.10.2020 ka informuar MFE, në lidhje me ecurinë e KK/PPP në Raportimin sipas shtojcës 8.1, për muajin shtator 2020. Sipas raportimit periodik mujor, rezulton se ndërtimi i shkollave për Lotin 1 për muajin gusht 2020, planifikimi i punimeve 78 % për ndërtim dhe realizimi është 65%.
- NJZP me shkresën nr. 30583 prot, datë 14.09.2020 ka informuar MFE, në lidhje me ecurinë e KK/PPP në Raportimin sipas shtojcës 8.1, për muajin shtator 2020.

d/3. Nga zbatimi i punimeve të kontratës me Koncesion/Partneritet Publik Privat (PP) me objekt: "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në Zonën Tirana 4", rezultoi:

Bashkia Tiranë (në vijim ñBTò) në kuadër të përmbushjes së përgjegjësive të saj për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, si dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimore parashkollor në kopshte dhe çerdhe, synon të përmirësojë infrastrukturën arsimore në Tiranë, duke ndërtuar shkolla të reja në mënyrë që tû jepet një zgjidhje përfundimtare problemeve me të cilat përballet sistemi arsimor në BT, si zhvillimi i mësimit me dy turne, mbipopullimi i shkollave, etj. BT ka kryer procedurat ligjore dhe procedurat përzgjedhëse konkurruese, bazuar në ligjin nr. 125/2013 ñPër koncesionet dhe partneritetin publik privatò të ndryshuar, në lidhje me propozimin e kërkuar për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në BT ñPër projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e 4 (katër) objekteve arsimore, loti 4, në ñZonën Tirana 4 ò konkretisht:

-2 (dy) objekte arsimore Tip 1 + Tip 4, janë vendosur në Njësinë Administrative (në vijim ñNJAò) Nr. 8;
-1 (një) objekt arsimor Tip 2, në NJA Nr. 2;
-1 (një) objekt arsimor Tip 4, në NJA Dajt.

<u>Kontratat (Sipërmarrje, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve).</u>

- Për investimin me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në BT ñ për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e katër objekteve arsimore në Zonën Tirana 4 ò është lidhur kontratë për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Bashkisë Tiranë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. ñE. V.ò dhe BOE midis shoqërive ñJ.V ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñEd.K.ò

SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikues NUIS J61812013R & NUIS I61922018S & NUIS K61625001I & NUIS K72113010E & NUIS L51424014F & NUIS J66902027T, krijuar nëpërmjet akt-marrëveshjes për BOE datë 07.09.2019, përfaqësuar nga shoqëria ñA. K.ò SHPK përfaqësuar nga administratori ligjor z. ñA. K.ò, banues në Tiranë, rruga ñFrederik Shirokaò Tiranë, në cilësinë e ñKoncesionaritò.
- BOE ñJ.V ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñEd.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò ka krijuar shoqërinë SPV ñ SH.K.T4.ò SHPK me datë themelimi 07.10.2020 dhe datë regjistrimi në QKB me NUIS M02219001K dhe me administrator Z. ñE. F.ò. Kapitali themelor fillestar është ALL 100,000 (njëqind dhe ndahet në 6 (gjashtë) kuota.

<u>Vlera totale e kontratës Koncesionare dhe pagesa e koncesionit.</u>

Ndërtimi i shkollave dhe punimet e ndërtimit do të realizohen me financimin e koncesionarit, i cili merr përsipër riskun dhe koston e investimit për zbatimin e objektit të kësaj kontrate, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në të, duke patur parasysh se në përputhje me DSK dhe ofertën e koncesionarit, AK ka marrë përsipër tôi paguaj koncesionarit vlerën prej 1,738,456,242 lekë pa TVSH ose 2,086,147,490 lekë me TVSH, që përmban komponentët e mëposhtëm:

- Vlera e investuar nga koncesionari për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe kosto mirëmbajtje të barabartë me 1,176,113,096.30 lekë pa TVSH ose 1,411,335,715.56 lekë me TVSH.
- Vlera e investuar nga koncesionari për shërbimet e mirëmbajtjes së objekteve arsimore deri në fund të kontratës, të barabartë me 251,132,420 lekë pa TVSh ose 301,358,904 lekë me TVSH.
- Marzhin e fitimit në masën 6.28 %, që përllogaritet çdo vit mbi vlerën e mbetur të investimit direkt dhe mbi koston vjetore të mirëmbajtjes, të përllogaritur sipas kalendarit të pagës në Aneksin 3 (ñ*Vlera totale e kontratës*ò).
- AK do dôi paguajë koncensionarit si kontribut në këtë PPP për realizimin e ndërtimeve dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore për gjithë kohëzgjatjen e koncesionit, vlerën totale të kontratës, për një periudhë 7-vjeçare nga data e çertifikimit të ndërtimit, në përputhje me shumat dhe afatet e përcaktuara në kalendarin e pagesave në aneksin 3.
- Koncesionari ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñED.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò me datë 12.02.2020 në kompaninë e sigurimit Albsig ka siguruar KK, për llogari të AK, në shumën 208,614,749.02 lekë me TVSH, si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës së sipërmarrjes.

Në KK është bërë një lapsus duke parashikuar për shpronësim Truall pronësi shtet (aset i Bashkisë Tiranë) sipas tabelës.

Nga auditimi i dokumentacioni tekniko ï ligjor në dosjen teknike të zbatimit të KK me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020 fituar nga ñSh.K. T4.ò SHPK, mbi shpronësimin e pronave private që ndodhen brenda sipërfaqes së sheshit të ndërtimit D2 që ndodhet pranë Linzes, Njësia Administrative Dajt u konstatua një lapsus në koston direkte të investimit duke parashikuar koston e truallit në vlerën 27,547,520 lekë për truallin pronësi shtet (Aset i bashkisë Tiranë) me sipërfaqe 13,244 m^2 që ndodhet në Zonën Kadastrale 2460 dhe me numër pasurie 194/28.

Tabela 168: Tabela me llogaritjet paraprake të pasurive që preken nga projekti. Sheshi D2, NjA Dajt.

Nr.	Emër	Shënim në Sek. E	Zona Kast.	Nr. Pasurisë	Sip. Tr. prekur (m^2)	Çmimi i truallit Lek/m^2	Sip. Obj. prekur (m^2)	Çmimi Obj. lek/m^2	Vlera në lekë
1	Truall pronësi shtet (aset	-	2460	194/28	13,244	2,080	-	-	27,547,520

	i bashkisë Tiranë)								
	Shuma	**-**	**-**	**-**	**13,244**	**-**	**-**	**-**	**27,547,520**

Burimi i informacionit: Bashkia Tiranë, KK/PPP; Studim Fizibiliteti nëntor 2016 rishikuar në shtator 2018.

Në zbatim të VKM-së nr.15, datë 16.01.2019 ñPër kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të këtyre pronave...ò dhe të VKM nr. 355, datë. 5.04.2016, VKM nr. , 100 datë 23.02.2018, VKM 128. datë 17.04.2019, Pronat më sipër kanë kaluar të gjitha në pronësi të Bashkisë Tiranë, janë rifreskuar dhe statuset juridike të pronave. Rekomandohet që në kostot e truallit të bëhet modifikimi përkatës sipas tabelës 181. Ky lapsus nuk ka shkaktuar efekte negative sepse nga ana e Bashkisë Tiranë për këtë truall nuk ka kryer shpronësime.

Tabela 181 Kosto direkte investimit për Lotin 4

Viti	Përshkrimi	Shuma totale
A.	Kosto direkte të investimit	1,230,118,136
A.1	Kostot e Truallit	53, 345,580
A.2	Kostot e Projektimit	25,283,249
A.3	- Ndërtim + instalime	1,023,486,195
A.4	- Oponenca teknike	843,550
A.5	- Taksë infrastrukture	-
A.6	- Leje mjedisore	120,000
A.7	- Mbrojtje ndaj zjarrit	200,000
A.8	- Kosto supervizimi	11,683,304
A.9	- Kosto Kolaudimi	414,825
A.10	- Mobiljet dhe orendi	73,400,000
A.11	- Investime IT & T dhe laboratore	41,341,433

Burimi i informacionit: Bashkia Tiranë, KK/PPP; Studim Fizibilitetit nëntor 2016.

Procedura e lidhjes së kontratës së mbikëqyrësit të punimeve.

- Në zbatim të kushteve të kontratës së koncesionit/ PPP me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020 të lidhur ndërmjet BT përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. ñE. V.ò dhe ñMASRò përfaqësuar nga Ministri Znj. ñB. SH.ò dhe BOE midis shoqërive ñJ.V ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñEd.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò.

ñ SH.K.T4.ò ka paraqitur pranë BT shkresën me nr. Prot. 36663, datë 22.10.2020, në lidhje me ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 i kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 për mbikëqyrës punimesh subjektet e mëposhtme:

- ñA.MK.ò SHPK
- ñT.ò SHPK
- JV ñA. & C. M. A.ò SHPK

Si dhe propozimin në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, neni 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò i kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 për kolaudator punimesh si vijon:

-ñD-Nò SHPK T. E. D. S. SHPK
-ñI.ò SHPK
-ñG. & L.ò SHPK

- Kryetari i BT me shkresën me nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar ñSH.K.T4.ò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 ñCaktimi i Mbikëqyrësit të punimeveò si dhe të pikës 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon:

- Për mbikëqyrës punimesh ñA. MK.ò SHPK

- Për kolaudator BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4ò është lidhur kontrata më datë 27.10.2020 ndërmjet ñSH.K.T4.ò me NIPT M02219001K, përfaqësuar nga administratori Z. ñE.F.ò dhe shoqërisë ñA. MK.ò SHPK me seli në Mallakastër me NIPT L67619801Q, dhe licencë MK. 2892/4 ñPër mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimitò përfaqësuar nga administratori Z. ñE. M.ò. Vlera e kontratës së mbikëqyrësit të punimeve është 11,683,304 lekë pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve të kontratës së mbikëqyrjes do të jetë ai që është përcaktuar në vendimin e KRT-së Bashkia Tiranë.

<u>Problematika të konstatuara:</u>

1. Koncesionari ñSH. K. T4ò SHPK ka paraqitur propozimin pranë BT për subjektet për mbikëqyrje punimesh dhe kolaudim objekti me datë 22.10.2020, pra rreth 1 (muaj) me vonesë nga Urdhri i Kryetarit të BT lëshuar me nr. 29139/2 prot, datë 16.09.2020 për ngritjen e NJZP për zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 4ò, ndërkohë që propozimi nga koncesionari mbi subjektet për mbikëqyrje dhe kolaudim duhet të ishte bërë para datës 26.09.2020. Ky veprim është në kundërshtim me kushtet e KK Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu V, Pika 5.1.1.

2. Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë dispozision grupit të auditimit, konstatohet se nuk ka asnjë dokument si shkresë apo raport vlerësimi e cila të pasqyrojë propozimin e bërë nga NJZP mbi përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punime dhe kolaudatorit duke marrë parasysh eksperiencën, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Po cilat janë rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit mbështetur në ligjin e zbatueshëm??.

Po tõi referohemi kuadrit ligjor të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, konkretisht: Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, UKM nr. 354, datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò zgjedhja e mbikëqyrësit të punimeve dhe koladatorit, duhej të ishte bërë ndryshe, argumentuar si vijon:

-BT në kontratën për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu V, Pika 5, Nënpikat 5.1.1/5.1.2 i kanë dhënë komoditetin koncesionarit shoqërinë SPV ñSH.K. T4.ò SHPK, për të paraqitur BT subjekte mbikëqyrëse punimesh ndërtimit, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse mbikëqyrësi i punimeve i propozuar nga Koncesionari dhe i përzgjedhur është bërë pa argumentuar përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën nga NJZP dhe AK Bashkia Tiranë. Parashikimi në KK Kreu V, pika 5 mbi caktimin e mbikëqyrësit të punimeve si dhe rruga e ndjekur nga AK për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve rezulton e tillë që Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ñA. MK.ò SHPK është e lidhur me shoqërinë zbatuese të objektit, fakti që kjo shoqëri është përzgjedhur nga ñ SH.K. T4.ò SHPK. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 7 i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë*...ò

-BT në kontratën për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu V, Pika 5.2, Nënpikat 5.2.1 dhe 5.2.2 i kanë dhënë komoditetin koncesionarit shoqërinë SPV

ñSH.K.T4.ò SHPK, për zgjedhur dhe paraqitur BT subjekte kolauduese punimesh ndërtimi, në rrethanat e konfliktit të interesit, sepse kolaudatori i punimeve i propozuar nga Koncesionari dhe i përzgjedhur pa argumentuar përmbushjen e kritereve mbi eksperiencën nga Bashkia Tiranë. Parashikimi në KK Kreu V, pika 5.2 mbi caktimin e kolaudatorit të punimeve si dhe rruga e ndjekur nga AK për caktimin e kolaudatorit të punimeve rezulton e tillë që Kolaudatori i punimeve BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK është e lidhur me shoqërinë zbatuese të objektit, nisur nga fakti që kjo shoqëri është përzgjedhur nga ñ SH.K. T4.ò SHPK. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Neni 12, i cili thekson se: ñ...*Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë*...ò.

3. Sipas kontratës për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë **08.09.2020,** Kreu VII, pika 7.2 theksohet se: ñ... *NjZP do të përzgjedhë mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin nga paneli i propozuar nga koncesionari, sipas parashikimeve të kësaj kontrate dhe do t'ia komunikojë këtë koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues. Njëkohësisht, ajo do të shqyrtojë raportet e mbikëqyrësit të punimeve dhe do të monitorojë procesin e kolaudimit nga kolaudatori*ò.

Për sa është trajtuar në Rraportin Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar Bashkia Tiranë, është paraqitur observacioni me shkresë me nr. 15248/1 prot., datë 11.05.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 771/8 prot, datë 20.05.2021), në lidhje me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit:

1...Për sa i përket problematikës lidhur: Koncesionari "Tirana 4" SHPK ka paraqitur propozimin pranë BT për subjektet për mbikëqyrje punimesh dhe kolaudim objekti me datë 22.10.2020, pra rreth 1 (muaj) me vonesë nga Urdhri i Kryetarit të BT lëshuar me nr. 29139/2 prot, datë 16.09.2020 për ngritjen e NJZP për zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP "Për përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 4", ndërkohë që propozimi nga koncesionari mbi subjektet për mbikëqyrje dhe kolaudim duhet të ishte bërë para datës 26.09.2020. Ky veprim është në kundërshtim me kushtet e kontratës së koncesionit Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu V, Pika 5.1.1.

2. Mbi Auditimin e dokumentacionit tekniko – ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe propozimet e bëra nga NJZP mbi përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaodatorët e punimeve, në observacion pretendohet se, përzgjedhja e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit është bërë nga NjZP dhe është konfirmuar me shkresë nr. prot. 36663/1, datë 27.10.2020 të kryetarit të BT drejtuar "SH.K.T4." SHPK.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:

1. Në lidhje me komentet e bëra mbi pikën 1, se vendimi i NjZP është formalizuar nga AK (Kryetari i Bashkisë Tiranë) me shkresë datë 27.10.2020 dhe është njoftuar Koncesionari, sqarojmë se: Bazuar në kontratën për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, Kreu VII, pika 7.2 theksohet se: "... NjZP do të përzgjedhë mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin nga paneli i propozuar nga koncesionari, sipas parashikimeve të kësaj kontrate dhe do t'ia komunikojë këtë koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues. Njëkohësisht, ajo do të shqyrtojë raportet e mbikëqyrësit të punimeve dhe do të monitorojë procesin e kolaudimit nga kolaudatori". Në observacion tek detyrat e NJZP, nga ana Juaj pika 7.2 nuk është pasqyruar plotësisht. Argumentet e paraqitura nuk pasqyrojnë të kundërtën e opinionit të audituesit, prandajJju si NjZP nuk vërtetoni dhe argumentoni se keni koordinuar aktivisht përmbushjen nga palët të detyrimeve respektive përgjatë gjithë

kohëzgjatjes së koncesionit dhe sa më sipër sqaruar observacioni nuk merret në konsideratë.
2. Është e vertetë se informacioni ka qenë pjesë e dosjes dhe kjo vërtetohet më së miri pasi është trajtuar qartë në akt konstatimin nr. 4, datë 12.02.2021 të mbajtur nga grupi i auditimit, por kjo nuk vërteton se, përzgjedhja e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit është bërë nga NjZP. Në fakt, Kryetari i BT me shkresën me *nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar "SH.K.T4." SHPK me objekt: "Përmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 4" mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 "Caktimi i Mbikëqyrësit të punimeve" si dhe të pikës 5.2 "Caktimi i kolaudatorit " të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon:*
- Për mbikëqyrës punimesh, OE "A.MK." SHPK.
- Për kolaudator, BOE "D-N" SHPK & "T.E.D.S." SHPK.
Argumentet e paraqitura nuk pasqyrojnë të kundërtën e opinionit të audituesit, prandaj Ju si NjZP nuk vërtetoni me fakte (dikumente, shkresa, etj) se keni koordinuar aktivisht përmbushjen nga palët të detyrimeve respektive përgjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit dhe madje nuk keni asnjë dokument që të vërtetoni zbatimin e pikës 7.2 të kontratës së sipërmarrjes nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020. Sa më sipër sqaruar observacioni nuk merret në konsideratë.

Kohëzgjatja e koncesionit.
- KK do të ketë një kohëzgjatje totale prej 8 (tetë) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit *(08.09.2020*). Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të filluar punimet e ndërtimit dhe ofruar shërbimet e mirëmbajtjes janë të kushtëzuara nga dorëzimi i shesheve me dokumentacionin përkatës të sheshit (ñ*Data e fillimit*ò).
- Afati i ndërtimit (pika 2.4.3) të kontratës së shkollave duhet të përfundohet *brenda* një afati prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e fillimit të punimeve (neni 4 i kontratës). Afati i ndërtimit do të quhet se është plotësuar në datën kur është lëshuar *Akti i Kolaudimit* në përputhje me ligjin e zbatueshëm.
- Pas ndërtimit dhe vënies në funksion të objekteve arsimore, kontrata do të mbetet në fuqi edhe për 7 (shtatë) vjet nga data e ì ertifikimit të ndërtimit, për mirëmbajtjen e objekteve arsimore.

Dorëzimi i zonës së koncesionit si dhe Procedura mbi Lejen Zhvillimore dhe Lejen e Ndërtimit.
AK merr përsipër që të dorëzojë tek koncesionari zotërimin fizik si dhe dokumentacionin e sheshit brenda 1 (një muaji) nga data e nënshkrimit por, në çdo rast, jo më vonë se 6 (gjashte) muaj nga data e nënshkrimit (***Afati maksimal i dorëzimit***).
-Data në të cilën AK do të bëjë dorëzimin fizik të të gjitha shesheve që përbëjnë zonën e koncesionarit së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton pronësinë e ligjshme të BT mbi to, dorëzim i cili do të vërtetohet me mbajtjen nga palët të proçesverbalit të dorëzimit, sipas formës të parashikuar në Aneksin 5 do të konsiderohet si (ñ***data e fillimit***ò).
-Drejtori i Përgjithshëm i Punëve Publike (DPPP) z. ñT. T.ò, me shkresën me nr. 36084 prot, datë 20.10.2020 i është drejtuar Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) duke i bërë me dije se për ndjekjen e procedurave për lirimin dhe dorëzimin e shesheve të ndërtimit me qëllim rrethimin dhe organizimin e kantierit, kërkojmë lirimin e shesheve, përkatësish:

-nr. pasurie 6/473, nr, pas 6/679, nr. Pas 6/678, nr.pas 6/471 Zona Kadastrale (në vijim ñZKò) nr. 8190, NjA nr. 2
-nr. pasurie 194/28, ZK nr. 2460, NjA Dajt.
-nr. Pas 3/20, ZK nr. 8340, NjA nr. 8.

Në këtë shkresë theksohet se, pronat e bashkisë me nr. Pas 3/20 dhe 194/2 janë shpronësuar për interes publik me VKM nr. 335, datë 05.04.2016, VKM nr. 100, datë 23.02.2018 dhe VKM nr. 218, datë 17.04.2019 si pronë që preket nga realizimi i projektit ñNdërtimi i ri i shkollës Tip 1 + Tip 4 në NjA nr. 8 sheshi 8.1 dhe NjA Dajt, sheshi D2ò dhe më pas është bërë regjistrimi i tyre.

-Kryetari i BT me shkresën me nr. 36572 prot, datë 22.10.2020 i është drejtuar ñSH.K. T4.ò SHPK duke i bërë me dije se për ndjekjen e procedurave për kryerjen e aplikimit për leje zhvillimi dhe ndërtimi, bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden çertifikatat për vertëtim pronësie për sheshet e kësaj kontrate, përkatësish:

-nr. pasurie 6/473, nr, pas 6/679, nr.pas 6/471 ZK nr. 8190, NjA nr. 2

-nr. pasurie 194/2, ZK nr. 2460, NjA Dajt.

-nr. Pas 3/20, ZK nr. 8340, NjA nr. 8.

- ñ SH.K.T4.ò SHPK me admunistrator Z. ñE. F.ò, me shkresën me nr. Prot. 3, datë 03.11.2020, drejtuar NjZP për dijeni BT, me objekt ñKërkesë për autorizim lidhur me kryerjen e aplikimit për pajisjen me leje ndërtimiò i kërkon BT të pajiset me autorizim për ñSH.K. T4.ò SHPK, për ndjekje e procedurave dhe kryerjen e aplikimit për pajisje me Leje Zhvillimore bazuar në kuadrin ligjor, pranë KKT.
- Në vijim, Kryetari i BT me autorizimin nr. 38793/1, datë 5.11.2020 autorizon ñSh.K. T4ò SHPK nëpërmjet shoqërisë ñS.E. and C.ò SHPK, pjesë e kësaj shoqërie, të paraqesë kërkesën dhe të realizojë të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor për projektimin, menaxhimin e dorëzimin e dokumetacionit për aplikim për leje ndërtimi, përmes e-albania, në AZHT, sipas dispozitave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.20009 ñPlanifikim i territoritò i ndryshuar.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi dorëzimin e sheshit (***Aneksi 5***) rezulton të jenë dorëzuar nga bashkia Tiranë 2 (dy) sheshe ndërtimi, si vijon:

Njësia Administrative nr. 8 Sheshi 8/1 Ndërtim i ri i shkollës Tipi 1 + Tipi 4

[Sheshi kufizohet: Nga jugu: 3/426; Nga Veriu: 3/19; 3/18; 3/408; Nga Lindja: 3/38; 3/39; ¾; Nga Perendimi: 3/412]

<u>Mangësi në plotësimin e procesverbalit të dorëzimit të sheshit 8/1.</u>

- procesverbali i dorëzimit të sheshit nuk ka datë. Aktualisht edhe pse sheshi 8/1 është liruar, nuk ka filluar zbatimi i punimeve për ndërtimin e shkollës së re ñ Tipi 1 + Tipi 4ò, pasi leja e ndërtimit është në proces dhe shoqëria koncesionare është brenda afateve kontraktuale mbi fillimin e punimeve.
- procesverbali nuk është nënshkruar nga përfaqësiesi i BT.
- nuk u paraqit Leja Zhvillimore dhe Gen Plani i sheshit 8/1 si dhe vendimi i miratimit të sheshit të ndërtimit dhe të objektit.

Njësia Administrative nr. 2 Sheshi 2/3 Ndërtim i ri i shkollës Tipi 2

[Sheshi kufizohet: Nga jugu: 6/677; Nga Veriu: 5/424; Nga Lindja: 5/424 ; Nga Perendimi: 3/170]

<u>Mangësi në plotësimin e procesverbalit të dorëzimit të sheshit 2/3.</u>

- procesverbali i dorëzimit të sheshit nuk ka datë
- procesverbali nuk është nënshkruar nga përfaqësiesi i BT
- nuk u paraqit Leja Zhvillimore, Gen Plani i sheshit 2/3 si dhe vendimin e miratimit të sheshit të ndërtimit dhe të objektit.

Konstatojmë se, edhe pse kanë kaluar mbi 3 (tre) muaj nga lidhja dhe hyrja në fuqi e kontratës së sipërmarrjes, aktualisht nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit 2/3 në NjA nr. 2 ñNdërtim i ri shkolle Tipi 2ò si dhe sheshi i ndërtimit D2 në NjA Dajt ñNdërtim i ri shkolle Tpi 4ò.

Sa më sipër trajtuar, rezulton se nga BT janë dorëzuar 2 (dy) sheshe ndërtimi dhe vazhdon procedura për dorëzimin e sheshit të ndërtimit D2, në NJA Dajt. Realizimi mbi zbatimin e kontratës për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020 të lidhur

ndërmjet Autoritetit Kontraktues BT përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. ñE. V.ò, nga MASR përfaqësuar nga Ministri Znj. ñB. Sh.ò dhe BOE midis shoqërive ñJ.V ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñEd.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò, aneksi 5 ñProçesverbali i dorëzimit të sheshitò konsiderohet i pjesshëm duke u bërë pengesë mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të shkollave me kontrata me koncesion.

<u>Njësia e zbatimit të projektit (NjZP).</u>

- Kryetari i BT me Urdhërin nr. 29139/2, datë 16.09.2020, ka urdhëruar ngritjen e NjZP në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastruktutës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 4ò në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së e detyrimeve kontraktuale me përbërjen si vijon:

- Z. ñH. H.ò, Kryetar (Përfaqësues i BT).
- Znj. ñF. F.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT).
- Znj. ñO.B.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT).
- Z. ñL. Gj.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT).
- Znj ñS. K.ò, Anëtar (Përfaqësues i MASR).

Veprimtaria e NjZP, bazohet në Kreu VII, neni 7 ñDetyrat e NjZPò, pika 7.2, NjZP të kontratës për punë publike me Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020, dhe ka si objekt shqyrtimin e ìdo propozimi dhe çdo çështje tjetër që paraqitet për shqyrtim në lidhje me Projektin apo zbatimin e tij.

- BT me shkresën me nr. 29943 prot, datë 10.09.2020, ka njoftuar MASR për lidhjen e kontratës së koncesionit/PPP, Zona Tirana 4 dhe në vijim mbi ngritjen e NJZP në cilësinë e monitoruesit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, e cila kontrollon dhe jep rekomandimet e saj duke ia përcjellë ato AK si dhe do të shqyrtojë çdo propozim që paraqitet për shqyrtim në lidhje me Projektin apo zbatimin e tij.

- MASR me shkresën me nr. 4692/1, datë 10.09.2020 (protokolluar në BT me nr. 29139 prot, datë 14.09.2020) ka emëruar Znj. ñS.K.ò (Përgjegjëse Sektori, Drejtoria e Konçesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve) përfaqësuesin e NjZP për MASR.

- BT me shkresën me nr. 29969 prot, datë 10.09.2020, ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në vijim MFE) për lidhjen e kontratës së koncesionit/PPP, Zona Tirana 4 dhe në vijim mbi ngritjen e NjZP në cilësinë e monitoruesit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, e cila kontrollon dhe jep rekomandimet e saj duke ia përcjellë ato AK si dhe do të shqyrtojë çdo propozim që paraqitet për shqyrtim në lidhje me Projektin apo zbatimin e tij.

- BT me shkresën me nr. 29935 prot, datë 10.09.2020, ka njoftuar Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve (në vijim ATK) për lidhjen e kontratës së koncesionit/PPP, Zona Tirana 4 dhe në vijim mbi ngritjen e NjZP në cilësinë e monitoruesit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, e cila kontrollon dhe jep rekomandimet e saj duke ia përcjellë ato AK si dhe do të shqyrtojë çdo propozim që paraqitet për shqyrtim në lidhje me Projektin apo zbatimin e tij.

- Drejtoria e Menaxhimimit të Investimeve të Huaja (në vijim ñDMIHò) me shkresëm me nr. 3879 prot, datë 05.11.2020 drejtuar Kryetarit të BT, bazuar në Kreu VII, neni 7, pika 7.2, NjZP mbështetur në aplikimin për leje zhvillimi nga ñSh.K. T4.ò SHPK sipas shkresës nr. 3 prot, datë 03.10.2020, kërkon pajisjen me një autorizim nga AK, për ndjekjen e procedurave për kryerjen e aplikimit për leje ndërtimi.

<u>Zbatimi i punimeve.</u>

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga auditimi në objekte/sheshet e ndërtimit rezulton se punimet e ndërtimit për Kontratën e Koncesionit/ PPP nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 me objekt *"Për përmirësimin e infratsrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4",* nuk kanë filluar edhe pse kanë kaluar 4 (katër) muaj nga lidhja e kësaj kontrate.

- Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë, grafiku i punimeve, etj., me këto të dhëna të përgjithshme:

Zbatimi i Kontratës Koncesionare /PPP "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë Tiranë për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4".		
14.Lidhja e kontratës Nr. 4907 Rep dhe Nr. 1874 Kol, datë 08.09.2020. Nr. 29970 prot, datë 10.09.2020 ñ SH.K.T4.ò SHPK.	**15.Vlera e kontratës** **2,086,147,490** lekë me tvsh ñJ.V ñA. K.ò SHPK & ñF.ò SHPK & ñED.Kò SHPK & ñA & E.E.ò SHPK & ñS.E. and C.ò SHPK & ñE.ò SHPKò përfaqësuar ngë shoqëria V ñA. K.ò SHPK.	**16.Likuiduar:** -
17. Situacioni Përfundimtar --	**18.Afati i punimeve të kontratës në muaj;** 18 muaj Afati i KK është 8.6 vjet Afati i shërbimit të mirëmbajtjes është 7 vjet Fillimi punimeve: 08.09.2020 Përfundimi punimeve:18 muaj sipas kontratës.	**19. Zgjatja e kontratës** Sôka
20. Mbikëqyrësi i punimeve ñA. MK.ò SHPK	Licenca nr. MK.2892/4	Kontrata nr. - prot, datë 27.10.2020
21. Kolaudatori i punimeve BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK	Licenca Nr: MK ---	Kontratë e kolaudimit nr. prot ------ datë ------.
22.Akt Kolaudimi ----	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** ---	

1. "Ndërtim i ri i Shkolle Tip 2 në NjA Nr.2 , (Sheshi 2/3)

Vendndodhja e sheshit 2/3 për ndërtimin e shkollës Tip 2 ndodhet pranë Drejtorisë së Higjienës (Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" Nëntor 2016). Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 2.

Përshkrim i sheshit: Sheshi 2/3 ndodhet në një zonë në pronësi të subjekteve private, e rrethuar, ka pjerrësi të konsiderueshme, nuk ka shkolla të mesme. Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore. Ky shesh gjendet në shpatin e kodrave ku është i lokalizuar edhe Qyteti Studenti dhe karakterizohet nga një pjerrësi e konsiderueshme.

Ka një sipërfaqe rreth 4,093.5 m^2.

2. Ndërtim i ri Shkolle, Tip 4 në NjA Dajt (Sheshi D2).

Vendndodhja e sheshit të propozuar nr. D2 për ndërtimin e shkollës Tip 4 ndodhet pranë Linzës, NjA Dajt . Sheshi aksesohet nga rruga ñShefqet Kukaò.

NjA Dajt (Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" Nëntor 2016 rishikuar në Shtator 2018.

Përshkrim i sheshit:

Akses i thjeshtë dhe prani e rrjetit rrugor në afërsi të sheshit;

Sheshi ndodhet pranë zonës së banuar ne Linzë.

Aktualisht sheshi përbëhet nga truall dhe godina të ish Sherbimit Informativ Ushtarak.

Ka një sipërfaqe 13.244 m^2.

3. Ndërtim i ri Shkolle, Tip1 në NjA Nr. 8 (Sheshi 8/1).

Vendndodhja e sheshit të propozuar nr. 8/1 për ndërtimin e shkollës Tip 1 dhe Tip 4 ndodhet pranë rrugës ñ5 Majiò. Njësia Administrative Nr. 8. Referuar Studimit të Fizibilitetit "Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë" Nëntor 2016.

Përshkrim i sheshit: Sheshi 8/1 ndodhet në një zonë të qetë relativisht, aksesi në këtë shesh është i lehte. Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore. Ka një sipërfaqe rreth 17,510 m^2.

Në këtë shesh ndërtimi do të ndërtohen 2 (dy) shkolla, përkatësisht:

1.1. Shkolla për arsimin 9-vjeçar urban (Tipi 1) (Sheshi 8/1).

1.2. Shkolla për arsimin e mesëm të lartë urban (Tipi 4) (Sheshi 8/1)
Katër shkollat që do të ndërtohen të tipeve, Tipi 1, Tipi 2 dhe Tipi 4, për arsimin 9-vjeçar urban dhe për arsimin e mesëm të lartë urban, duhet të kenë të gjitha ambientet e nevojshme akademike (klasat mësimore duke përfshirë laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, informatikës etj), palestër me ambientet ndihmëse të saj, hapësirat administrative, hapësirat shoqërore, etj. Objektet duhet të kenë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore dhe MKZ. Sistemimit të oborrit të shkollës duhet tõ kushtohet një rëndësi e veçantë. Ambientet e jashtme duhet të jenë të sistemuara, duke përfshire ambjentet funksionale përkatëse, terrenet sportive me gjelbërim dhe me ndriçim të jashtëm. Ndërtimi i këtyre objekteve shkollore do të plotësojë mungesat e objekteve arsimore në këto zona, si dhe do të ndikojë në uljen e numrit të nxënësve në shkollat ekzistuese të cilat ndodhen në kufijtë e këtyre njësive.
Aktualisht nuk ka filluar zbatimi i punimeve të ndërtimit, pasi leja e ndërtimit është në proces dhe shoqëria koncesionare është brenda afateve kontraktuale mbi fillimin e punimeve.

II. Monitorimi i kontratave koncecionare/PPP mbi ndërtmin e shkollave në bashkinë Tiranë.
Monitorimi dhe inspektimi gjatë/pas ndërtimit. Përveç monitorimit dhe inspektimit nga BT (në cilësinë e investitorit) Autoriteti Kontraktues përmes NjZP mund të monitorojë dhe inspektojë gjatë fazës së ndërtimit, në prani të koncesionarit, pasi i jep një njoftim të mëparshëm. Nëse gjatë monitorimit vërehen shkelje, NjZP harton një raport me shkeljet e konstatuara dhe masat përkatëse që duhet të ndërmerren për riparimin e tyre dhe ja dërgon AK-së.
Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike (DPPP) nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve të Huaja (DMIH) dhe konkretisht NjZP e përbërë nga: Z. ñH. H.ò, Kryetar (Përfaqësues i BT); Znj. ñF. F.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT); Znj. ñO. B.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT); Z. ñL.Gj.ò, Anëtar (Përfaqësues i BT); Znj ñS. K.ò, Anëtar (Përfaqësues i MASR)].
Informon MFE se në zbatim të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kontratës së koncesionit/PPP me objekt ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò me nr. 4907 rep dhe nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 lidhur midis BT, MASR si dhe BOEtë shpallur fitues për Zonën Tirana 4, NjZP e ngritur me urdhrin nr. 29139/3, datë 16.09.2020 me cilësinë e monitoruesit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, referuar kuadrit ligjor ñKoncesionit/PPPò si dhe në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 121, seksioni i IV udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019. Nisur nga fakti se aktualisht, nuk kanë filluar punimet e ndërtimit të objekteve arsimore për tre sheshet e ndërtimit, respektivisht:

- -2 (dy) objekte arsimore Tip 1 + Tip 4, janë vendosur në Njësinë Administrative (në vijim ñNJAò) Nr. 8;;
- -1 (një) objekt arsimor Tip 2, në NJA Nr. 2;
- -1 (një) objekt arsimor Tip 4, në NJA Dajt.

nga ana e NjZP nuk ka filluar raportimi mbi monitorimin apo zbatimin e punimeve të kontratës Koncesionare me objekt ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në bashkinë Tiranëò loti 4, ñZona Tirana 4ò.
Për sa është trajtuar në Rraportin Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tiranë, është paraqitur observacioni me shkresë me nr. 15248/1 prot., datë 11.05.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 771/8 prot, datë 20.05.2021), në lidhje me ñAuditimin mbi përputhshmërinë për projektin e PPP, Ndërtimi i shkollave në Bashkinë Tiranëò.

Pretendimi i subjektit:
1...Për sa i përket problematikës: "Mbi mungesën e oponencës teknike, përkatësisht për sheshin 11/2" sipas kontratës me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol., datë 17.10.2018, theson se:.....nisur nga sa më sipër konstatojmë se NJZP, ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionit në lidhje me kriteret e ndërtimit, ka dhënë sugjerimet e saj në lidhje me analizën funksionale të projektit dhe e ka përcjellë pranë Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve

Publike, e cila kontrollon dokumentacionin e plotë për miratimin në Këshill Teknik. Sipas ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Kreu III, Projektimi, Mbikëqyrja, Zbatimi dhe Kolaudimi i punimeve të ndërtimit, neni 6, "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga Ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit", si e tillë, shoqëria Koncesionare edhe në rolin e projektuesit, ka detyrim të ndjekë dhe të kryej të gjithë detyrimet ligjore përfshirë edhe oponencën.....oponenca teknike është pjesë e shpenzimeve preliminare të objektit dhe si e tillë, kërkesa, ndjekja dhe pagesa e këtij shërbimi do të kryhet nga ana e shoqërisë koncecionare. Nisur nga kjo shoqëria koncesionare me anë të shkresës me nr. prot, datë 76, datë 15.01.2021 ka bërë kërkesë pranë Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës teknike për objektin e ndodhur në sheshin 11/2 të kontratës.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:

Argumenti se SHK me anë të shkresës me nr. prot. 76, datë 15.01.2021 ka bërë kërkesë pranë Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës teknike për objektin të ndodhur në sheshin 11/2 të kontratës, kryerja e oponencës teknike konsiderohet e pjesshme dhe mbi të gjitha oponenca teknike duhet të realizohet përpara nxjerrjes së lejes së ndërtimit.

- Referuar në dokumentet bashkëlidhur këtij observacioni si: Shkresa me nr. 11750/1 prot, datë 03.04.2020 "Kërkesë për trajtimin e Projekt idesë"; Vendimi i Këshillit teknik me nr. 76 prot, datë 15.01.2021; shkresa për oponencë teknike me nr. 76 datë 15.01.2021, tregojnë vonesat dhe problematikat nga palët kontraktuale dhe NjZP, konkretisht:

- kryerje e pjesshme e oponencës teknike dhe shumë e vonuar.

- kryerje e oponencës teknike mbas aplikimit të shoqërisë Koncesionare për leje ndërtimi.

- kërkesë e bërë nga NjZP vetëm për trajtimin e Projekt idesë vetëm për "Ndërtim i Ri i shkollës TIP 2 në NjA nr. 11, sheshi 11/2" dhe jo për 2 (dy) sheshet e tjera si dhe miratimi nga KT i bashkisë vetëm Projekt idesë vetëm për "Ndërtim i Ri i shkollës TIP 2 në NjA nr. 11, sheshi 11/2". Me argumentimin dhe argumentet e paraqitura, grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin.

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

...Për sa i përket: Administrimit të procedurave për dhënien me koncesion/PPP të projektit me objekt "Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në BT"; Administrimit të kësaj kontrate dhe marrëdhëniet e Koncesionarit me Autoritetin Kontraktues; dhe marrjes përsipër për ndërtimin e 17 shkolllave të reja të ciklit parauniversitar, nga të cilat 10 shkolla të arsimit 9-vjeçar dhe 7 shkolla të arsimit të lartë, brenda afateve të parashikuara në planin e punës dhe studimin e fizibilitetit është përcaktuar në:

1. Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe MASR, pika 1, neni 4.

2. Vendimin nr. 353, datë 19.04.2017, pika 2.

3. Pika 1.1 "Palët" të Kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020 . Bashkia Tiranë administron procedurat për dhënien me koncesion/PPP, merr përsipër ndërtimin e 17 shkollave dhe është ajo që përfaqëson MASR në çdo marrëdhënie me Koncesionarin.

Është parashikuar se "Për qëllimet e administrimit të kësaj kontrate dhe marrëdhëniet e Koncesionerit me Autoritetin Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të përfaqësohet nga Bashkia Tiranë"

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:

Në lidhje me komentet e bëra në observacion nga Bashkia Tiranë, argumente me të cilat është njohur me parë grupi i auditimit gjatë procesit të auditimit, observacioni merret pjesërisht në konsideratë, duke sqaruar se NjZP ka formë të plotë për propozime dhe vendim marrje me 5 (pesë) antarë (përbërje me numër tek) dhe jo me 4(katër) antarë.

Për sa është trajtuar në Rraportin Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar, Bashkia Tiranë, është paraqitur observacioni me shkresë me nr. 15248/1 prot., datë 11.05.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 771/8 prot, datë 20.05.2021), në lidhje me pajisjen nga BT me ñLeje ndërtimitò dhe ñLeje Zhvillimoreò.

Pretendimi i subjektit:

...Lidhur mbi lejet e ndërtimit, po ju dërgojmë bashkëlidhur lejet endërtimit për objektet e Lotit 1 dhe Lotit 4.

- Me Vendimin nr. 10, datë 17.03.2021 nga KKT është vendosur miratimi i Lejes së Ndërtimit për objektin "Shkolla 9-vjeçare dhe Kopshti "Drejtoria e Higjenës" me vendndodhje në bashkinë Tiranë.

- Me Vendimin nr. 15, datë 03.12.2020 nga KKT është vendosur miratimi i Lejes së Zhvillimit për objektin "Shkolla 9-vjeçare dhe Kopshti "Drejtoria e Higjenës" me vendndodhje në bashkinë Tiranë.

- Me Vendimin nr. 08, datë 17.03.2021 nga KKT është vendosur miratimi i Lejes së Ndërtimit për objektin "Shkolla e mesme 5-Maji" me vendndodhje në Bashkinë Tiranë.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH:

Në lidhje me komentet e bëra në observacion nga Bashkia Tiranë, mbi lejet e ndërtimit dhe lejet zhvillimore, vërehet se nga KKT(KKT) lejet nuk janë lëshuar sipas emërtimeve të shesheve të përcaktuara në kontratat koncesionare dhe për të gjitha sheshet e ndërtimit dhe shkollat. Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

4. AUDITIM I PROBLEMEVE TË NDRYSHME TË DALA GJATË AUDITIMIT.

Gjatë procesit të auditimit në subjektin Bashkia Tiranë bazuar në programin e auditimit nr. 771/3, datë 02.11.2020 ndryshuar me nr. 771/5, datë 17.12.2020, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk u konstatuan problematika specifike për tâu trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në studimin e fizibilitetit Bashkia Tiranë ka analizuar se duke qenë që në Shqipëri nuk janë bërë më përpara investime të këtyre përmasave në fushën e arsimit, risku që të gjenden Operatorë Ekonomikë me eksperiencë në këtë fushë të përmasave financiare të sipërcituara është i madh. Në çdo rast, edhe nëse do të kishte Operatorë Ekonomikë të cilët kanë kryer kontrata të ngjashme të përmasave të mësipërme, numri i tyre do të ishte tepër i limituar duke limituar kështu edhe konkurrencën, gjë që dëmton procesin e prokurimit. Përveç sa më sipër, skema e financimit përmes PPP parashikon që Operatori Ekonomik të shërbejë edhe si investitor përveçse si ndërtues. Ky element e vështirëson akoma më tepër gjetjen e Operatorëve Ekonomikë që kanë kapacitete për realizimin e këtij projekti si një i tërë. Ndaj Bashkia Tiranë ka vlerësuar që projekti të ndahet minimalisht në **4 Lote**, për të rritur shanset që kërkesat e mësipërme të plotësohen. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi studimin e fizibilitetit të projektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranëò, nga Bashkia Tiranë ka rezultuar se, nuk ka analizuar mundësinë apo variantin financiar nëse Bashkia Tiranë do të marrte vetë kredi për realizimin e projektit.
Nga Bashkia Tiranë, *nuk është analizuar varianti për ndarje në më shumë LOTE*, në mënyrë që të nxitej apo stimulohej konkurrenca e operatorëve ekonomik pasi në projektet me vlera të larta monetare, konkurrenca është më e ulët ku shumë pak operatorë ekonomik në treg plotësojnë kapacitete financiare dhe teknike. Ndarja në më shumë se 4 lote, do të realizonte një konkurrencë apo tërheqje më të gjerë e më shumë operatorëve ekonomik *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.b.c faqe 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>1.1 Rekomandimi:</u> Bashkia Tiranë të analizojë variantin për ndarje në më shumë lote për dy lotet e parealizuara ende, në mënyrë që të nxiten apo stimulohen operatorë ekonomik për të marrë pjesë në PPP, ku të zhvillohet konkurrenca, duke përfituar ulje të çmimeve dhe të marzheve nga konkurimi publik.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Kërkesat e veçanta të kualifikimit për objektin ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën **Tirana 4**ò, si dhe për pesë objektet arsimore në zonën **Tirana 1** nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Sipas DSK te kriteret e vlerësimit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit. - Në pikën **2.3** Kapaciteti teknik AK kërkon: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Eksperiencë në Ndërtim:
a. Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **30 % e vlerës** së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 307,075,859 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit. **Ose,**
b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në ***një vlerë jo më të vogël sa dyfishi***, i vlerës së përllogaritur të zërave përkatës të kontratës objekt Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2,047,172,392 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.
<u>*Sa më sipër*</u>, konstatohet mospërputhje e kritereve sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar pasi në nënin 26, pika 6 ñKontratat për punë publikeò citohet:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **50 % e vlerës** së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Pra AK ka ndryshuar pikën (a), të punëve të ngjashme për një objekt nga 50 % në 30 % dhe ka lënë të pandryshuar pikën (b) me shumë objekte në dyfishin e vlerës. Veprimi i mësipërm favorizon operatorët ekonomik të cilët kanë punë të ngjashme për një objekt të vetëm deri në 30 % të vlerës dhe vështirësia e pjesëmarrjes së operatorëve që plotësojnë dyfishin e vlerës qëndron e njëjtë sipas legjislacionit. *Në lidhje me eksperiencat në mirëmbajtje, projektim dhe furnizim mallrash, AK i ka vendosur në përqindje më të ulëta se e parashikon legjislacioni i prokurimit publik.* Në lidhje me pikën **2.2**, konstatohet kërkesa të panevojshme dhe në mbivendosje të stafit teknik të zbatimit, pasi është kërkuar për çdo inxhinier në zbatim licenca e projektimit, e cila është e panevojshme për zbatimin e punimeve, e cila është e mbivendosur në kërkesën në pikën 2.1, ku operatorit zbatues i janë kërkuar gjithashtu edhe licencat e projektimit. Gjithashtu, vendosja e kritereve mbi eksperiencën në punë *5 vite në sektorin përkatës*, është e panevojshme pasi:
Mbështetur në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 kreu IV dhe në Vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 ñ*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*ò lidhja 4 përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Rrjedhimisht përderisa një projektues ka atë kategori licence i ka plotësuar kushtet specifike të vjetërsisë. Në pikën **5** AK ka përcaktuar se operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë *për të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit*. Në pikën **5.1** përcaktohet që OE të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për *6 (gjashtë) muajt e fundit të pakten 40 (dyzet) punonjës*. Në lidhje me pikën 5, 5.1, Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë të stafit teknik dhe 40 punonjës me dëshmi nga ISHTI, ngushton pjesërisht konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët e kanë patur këtë staf me kualifikime e dëshmi më shumë se 6 muaj. Pra një OE që ka 20 apo 30 punonjës me ISHTI në listëpagesë për 3 muaj, nuk do të stimulohej të merrte pjesë në procedurë. ***Ndërkohë***, në pikën **5.2**. AK kërkon që Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë në staf të punësuar Inxhinier ï Auditues energjie (1 person) dhe Ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person) në listpagesat e shoqërisë për të paktën *3(tre) muajt e fundit.* Në pikën **6**, kërkohet që Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, ***1 mjek***, bazuar në bazë të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 ñPër sigurinë dhe shëndetin në punëò, VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 ñPër aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò (i ndryshuar). Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 09.02.2011, të Këshillit të Ministrave ñPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, pika 1, pika 3, germa ñbò dhe pika 4 germa ñbò thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, ñPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëò, ***shfuqizohet***. Pra kërkesa e mjekut është shfuqizuar. Gjithashtu, vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 74 pika 3 ku citohet ....ñ *secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DSK. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*ò. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon ñMjekò nuk mund të jetë pjesë e një bashkimi operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, ***pra përjashtohen OE duke i***

mohuar mundësinë e bashkimit. Në pikën **18**, AK kërkon dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund tâi vihen në dispozicion operatorit ekonomik, ku disa prej tyre nuk janë në përpjesëtim të drejtë më natyrën dhe volumin e projektit. Në DSK është kërkuar Vinç kullë me lartësi min 30 ml me peshëmbajtje të paktën 850 kg në 35 ml distance, ku në fakt tipet e shkollave nuk e kanë të nevojshme këtë vinç. Është kërkuar Fabrikë Prodhim Betoni dhe specifikohet, *në rast së është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësisë i shoqëruar me leje mjedisore lëshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontratë qiraje duhet të paraqitet akti i pronësisë së qiradhënësit shoqëruar me lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Kontrata e qirase duhet të jetë e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.* Vendosja e fabrikës për prodhim betoni, tërheq nga konkurrimi të gjithë operatorët ekonomikë tregtarë dhe favorizon OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomik tregtar, i cili do të marrë pjesë në këtë procedurë, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në procedurë), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tâu realizuar. Prandaj kriteri largon nga gara çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në procedurë. *Në lidhje më këtë kërkesë AK duhet të shtonte specifikimin për kontratë furnizimi me fabrikën e betonit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.b/c faqe 52-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve për Lotet 2 dhe 3 që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret në lidhje me punët e ngjashme, stafin teknik, licencat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 34277/2, datë 09.10.2019, mbështetur në KK me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018, Kreu IV, Pika 4.4.2, paragrafi ñcò dhe pika 4.5 në pozicionin e zhvilluesit/investitorit, duke përfaqësuar Institucionin Bashkia Tiranë, ka autorizuar Shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK të paraqesë kërkesë dhe të realizojë të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor për projektimin, menaxhimin e dorëzimin e dokumentacionit për aplikim për leje ndërtimi.

- Në vijim, Shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK me shkresën nr. 21, datë 09.10.2019, autorizon shoqërinë ñA. K.ò SHPK që të përfaqësojë shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK në procedurën e aplikimit për Leje Ndërtimi për objektin: ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò.

Grupit të auditimit deri në fund të auditimit, nuk ju paraqit zbardhja e lejeve të ndërtimit për 5 (pesë) objektet arsimore që po ndërtohen në sheshet e ndërtimit: Sheshi 9/1, rruga ñEshref Frashëriò; Sheshi 11/2, rruga òVangjel Notiò dhe Sheshi 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò.

Sa më sipër zgjatja e procedurës së lëshimit të lejes së ndërtimit dhe ndërkohë fakti që vazhdimi i punimeve të ndërtimit për objektet arsimore është në proces, nuk është në përputhje me Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"* të ndryshuar, neni 28 dhe neni 29, dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë.

- Për shkak të zgjatjes së procedurës për Lejen e Ndërtimit nga Bashkia e Tiranës, për objektet arsimore që do të ndërtohen në sheshet e ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò pranë lagjes ñDon Boskoò, në Sheshin 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò dhe në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò, nga mbikëqyrësi i punimeve JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò, nuk janë mbajtur dokumentet teknike si: Akt kontrolli në kuotës ± 0.00 si dhe Aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit (në përfundim të kësaj faze) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, të analizohet mos dhënia e lejeve të ndërtimit dhe të dalin përgjegjësitë. Të merren masa të menjëhershme për dhënien e lejeve të ndërtimit për pesë objektet arsimore në lotin 1 ñZonën Tirana 1ò duke mundësuar realizimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit (konformë kushteve urbanistike dhe treguesve zhvillimor për zhvilluesin Bashkia Tiranë), projektin e zbatimit, kushtet teknike të zbatimit dhe të sigurojë cilësinë e objekteve arsimore dhe materialeve të ndërtimit sipas kërkesave të projektit në përputhje me standardet kombëtare ose Europiane.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e punimeve sipas Kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 me operator ekonomik fitues shoqërinë Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK për shkollën, Tip 2 + Kopësht që po ndërtohet në Sheshin 11/2, rruga ñVangjel Notiò nuk është bërë kërkesë për Leje Mjedisi pranë AKM.
Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e zbatimit rezulton se, AKM ka pajisur shoqërinë ñA. K.ò SHPK me leje mjedisi për objektet arsimore që po ndërtohen në sheshin e ndërtimit 11/1 rruga ñPaisi Vodicaò dhe në sheshin e ndërtimit 9/1 rruga ñEshref Frashëriò në vlerën 60,000 lekë dhe jo në vlerën 150,000 lekë siç është llogaritur në raportin përmbledhës nr. 34198, datë 09.11.2016, pika 1.3.1.3 ñKostot e tjera të drejtpërdrejta të investimitò (Fizibiliteti). Sa më sipër vazhdimi i punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes së mjedisit është në kundërshtim me pikën 4.4.2 germa (c) të kontratës Koncesionare; ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, pika 4, germa (e) dhe ngarkon me përgjegjësi shoqërinë Koncesionare, Autoritetin Kontraktues Bashkinë Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tëi kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA. K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për leje mjedisi për objektin arsimor që po ndërtohet në sheshin e ndërtimit 11/2, për të garantuar parandalimin dhe kontrollin për çdo ndikim apo ndotje mjedisore si dhe zbatimin e kërkesave teknike të përcaktuar në lejen mjedisore.

Menjëherë

4.2 Rekomandimi: AK Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për lejet mjedisore, duhet të reflektojë diferencën prej 90,000 lekë në koston direkte të investimit në kalendarin e pagesave parashikuar në nenin 2.5 të kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kontratës.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se Oponenca Teknike për projektin ñPërmirësimi i infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò është bërë e pjesshme, nga shoqëria Koncesionare ñZ.M.A.ò SHPK vetëm për objektin ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 9/1, Rruga ñEshref Frashëriò Tiranë dhe nuk rezulton të jetë bërë oponencë teknike në vlerën 729,484 lekë për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/1, Rruga ñPaisi Vodica ò Tiranëò dhe për projektin e zbatimit të objektit ñPërmirësimi i Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranësò, Sheshi 11/2, Rruga ñVangjel Noti ò Tiranëò, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se: ñ*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që*

*mbulon veprimtarinë e ndërtimeve*ò. Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues Bashkina Tiranë, NjZP dhe Mbikëqyrësi i punimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktues Bashkia Tiranë, Njësia e Zbatimit të Projektit dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa dhe tëi kërkojnë shoqërisë Koncesionare ñA. K.ò SHPK të aplikojë menjëherë për kryerjen e oponencës teknike për objektet arsimore që po vazhdojnë punimet e ndërtimit me një projekt zbatimi pa kryer më parë oponencën teknike, si një detyrim ligjor.

Menjëherë

5.2 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, referuar pagesës nga shoqëria Koncesionare për oponencën teknike, duhet të reflektojë diferencën prej 729,484 lekë në koston direkte të investimit në kalendarin e pagesave parashikuar në nenin 2.5 të kontratës Koncesionare me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol, datë 17.10.2018 dhe Aneksin 3 bashkëlidhur kontratës.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se NjZP në cilësinë e monitorimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale është ngritur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me Urdhrin nr. 7710/3, datë 21.02.2019. Në zbatim të Kontratës së Koncesionit/PPP ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës, Zona Tirana 1ò, Njësia e Zbatimit të Projektit duhej të ishte ngritur një muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës Koncesionare (17.10.2018), pra me datë 17.11.2018 dhe jo me datë 21.02.2019. Sa më sipër, NjZP është ngritur rreth 4 (katër) muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me Kontratën Koncesionare/PPP ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranësò me nr. 9513 rep dhe nr. 3756 kol., datë 17.10.2018, pika 6.1 ku thekson se: ñ*Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e Kontratës, AK krijon Njësinë e Zbatimit të Projektit e cila do të përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen si më poshtë ("NJZP")*...ò. Ngritja e NJZP me shumë vonesë ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë, për mos zbatim të përmbushjes së detyrime kontraktuale të kontratës së koncesionit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Tiranë, të merren masa që në vazhdimësi për zbatimin e kontratave Koncesionare në ndërtimin e objekteve arsimore për lotin 2 dhe lotin 3, të krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit në aftin kohor të përcaktuar në kontratën koncesionare, si një detyrim kontraktual.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve civile të ndërtimit në objekt për Kontratën Koncesionare (KK) me Nr. 9513 Rep dhe Nr. 3756 Kol, datë 17.10.2018 me sipërmarrës punimesh BOE ñA. K.ò SHPK, ñM. E.ò SHPK dhe ñZ. & C.ò SHPK, për 5 (pesë) objektet arsimore (Shkolla + kopshte) për sheshet e ndërtimit 9/1, rruga ñEshref Frashëriò pranë lagjes ñDon Boskoò, të Sheshit 11/1, rruga ñPaisi Vodicaò dhe të Sheshit 11/2, rruga ñVangjel Notiò, rezulton se punimet po kryhen jashtë afatit të përcaktuar në KK, për shkak të vonesave të shkaktuara nga AK për mos lirimin e shesheve të ndërtimit dhe mos miratimit me leje zhvillimore dhe leje ndërtimore. Afati kohor i përfundimit të punimeve në kontratën Koncesionare me PPP, është parashikuar 18 muaj, dhe duke i shtuar afatin maksimal prej 6 muaj sipas pikës 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò të kontratës Koncesionare (koha maksimale për lejet zhvillimore dhe lejet ndërtimore), bëhet 24 muaj, pra 2 vjet. Meqenëse kontrata është lidhur me datë 17.10.2018, atëherë punimet e ndërtimit duhej të përfundonin me datë 17.10.2020. Aktualisht ku realizimi i punimeve të ndërtimit paraqitet rreth 53 % për 5 (pesë) objektet arsimore konstatohet kryerje punime ndërtimi jashtë afatit kohor të KK me 115 ditë

vonesë, për shkak të mos lirimeve të plota të shesheve të ndërtimeve, duke riskuar mundësinë e penaliteteve ndërmjet palëve. Sa më sipër është vepruar dhe po veprohet në kundërshtim me nenin 2.7.1 ñDorëzimi i zonës së koncesionitò dhe nenin XVII Sanksionet dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Tiranë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Nga shoqëria koncesionare ñZ.M.Aò SHPK, të merren masa për zbatimin e punimeve të ndërtimit në afatet kohore të përcaktuara në KK, duke eliminuar vonesat për shkak të mos lirimit të shesheve të ndërtimit ose të lirimit të pjesshëm të tyre.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Përcaktimi i kostos së ndërtimit të shkollave, nga AK Bashkia Tiranë është referuar preventivave të hartuar për ndërtimet e reja të objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, me financim nga fondet publike dhe donatorë, ku janë marrë në konsideratë 5 shkolla dhe është nxjerrë çmimi për njësi në m^2. Sipas preventivëve të marrë në analizë për të 5 objektet arsimore, kategoritë e punimeve me zërat përkatës, që realizohen, janë Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike. Duke qenë se preventivët e këtyre objekteve janë hartuar duke iû referuar Manualit Teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2012 ï 2013, ku është bërë indeksimi i çmimit për m^2 i dalë nga këto preventiva. Ky indeksim i referohet buletinit të INSTAT-it ñNdryshimet Mesatare Vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (*Për Banesa*), 1994-2015ò, ku për periudhën 2013 ï 2015, indeksi i rritjes së çmimit mesatar të ndërtimit është 0.55 %. Si rezultat i këtij indeksimi çmimi mesatar i ndërtimit për shkollat është pranuar **46,331.6 lekë/m^2** pa TVSH dhe çmimi mesatar i ndërtimit për kopshteve është marrë **54,381 lekë/m^2** pa TVSH. *Pra konstatohet,* se një analizë jo e saktë e kostove të ndërtimit pasi në të dyja rastet e shkollave dhe të kopshteve preventivat e punimeve kanë të njëjtat zëra të punimeve (Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike). Në të dy rastet e përllogaritjeve për shkollat dhe kopshtet u është referuar manualeve teknike të çmimeve 2012-2013, të cilat nuk kanë ndryshime për zërat e punimeve dhe indeksimi për banesat është marrë i njëjtë 0.55 %. Në analizën e kostove për kopshtet, nuk paraqiten objektet e përllogaritura, nga janë marrë referencat etj. Rrjedhimisht, edhe kostoja për m^2 e kopshteve duhej të ishte e njëjtë me atë të ndërtimit të shkollave, ku të dyja përfshihen në të njëjtin grup tarifor sipas VKM 354, datë 11.05.2016 për ñ*Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim Territori, projektim, mbikëqyrje dhe Kolaudim*ò. Për objektet arsimore, i referohet Kreu III, Seksioni I ñNdërtesat dhe ndarjet funksionale të tyreò, ku kemi marrë grupin e IV tarifore dhe referuar tabelës 6, ñTabela shoqërueses e tarifave, neni 25. Pra, kostoja për m^2 e kopshteve është marrë me çmimin 54,381 lekë/m^2 pa TVSH, e cila duhej të merrej me çmimin 46,331.6 lekë/m^2 pa TVSH, me një diferencë prej **8,049.4 lekë/m^2**, e cila përbën rritje të analizës së kostove të ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë, e cila sjell rritje të mëtejshme në kostot shtesë për projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin. Nga rillogaritja e grupit të auditimit konstatohet se Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,030 lekë më tepër***, Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***10,544,496 lekë më tepër*** dhe Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), diferenca e çmimit rezultoi me ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë të analizojë situatën ku të nxjerrë përgjegjësitë për përllogaritjen e kostove të ndërtimit të shkollave dhe të kopshteve, të paargumentuara teknikisht në diferenca të çmimit, për:

- Ndërtimin e shkollave Tipi 1 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,030 lekë më tepër***.

- Ndërtimin e shkollave Tipi 2 (Shkollë + Kopësht), në ***10,544,496 lekë më tepër.***
- Ndërtimin e shkollave Tipi 3 (Shkollë + Kopësht), në vlerën ***7,035,031 lekë më tepër***, të cilat përbëjnë rritje të përllogaritjeve të vlerave të kontratës në kostot e ndërtimit për buxhetin e Bashkisë Tiranë.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Bashkia Tiranë të marrë masa të menjëhershme që për dy lotët 2 dhe 3 të cilat nuk janë zhvilluar ende, të rillogariten saktë kostot e ndërtimit, në mënyrë që fondet publike të përdoren me ekonomicitet, efektivitet dhe eficensë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në DSK kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën Koncesionare/PPP duhet të ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikëqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.* Kryetari i BT me shkresën me nr. 36663/1 prot, datë 27.10.2020 i është drejtuar ñSH.K.T4.ò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktore, në zbatim të kontratës së Koncesionit/PPP, Zona Tirana 4ò mbi propozimet e kësaj shoqërie në lidhje me përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht Kreu V, Pika 5.1, nënpika 5.1.1 ñCaktimi i mbikëqyrësit të punimeveò si dhe të pikës 5.2 òCaktimi i kolaudatorit ò të kontratës nr. 4907 rep, nr. 1874 kol, datë 08.09.2020, me propozimet si vijon:
- Për mbikëqyrës punimesh ñA. MK.ò SHPK.
- Për kolaudator BOE ñD-Nò SHPK & ñT.E.D.S.ò SHPK. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit për ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4ò është lidhur ndërmjet ñSH.K. T4.ò. ***<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, "Sh.K. T4." dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>*** Në ofertën e koncesionarit në kapitullin C, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 9,552,840 lekë pa TVSH ose 11,463,408 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 408,166 lekë pa TVSH ose 489,800.2 leke me TVSH. Në total vlerë është **9,961,006 lekë pa TVSH** ose **11,953,207 lekë me TVSH.**
Pra sa më sipër, konstatohet konflikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra, mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimeve është i konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria Koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin e zbatimit, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, etj. *Vlera prej* **11,953,207 lekë me TVSH** që do të

paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të marrë masa nëpërmjet një grupi të veçantë pune, që vlera prej **11,953,207 lekë me TVSH** për mbikëqyrjen dhe kolaudimit, të derdhet nga Koncesionari fitues në llogarinë e Bashkisë Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim rritjen e sigurisë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interesit ndërmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në DSK kërkohet që Operatorët Ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën Koncesionare /PPP duhet tõi ofrojnë Autoritetit Kontraktor *3 (tre) shoqëri supervizioni* si dhe *3 (tre) kolaudator (person fizik ose person juridik),* në rastin e shpalljes fitues në këtë procedure. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikëqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Kërkesa e mësipërme favorizon operatorët ekonomik që të zgjedhin mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e objekteve. Veprimi apo kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar; Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar; Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. **Neni 7** i cili thekson se: ñ...*Mbikëqyrësi i punimeve i emëruar nga Investitori , duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur e licencë përkatëse dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë</u>*...ò **Neni 12** të Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, ku citohet: *Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe <u>që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</u> që do të kolaudojë.* Me datë 29.10.2018 Drejtori i Përgjithshëm të Punëve Publike në BT me shkresën me nr. 39681/2 prot (datë 27.10.2020) i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò SHPK me objekt: ñPërmbushje detyrimi kontraktorë, në zbatim të kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Zona Tirana 1ò se duke marrë parasysh reputacionin personal, ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara sipas ligjit të zbatueshëm për rregullat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit zgjidhen:

- Për mbikëqyrës punimesh JV ñD-Eò SHPK & ñ Y.A.ò
- Për kolaudator ñT.ò SHPK.

Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit të objektit ñPër përmirësimin e infrastrukturës arsimore në bashkinë e Tiranës për pestë objektet arsimore në zonën Tirana 1ò është lidhur ndërmjet shoqërisë Koncesionare ñZ.M.Aò shpk. ***<u>Pra konstatohet se mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve paguhen apo kanë Autoritet Kontraktor, Shoqërinë Koncesionare Tirana 1 dhe jo Bashkinë Tiranë.</u>*** Ndërkohë në ofertën e koncesionarit, është paraqitur vlera e mbikëqyrjes e cila paguhet nga koncesionari në vlerën 14,161,791 lekë pa TVSH ose 16,994,149 me TVSH dhe vlera që do të paguhet kolaudatori është 561,098 lekë pa TVSH ose 673,318 leke me TVSH. Në total vlerë është **14,722,889 lekë pa TVSH** ose **17,667,467 lekë me TVSH.**

Pra sa më sipër, konstatohet konflikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimeve është ose konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi Investitor në këtë rast është shoqëria Koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, etj. *Vlera prej* **17,667,467 lekë me TVSH** që do ti paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.d faqe 48-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, të analizojë dhe të marrë masa nëpërmjet një grupi të veçantë pune, që vlera prej **17,667,467 lekë me TVSH** për mbikëqyrjen dhe kolaudimit, të derdhet nga Koncesionari fitues në llogarinë e Bashkisë Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim rritjen e sigurisë në realizimin e punimeve të ndërtimit për objektet arsimore, duke bërë të mundur përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Menjëherë

3.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, për procedurat e koncesioneve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që me anë të prokurimit publik të përcaktojë vetë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët, në mënyrë që të shmanget konflikti i interesit ndëmjet koncesionarit dhe mbikëqyrësit e kolaudatorit.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT TË KLSH

S.M., Përgjegjës i grupit të auditimit;

A.K., auditues;

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

V.K

V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e këtij projekt raport auditimi janë edhe aktet e mëposhtëme:

Nr.	Dokumenti i auditimit	Datë	Përshkrimi
1	Akt konstatimi nr. 1	12.02.2021	Për fizibilitetin
2	Akt konstatimi nr. 2	12.02.2021	Për prokurimet e koncensionit (Loti 1).
3	Akt konstatimi nr. 3	12.02.2021	Për prokurimet e koncensionit (Loti 4).
4	Akt konstatimi nr. 4	12.02.2021	Zbatimi i Kontratës Koncesionare
5	Akt konstatimi nr. 5	12.02.2021	Zbatim i Kontratës Koncesionare

VI. ANEKSE

Të përgjithshme mbi projektin "Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë" ndërtimi i 17 shkollave.

Tabela. 71: Vlera e përgjithshme e projektit

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	5,406,768,353										
2	1	5,406,768,353	6.28%	772,395,479	4,634,372,874	339,545,053	1,111,940,532	165,676,837	10,404,505	176,081,342	349,949,558	**1,288,021,874**
3	2	4,634,372,874	6.28%	772,395,479	3,861,977,395	291,038,616	1,063,434,096	165,676,837	10,404,505	176,081,342	301,443,122	**1,239,515,438**
4	3	3,861,977,395	6.28%	772,395,479	3,089,581,916	242,532,180	1,014,927,659	165,676,837	10,404,505	176,081,342	252,936,686	**1,191,009,002**
5	4	3,089,581,916	6.28%	772,395,479	2,317,186,437	194,025,744	966,421,223	165,676,837	10,404,505	176,081,342	204,430,250	**1,142,502,566**
6	5	2,317,186,437	6.28%	772,395,479	1,544,790,958	145,519,308	917,914,787	165,676,837	10,404,505	176,081,342	155,923,814	**1,093,996,130**
7	6	1,544,790,958	6.28%	772,395,479	772,395,479	97,012,872	869,408,351	165,676,837	10,404,505	176,081,342	107,417,378	**1,045,489,694**
8	7	772,395,479	6.28%	772,395,479	0	48,506,436	820,901,915	165,676,837	10,404,505	176,081,342	58,910,941	**996,983,257**
Grand total				**5,406,768,353**		**1,358,180,210**	**6,764,948,563**	**1,159,737,859**	**72,831,538**	**1,232,569,397**	**1,431,011,748**	**7,997,517,960**

Tabela 72: Vlerat që do mbulohen nga bashkia dhe nga konçesionari

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**814,242,252**	**1**	**814,242,252**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**5,406,768,353**	**1**	**5,406,768,353**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	5,406,768,353	1	5,406,768,353
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**165,676,837**	**7**	**1,159,737,859**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	165,676,837	7	1,159,737,859
4	**Marzhi i Fitimit**	**1,431,011,748**	**1**	**1,431,011,748**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	1,431,011,748	1	1,431,011,748
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4)			**8,811,760,212**

Nga të Cilat:	Bashkia	Koncesionari	Totali
1. Vlera e Përgjithshme e Projektit Pa TVSH	814,242,252	7,997,517,960	8,811,760,212
Totali	**814,242,252**	**7,997,517,960**	**8,811,760,212**

Tabela 88: Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 1

	Nr i shkollave Tipi sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopësh ti për shkollë	Sip ndërtim i shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
TIPI 1	1	20	4	4,938	874	5,812	46,332	54,381	228,785,770	47,528,848	276,314,618	276,314,618
Tipi 2	2	30	6	13,176	2,620	15,796	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	752,943,823
Tipi 4	2	21	-	8,001	-	8,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	370,699,665
Grand To	**5**	**71**	**10**	**26,115**	**3,494**	**29,609**	**138,995**	**163,143**	**719,368,623**	**118,767,740**	**838,136,363**	**1,399,958,107**

Tabela 100: Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 1

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,601,063,470										
2	1	1,601,063,470	6.28%	228,723,353	1,372,340,118	100,546,786	329,270,139	48,542,258	3,048,454	51,590,712	103,595,240	**380,860,851**
3	2	1,372,340,118	6.28%	228,723,353	1,143,616,765	86,182,959	314,906,312	48,542,258	3,048,454	51,590,712	89,231,413	**366,497,024**
4	3	1,143,616,765	6.28%	228,723,353	914,893,412	71,819,133	300,542,486	48,542,258	3,048,454	51,590,712	74,867,587	**352,133,198**
5	4	914,893,412	6.28%	228,723,353	686,170,059	57,455,306	286,178,659	48,542,258	3,048,454	51,590,712	60,503,760	**337,769,371**
6	5	686,170,059	6.28%	228,723,353	457,446,706	43,091,480	271,814,833	48,542,258	3,048,454	51,590,712	46,139,933	**323,405,544**
7	6	457,446,706	6.28%	228,723,353	228,723,353	28,727,653	257,451,006	48,542,258	3,048,454	51,590,712	31,776,107	**309,041,718**
8	7	228,723,353	6.28%	228,723,353	(0)	14,363,827	243,087,179	48,542,258	3,048,454	51,590,712	17,412,280	**294,677,891**
Grand total				**1,601,063,470**		**402,187,144**	**2,003,250,614**	**339,795,806**	**21,339,177**	**361,134,983**	**423,526,320**	**2,364,385,597**

Tabela 101: Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 1

Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
Kostoja e përgjithshme e shpronësimit	**252,915,927**	**1**	**252,915,927**
Kosto direkte e Investimit pa TVSH	**1,601,063,470**	**1**	**1,601,063,470**
Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,601,063,470	1	1,601,063,470
Kosto e mirembajtjes pa TVSH	**48,542,258**	**7**	**339,795,806**
Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	48,542,258	7	339,795,806
Marzhi i Fitimit	**423,526,320**	**1**	**423,526,320**
Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	423,526,320	1	423,526,320
Total i pergjithshëm i kostos			**2,617,301,524**

V.I. Loti 4: Kontrata Koncesionare /Partneritet Publik Privat, " Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës për katër objektet arsimore në zonën Tirana 4".

Tabela 174: Kostot e ndërtimit për shkollat në Lotin 4

	Nr i shkollave Tipi sipas tipit	Nr klasash për shkollë	Klasa kopësh ti për shkollë	Sip ndërtim i shkolla	Sip ndërtimi kopështe	Tot Sipërfaqe ndërtimi	Cmimi i ndertimit te shkollave lek/m2	Cmimi i ndertimit te kopështeve lek/m2	Kosto ndertimi të një shkolle	Kosto e ndërtimit të një kopështi	kosto e ndërtimit të një shkolle + kopesht	Kosto e përgjithshme e ndertimit
Tipi 1	1	20	4	4,938	874	5,812	46,332	54,381	228,785,770	47,528,848	276,314,618	276,314,618
Tipi 2	1	30	6	6,588	1,310	7,898	46,332	54,381	305,233,020	71,238,892	376,471,912	376,471,912
Tipi 4	2	21	-	8,001	-	8,001	46,332	54,381	185,349,833	-	185,349,833	370,699,665
Grand To	**4**	**71**	**10**	**19,527**	**2,184**	**21,711**	**138,995**	**163,143**	**719,368,623**	**118,767,740**	**838,136,363**	**1,023,486,195**

Tabela 185: Tarifa vjetore qe do t'i paguhet konçesionarit për Lotin 4

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Nr rend or	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Vlera e Mbetur e Kostos Direkte te Investimit (C-E)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+G)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*I)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+J)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH
1	0	1,176,772,556										
2	1	1,176,772,556	6.28%	168,110,365	1,008,662,191	73,901,317	242,011,682	35,879,060	2,253,205	38,132,265	76,154,522	**280,143,947**
3	2	1,008,662,191	6.28%	168,110,365	840,551,826	63,343,986	231,454,351	35,879,060	2,253,205	38,132,265	65,597,191	**269,586,616**
4	3	840,551,826	6.28%	168,110,365	672,441,461	52,786,655	220,897,020	35,879,060	2,253,205	38,132,265	55,039,860	**259,029,285**
5	4	672,441,461	6.28%	168,110,365	504,331,096	42,229,324	210,339,689	35,879,060	2,253,205	38,132,265	44,482,529	**248,471,954**
6	5	504,331,096	6.28%	168,110,365	336,220,730	31,671,993	199,782,358	35,879,060	2,253,205	38,132,265	33,925,198	**237,914,623**
7	6	336,220,730	6.28%	168,110,365	168,110,365	21,114,662	189,225,027	35,879,060	2,253,205	38,132,265	23,367,867	**227,357,292**
8	7	168,110,365	6.28%	168,110,365	-	10,557,331	178,667,696	35,879,060	2,253,205	38,132,265	12,810,536	**216,799,961**
Grand total				**1,176,772,556**		**295,605,266**	**1,472,377,822**	**251,153,420**	**15,772,435**	**266,925,855**	**311,377,701**	**1,739,303,677**

Tabela 187: Vlera e përgjithshme e projektit për Lotin 4

Nr	Vlera e Pergjithshme e Projektit	Çmimi	Sasia	Vlera totale
1	**Kostoja e përgjithshme e shpronësimit**	**53,345,580**	**1**	**53,345,580**
2	**Kosto direkte e Investimit pa TVSH**	**1,176,772,556**	**1**	**1,176,772,556**
2.1	Kosto direkte e investimit te koncesionarit Pa TVSH	1,176,772,556	1	1,176,772,556
3	**Kosto e mirembajtjes pa TVSH**	**35,879,060**	**7**	**251,153,420**
3.1	Kosto e mirembajtjes te koncesionarit Pa TVSH	35,879,060	7	251,153,420
4	**Marzhi i Fitimit**	**311,377,701**	**1**	**311,377,701**
4.1	Marzhi i Fitimit të Koncensionarit	311,377,701	1	311,377,701
	Total i pergjithshëm i kostos(1+2+3+4)			**1,792,649,257**